

**UNIVERSITETI I SHKODRËS**  
**“Luigj Gurakuqi”**

# **BULETIN SHKENCOR**

**Seria e shkencave të edukimit**

**Viti LXXIV (74)**

**2024**

*Shkodër, 2024*

## **REDAKSIA**

**Kryeredaktor - Prof. dr. Fatmir VADOHEJ**  
**Sekretar shkencor - Dr. Visar DIZDARI**  
**Anëtarë –Prof. dr. Mimoza PRIKU, prof. as. dr. Fatbardha**  
**OSMANAGA, prof.as.dr. Arjana STRINIQI,**  
**prof. as.dr. Dhurata HOXHA, prof.as.dr. Eranda HALLUNI,**  
**dr. Besara KADIU**

**DREJTOR I REVISTËS**  
**Prof. dr. Tonin GJURAJ**

**Korrektori dhe punoi në kompjuter: Arta Bajrami**

---

***Pronë letrare e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”***

---

Adresa e redaksisë: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”  
Redaksia e Buletinit Shkencor  
Seria e Shkencave të Edukimit  
Tel/fax: 0035522243747

## PASQYRA E LËNDËS

**Eranda HALLUNI BILALI, Fatmir VADOHEJ**

Shotë Galica - një Zhan D'Ark kosovare

*Shotë Galica – the Kosovo Joan of Arc..* .....5

**Visar DIZDARI**

Kontributi i Alfred Schutz në qartësimin e disa koncepteve themelore të sociologjisë kuptimore

*Alfred Schutz's contribution to the clarification of some fundamental concepts of the comprehensive sociology*.....15

**Zenel SINA, Lindita LUTAJ**

Metodat e mësimdhënies dhe mësuesit e së ardhmes

*Teaching methods and teachers of the future*.....23

**Lulzime DHORA, Dritan DHORA**

Vlerat e liqenit të Shkodrës në fokusin e arsimit parauniversitar

*Basic knowledges on the Lake Shkodra for schoolars*.....37

**Ylber DYLI, Dritan RUSTJA**

Disiplina e gjeografisë dhe vendi i saj në kurrikulën mësimore të arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë

*The discipline of Geography and its place in the curriculum of Lower Secondary Education and Higher Secondary Education*.....51

**Gerda SULA, Merita HOXHA**

Eksplorimi i ndikimit pedagogjik të EdPuzzle në klasat me mësim të integruar të përmbajtjes dhe gjuhës – kur CLIL bëhet digjital

*Exploring the Pedagogical impact of EdPuzzle in Content Language Integrated classrooms – when CLIL goes digital*.....61

**Ledina PREZA, Admir DEHATI**

Zgjedhja e profesionit në psikologji dhe punë sociale: një analizë e faktorëve psikologjikë dhe socio-kulturorë

*Career Choice in Psychology and Social Work: An Analysis of Psychological and Socio-Cultural Factors*.....83

**Jeta LILA, Lediana XHAKOLLARI, Xhevaire DULJA**

Motivimi i brendshëm në punë: roli i faktorëve socio-demografikë tek punonjësit në sektorin e turizmit në Shqipëri

*Intrinsic motivation at work: The role of socio-demographic factors among employees in the tourism sector in Albania*.....95

**Arben HOTI**

Ndikimet gjinore në mirëqenien shëndetësore gjatë menaxhimit të situatës së COVID-19 tek studentët e Universitetit të Shkodrës

*Gender impacts on health well-being during the management of the COVID-19 situation among students of the University of Shkodra*.....105

**Elona HASMUJAJ, Admir DAHATI, Anisa HALAJ, Juri VUKA, Klea CANI, Megi GRISHAJ, Valter ÇARRI**

Ndikimi i pjesëmarrjes në klubet studentore në socializimin, altruizmin dhe mirëqenien psikologjike të studentëve

*The impact of student club participation on students' socialization, altruism, and psychological well-being* .....117

**Arlinda HALLUNOVI YMERI**

Identifikimi i faktorëve motivues të mësuesve në shkollat e mesme

*Identification of teacher's motivational factors in secondary schools*..... 131

**SHOTË GALICA-NJË ZHAN D'ARK KOSOVARE**

Eranda Halluni Bilali, Fatmir Vadohej

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti i Mësuesisë*

**ABSTRAKT**

Kombi ynë i pasur me ngjarje të shumta historike, me figura trimëresha, luftëtare, të cilat shumë shpejt flakën “*petkat e nusërisë*”, e morën pjesë në debatet me karakter politik e ushtarak duke krijuar “*modelin e ri*” për gjininë e tyre.

Në këtë punim do të ndalemi në figurën e trimëreshës Shotë Galica, e cila u lind e u rrit në kohën e furtunave e oshtimave të armëve jo vetëm në Drenicë, por edhe Kosovë e Shqipëri. “*Oda*” ku mori mësim e edukim, lidhja me Azem Galicën dhe “*nusërimi*” në çetën e të shoqit përbëjnë mozaikun e jetës së saj, të cilën e filloi me luftë, dhe ashtu e mbaroi “*nuse jo për të tundur djepin*”.

Njohja e figurave të tilla, të cilat kontribuan jo vetëm në çështjen kombëtare, janë një themel i fortë jo vetëm për njohjen e historisë, por shërbejnë edhe si burim frymëzimi për brezat e ardhshëm.

**Fjalët kyçe:** edukimi, oda, nuse, çetë.

**Shotë Galica – the Kosovo Joan of Arc****ABSTRACT**

Our nation, rich in historical events, has given rise to many courageous female figures—warriors who swiftly cast aside their “wedding garments”, to engage in political and military affairs, thus creating a “new model” for women of their time.

This paper focuses on the extraordinary figure of Shotë Galica, a heroine born and raised during the turbulent times of armed resistance not only in Drenica, but across Kosovo and Albania. The traditional “oda” (Albanian guest room) where she received her early education, her relationship with Azem Galica, and her “marriage” within her husband’s guerrilla band constitute the mosaic of her life—a life that began with war and ended the same way, “a bride not destined to rock the cradle.” Recognizing and understanding such figures—who contributed

significantly to the national cause—provides a solid foundation for appreciating our history and serves as an enduring source of inspiration for future generations.

**Keywords:** education, oda, bride, guerrilla band.

Njëra nga figurat më të shquara të kombit shqiptar, është trimëresha e maleve të Kosovës, një legjendë për kohën e saj, Shota e Azem Bejt Galicës. *“Ajo gjithë jetën ia kushtoi luftës për lirinë e Kosovës dhe të Shqipërisë në përgjithësi”*.<sup>1</sup>

Shotë Galica u lind më 1895 në Radishevë të Drenicës. E pagëzuan me emrin Qerime, por më vonë e quajtën Shotë, në shenjë përkëdhelje nga babai i saj, emër me të cilin hyri në historinë kombëtare. *“Atij as nuk i kishte shkuar ndër mend se kështu, pa dashur, i kishte vënë një emër të dytë, me të cilin filluan ta thërrisnin jo vetëm nëna e vëllezërit, por krejt Radisheva, Drenica, Kosova dhe mbarë Shqipëria”*.<sup>2</sup>

U lind dhe u rrit në kohën e furtunave e oshtimave të armëve jo vetëm në Drenicë, Kosovë e Shqipëri, por edhe më gjerë. *“Radisheva ishte e papërkulur si shumë treva të tjera kundër pushtuesve të huaj, ndërsa këtë gjë e theksonte edhe vetë shtypi i shtetit verior”*<sup>3</sup>—përkatesisht ai i Serbisë. *“Drenica ka marrë pjesë gjithmonë në luftëra të bujshme për çlirimin kombëtar e politik; ajo ju ka sjellë përherë kokëçarje pushtuesve të huaj, si atij osman, austro-hungarez dhe serbo-malazet”*.<sup>4</sup>

### **Edukata popullore, "Oda" ku mori mësim dhe edukim**

Tradita e edukatës popullore gjatë shekujve ka qenë shumë e fuqishme dhe është shquar për prirje të shëndosha kombëtare. Forca e gjallë dhe e pavdekshme e pedagogjisë së popullit tonë ka qenë një faktor me rëndësi në shekuj për edukimin e shqiptarit. Edukimi i virtyteve të larta morale dhe i zakoneve të mira kanë qenë një sferë e rëndësishme e edukatës popullore. Breznitë e reja janë edukuar me frymën e atdhetarizmit, të trimërisë, të besës e të burrërisë, të nderit e dinjitetit, të mikpritjes, të sedrës, të ndihmës e të bashkëpunimit me njëri-tjetrin.

Kushtet e vështira të jetës, puna e rëndë fizike e krahut, luftërat e vazhdueshme kërkonin që breznitë e reja të ishin të përgatitur fizikisht, të

<sup>1</sup> Xheladin Shala, *Ngjarje dhe personalitete historike*, Prishtinë, 2009, fq. 286.

<sup>2</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica*, Tiranë, 1976, fq. 9.

<sup>3</sup> Politika, 17.VII. 1924, Beograd.

<sup>4</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica*, Tiranë, 1976, fq. 6.

zotëronin aftësi luftarake. Prandaj edukata popullore përpunoi një brendi të pasur e forma të larmishme për edukimin fizik e ushtarak të shqiptarëve, të cilët, siç shprehet edhe Barleti: "...me një rrëdhë dorë... lëvronin arat dhe me tjetrën mbanin shpatën."<sup>5</sup> Kështu, formimi i cilësive fizike, si: forca, shkathtësia, durimi, të lidhura ngusht me cilësitë morale, si: guximi, trimëria, ndihma reciproke, dinjiteti kombëtar, familjar e personal, dashuria për popullin, tokën gjuhën dhe atdheun kanë qenë gjithmonë synime edukative të mishëruara me aq mjeshtëri në jetën shoqërore dhe familjare, të ruajtura të trashëguara brez pas brezi.

Këto ideale edukative populli ynë nuk pat mundur t'i realizojë në institucionet arsimore dhe edukative, por ua mëkoi bijve të vet në mënyrë të natyrshme edukatën familjare, siç thotë Mjeda:

*që ndër djepa rrisin nanat  
e Hotit djelmninë ushtore  
e idhnim n'anmikun nëpër gji u qisin...*<sup>6</sup>

Në Drenicë nuk kishte shkollë, kështu si në të gjitha malësitë shqiptare, edhe në Drenicë ka ekzistuar "oda". Ajo ka zëvendësuar zbrazëtinë e arsimit. Sipas traditës, "oda" ishte njëfarë institucioni tradicional mësimi dhe edukimi, ku derdhej gurra e pafund e urtësisë popullore. Aty, me orë të tëra bëheshin kuvende, me zë të qetë e të matur, tregoheshin kujtimet e historisë së lavdishme, aty lëvdoheshin shembujt më të bukur të trimërisë, të nderit dhe të besës, aty shfrynte dufi dhe urrejtja për pushtuesin dhe veglat e tyre. Aty jehonte kënga, lahuta, çiftelia, fyelli e sharkia. "Tingujt e lahutës, të çiftelisë dhe të fyellit kanë jehuar fort nëpër "odat" e Drenicës. Me kësi tingujsh, të shoqëruar prej këngës së rapsodëve janë rritur Shota e Azemi dhe shumë trima të tjerë që ka nxjerrë Shqipëria. Të edukuar me këtë frymë, të rinjtë mezi prisnin të rriteshin e të bëheshin 15-16 vjeç që të rroknin armët e të luftonin për liri"<sup>7</sup>.

Në formimin e Shotës ndikoi së tepërmi i ati Halili, që e merrte përherë në "oda" ku mblidheshin burra. Duke ndenjur afër të atit përpiquej t'i shëmbëllente atij e me kënaqësi e dëgjonte atë se si gjatë dekadave të shkuara malet, grykat dhe fushat ishin bërë shesh betejash të përgjakshme. Dëgjonte më të mëdhenjtë e blinte mend prej tyre.

Para pushkës, në duart e Shotës zuri vend çiftelia. Për shumë vjet kënga e çiftelia u bënë shoqe të pandara. Shpesh mbrëmjeve nëpër "oda",

<sup>5</sup> Marin Barleti, Historia e Skënderbeut, Tiranë, 1964, fq. 100.

<sup>6</sup> Ndre Mjeda, Juvenilja, Tiranë, 1964, fq. 175.

<sup>7</sup> Ajet Haxhiu, Shota dhe Azem Galica, Tiranë, 1976, fq. 10.

sidomos mbas darke kur rrinin burrat e Radishevës, ajo merrte çiftelinë. Këndonte historinë e popullit të vet, i këndonte trimërisë, atdhedashurisë, nderit dhe besës, virtyte të larta këto të ruajtura brez pas brezi. Përmes këngëve hidhnin valle heronjtë e dëshmorët e Kosovës. Vegla dridhej në duart e saj, gishtat rrëshqisnin mbi telat, sytë i ndizeshin flakë e dalëngadalë ia merrte këngës. Kjo vegël i jepte asaj tipare burrërore, zëri përhapte lavdinë e burrërisë dhe prekte zemrën e kujtdo. *“Përmes tingujve të saj ndihej vikama Kosovës.”*<sup>8</sup> *“Nga goja e saj rridhnin këngë të popullit, vargje pushke, vargje historie të jetuara e të shprehura nga po ai popull që luftoi e këndoi pa druajtje.”*<sup>9</sup> Thua nuk këndonte, por shtinte sa për dy-tri pushkë. Kështu shfrente dufin ajo me këngë trimërie, shfrenin edhe ato që e dëgjonin. *“Dhe secili e ndiente veten Oso Kukë.”*<sup>10</sup>

Kjo edukatë që mori në fëmijëri la gjurmë në jetën e saj.

### Lidhja me Azem Galicën

Shota, në verën e vitit 1915, u martua me Azem Galicën, kryetrimin legjendar të njërive çlirimtare të Kosovës, legjendën e krahinës së Drenicës, emblemën më të njohur të trimërisë, patriotizmit dhe sakrificës. Ndryshe nga ç'ishte tradita, ai nuk kërkoi dhe gjeti nuse për të tundur djepa, por siç thotë Fan Noli: ashtu e nisën jetën, ashtu e mbaruan, në luftë.

Vetëm dy javë martesë, ajo do të rrokte pushkën, të cilën për 12 vjet nuk do ta lëshonte nga dora deri në fund të jetës së saj, kur edhe u bë heroinë e popullit. *“Që nga ajo ditë lufta u bë pjesë e jetës së Shotës, e cila ngjeshi armët dhe hyri në radhën e nuseve të malit, në radhën e burrave dhe të çetave të lirisë.”*<sup>11</sup>

Dalja e Shotës në mal që një hap i dyfishtë guximi, sepse ajo lidhej në luftën e gjatë kundër pushtuesve të huaj, e njëkohësisht, shkëlmonte zakonet prapanike mbi gruan. Çetë më çetë e mal më mal, ku luftoi e shkeli këmba e Shotës, burrat e dheut, duke parë qëndresën e saj, filluan ta vlerësonin e nderonin, madje t'i këndonin edhe këngë lavdërimi e trimërie, që dikur ua thurnin vetëm luftëtarëve të dalluar.

Heroina e Drenicës *“kaloi ylberin”* u vesh me tirq shajaku ngjeshi armët në brez, por mbeti gjithmonë nusja e bukur e Azem Bejtës. *“As dhe gati askush nuk mund të besonte se nën hijeshinë e nuses së re fshihej trimëria e burrit, e bashkuar kjo me urtësinë plot ndjesi të gruas*

<sup>8</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica*, Tiranë, 1976, fq. 15.

<sup>9</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica*, Tiranë, 1976, fq. 14.

<sup>10</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica*, Tiranë, 1976, fq. 15.

<sup>11</sup> Xheladin Shala, *Ngjarje dhe personalitete historike*, Prishtinë, 2009, fq. 287.



shqiptare"<sup>12</sup>. Marrëdhënia e tyre ishte krejt e veçantë dhe e vetmja në ambientin shqiptar. Barazia me të drejta dhe detyrime tek çifti Galica dukej diçka e natyrshme. “Në këtë këndvështrim Shota u dha grave të tjera një simbol emancipimi dhe njëkohësisht një tregues që nënshtrimi e pacifizmi me burrat shqiptarë janë një rrugë jo e sigurt për të patur më shumë të drejta”<sup>13</sup>. Ajo, në Kosovën pasosmane, do të shndërrohet në një personazh që hedh tej “petkat e nusnisë” dhe merr pjesë në të gjitha debatet me karakter politik dhe ushtarak, duke krijuar një model të ri jo vetëm për gjininë e saj.

Jeta e tyre u shkri në një jetë dhe luftë të përbashkët kushtuar idealeve çlirimtare të shqiptarëve. Forca që e shtyu heroinën të kapte pushkën në dorë ishte ndjenja e atdhedashurisë, urrejtja ndaj pushtuesit, etja për liri dhe ndjenja e “besnikërisë së pafund ndaj të shoqit”<sup>14</sup>.

Shumë detaje të saj na bëhen ndihmë për të kuptuar fenomenin Shotë Galica, i cili në vetvete mbetet i pakrahasueshëm. Sa herë që shfaqet portreti i saj fizik, ai gjithnjë del dhe duket jo si vajzë e nuse me bukuri mahnitëse, jo si një grua me pajë, por si një “amazonë” me pushkë në krah. Ja si shprehen poetët për të:

*Lisat të përshëndetnin hijen e pushkës  
Plisi besnikërisht t'i mante gërshetat  
U linde ta mposhtësh harrimin  
Ti krismë e përjetshme.  
(Q. Demiraj)*

*Duert tueja përkëdhelin pushkë,  
Jo fëmijë  
Grue mbi gratë,  
Grue mbi burrat,  
Grue për ma trimin <sup>15</sup>  
(A.Gjakova)*

### **“Nusërimi” në çetën e të shoqit**

Shota ka zënë vend për krah burrave në histori për luftën dhe trimërinë si luftëtare në çetën e të shoqit e më pas si udhëheqëse, si një njeri që ka sakrifikuar për çështjen kombëtare.

<sup>12</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica*, Tiranë, 1976, fq. 34.

<sup>13</sup> Gazeta 55. 30 gusht 2007, fq. 6.

<sup>14</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica*, Tiranë, 1976, fq. 35.

<sup>15</sup> A. Gjakova, “Këngë për Kosovaren” (Shotën)- këngët e Drinit të Bardhë- vjersha dhe poema, Tiranë, 1967.

Shtëpia e Azemit rrethohet nga xhandarmëria. Azemi me tre vëllezërit, nënën dhe Shotën u detyruan të mbroheshin. Në këtë betejë ata korren sukses të plotë. Kjo ishte lufta e parë e Shotës dhe thirrja e famshme *o prite Azem Galicën* zë fill tek ajo kur vret një xhandar. *“Kjo thirrje e rastësishme shënon hyrjen e Azemit dhe të Shotës në epikën legjendare, por ajo piskamë ka edhe një tjetër valencë ndjenjash, tregon adhurimin që ajo provonte për të shoqin. Ky është një moment që e rikthen Shotën në “Mrizin e Zanave”. “Në kohën që Azemi po bëhej gati të ndahej me njerëzit e vet dhe të nisej për në mal, Shota iu drejtue e i tha: “Azem, kij besim në mue, më merr me vete, ndoshta kam me t’u dashtë, të fortë kanë me qenë trupi e zemra ime, kam me durue tanë përplasjet e rrebeshet sikur ti; due me qenë shok me ty, të luftojmë e të vdesim bashkë, pushkën që kam në dorë kurrë skam me ja dorëzue kujt, kij besim në mue Azem!”<sup>16</sup> Ndërsa Azemit i kalonin në kokë gjithfarë mendimesh që nuk e linin të vendoste ndërhyr nëna e tij Sherifja:” Po bijë e nanës , mirë e kie, kurrë mos hiq atë pushkë prej dore, ka ardh koha me i dal zot kësaj toke. Pa atdhe s’jemi asgja. Shko të pastë nana! Ndiemoje e rueje Azemin!”<sup>17</sup>*

Jo kushdo e për ma tepër një grua mund të kishte miqësi me Luigj Gurakuqin dhe Hasan Prishtinën, Bajram Currin e të tjerë njerëz me ndikim të kohës. Ajo u pranua prej tyre si partnere ushtarake dhe politike. Një akt i tillë është certifikim i personalitetit të Shote Galicës. Tek ajo spikati zgjuarsia, instinkti dhe kundërshtia ndaj injorancës. Në çdo mjedis të grave ajo i shfrytëzoi bisedat për të ngjallur ndjenjat patriotike dhe për t’i bërë ato më pjesëmarrëse.

Një nga betejat ku del në pah karakteri i fortë dhe aftësia ushtarake si një kalorëse e stërvitur është ajo e vjeshtës të vitit 1918 kundër 2 mijë forcave austro-hungareze në zonën e quajtur Prroi i Keq. Kjo betejë qe një triumf i vërtetë u kap komandanti austriak i garnizonit. Një këngë popullore thotë:

*Me kangë në gojë, me allti në shokë,  
U rrit çika me emrin Shotë,  
Luftoi rreptë me austriakë  
Hem me pushkë, hem me shpatë!<sup>18</sup>*

Gjatë rrethimit të Radishevës në prillin e vitit 1919, Shota mori një plagë të lehtë në trup, që iu shërua pa u shpëputur nga çeta, por një plagë të rëndë në shpirt i shkaktoi Shotës terrori i shfrenuar serb. Në këtë luftë nga

<sup>16</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica*, Tiranë, 1976, fq. 33.

<sup>17</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica*, Tiranë, 1976, fq. 35.

<sup>18</sup> Këngë popullore e mbledhur në Kukës në vitin 1969.

24 anëtarë të familjes i kishin mbetur 5 vëllezër që me armë në dorë luftonin në rrallët e çetave kryengritëse, ndërsa nëna kishte mbetur e vetme pa plang e shtëpi. Me gjithë mizorinë e serbëve, morali i Shotës nuk ra. Përkundrazi ndjenja e shpagimit u shtua edhe më tepër. Në mbrëmje, në prani të një pjese të çetës Azemi iu lut Shotës që të pushonte për disa ditë...E përgjigjja e Shotës qe: *“A nuk jam edhe unë si shokët? Edhe gruen, kur e din pse lufton nuk paska gja në botë që e përkul...Mandej ti, Azem e di se unë një herë kam ba be që për këtë popull jam gati me ba çfarëdo flije, apo jo?”* Azemi kur e pa se ishte e kotë të bisedohej më gjatë, i tha: *“Po Shotë ke të drejtë...e përse u përket grave, o Shotë, koha e ka provue se ti dhe shumë nana e motra tona kanë qindrue e kanë dale burra e përmbi burra”*<sup>19</sup>.

Gjatë rrethimit të Radishevës Shota u arrestua. U mor në pyetje dy ditë nga komandanti Savavoviq për të treguar se ku ishte Azemi, duke e kërcënuar se në të kundërt do t'i shkonte koka. Shota me qetësi dhe jo pa arrogancë i përgjigjet: *“Nuk e di se kush do ta paguajë me kokë para njëritjetrit, unë apo ti, se Azemi shpejt do të vijë këtu dhe do të keni punë me të”*.<sup>20</sup> Dhe kështu ndodhi. Shota u lirua.

Në kryengritjen e Dukagjinit të vitit 1919, Shota luftoi trimërisht.

Gjatë verës së vitit 1919, Shota me 60 luftëtarë u nis për në Shkodër. Kaloi nëpër malësi të Tropojës, Shalës e Nikaj-Mërturit. Thuhej se *“...kushdo që e pa dhe e njohu Shotën gjatë asaj rruge ruan kujtimet më të mira për të”*<sup>21</sup>. Shota dhe Azem Galica, së bashku me bashkëluftëtarët, u kthyen sërish në Kosovë dhe në fund të muajit gusht dhe në fillim të shtatorit 1919 vijnë në Shalë të Mitrovicës.

Me ndërmjetësimin e disa personave, në tetor të vitit 1919, bëhet një takim i Azemit e Shotës në fshatin Zhabar afër Mitrovicës me Mihajlo Ceroviqin, një kriminel ordiner, por nga takimi nuk doli asnjë rezultat. Qëllimi ishte të ndalej pak aktiviteti i Azemit dhe Shotës, meqë *Mitrovica me rrethinë konsiderohej si zonë e rrezikshme dhe më e lakmuar për Serbinë*<sup>22</sup> atëherë dhe sot. Mirëpo, atdhetarët e vërtetë e dinin se *“toka nuk do vetëm ujë. Ajo është shumë e shtrenjtë. Armiqtë e lakmojnë shumë. Uji e ruan nga Thatësira, gjaku e ruan nga armiqtë”*.<sup>23</sup>

Në fund të muajit korrik të vitit 1920 një batalion i ushtrisë serbe e rrethoi në Galicë, Shotën dhe nënën e Azemit, Sherifen. Falë vendosmërisë

<sup>19</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica*, Tiranë, 1976, fq. 74.

<sup>20</sup> Gazeta 55, 30 gusht 2007, fq.6.

<sup>21</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica*, Tiranë, 1976, fq. 83.

<sup>22</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica*, Tiranë, 1976, fq. 86.

<sup>23</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica*, Tiranë, 1976, fq. 51.

dhe trimërisë së Shotës dhe nënës së Azemit, si dhe ndihmës së bashkëvendësve, nga rrethimi u tërhoqën pa humbje. Shtëpia e Azemit u dogj. Për këtë ngjarje gazeta “Populli” e datës 14 gusht 1920, botoi një letër të ardhur nga Shkupi, e cila, midis të tjerash thoshte: *“Gati përditë bahen të ndeshme të përgjakshme në mes të serbëve e të çetave shqiptare. Në Drenicë një batalion serb, e pat rrethue me të pabesë shpinë e Azem Galicës. Ky i mrami nuk u gjet aty. Por nana e Azemit hapi luftën... grueja e Azemit i çau serbët me pushkë në dorë e shpëtoi nderën e shtëpisë”*.<sup>24</sup>

Në fillim të gushtit 1920 pushtuesit arritën të zënë nënën e Azemit në fshatin Dubofc me 7 femra të tjera, 3 gra e 4 vajza nën 14 vjeçe. Gjashtë i pushkatojnë pa kurrfarë preteksti e vetëm njëra 6-7 vjeçe shpëton. *“Në mesin e grave të pushkatuara ishin pos nënës, edhe motra e Azemit, Mihania dhe e bija trevjeçare Zoja”*.<sup>25</sup> Pas kësaj tragjedie, Shota kërkoi para bashkëluftëtarëve të çetës si kurrë ndonjëherë më parë që të betoheshin se *“do të merrnin hak për gjakun e grave e çikave të vrara”*.<sup>26</sup> Dhe vërtet kështu ndodhi. Shota hyri vetë e pesta në Mitrovicë dhe nxori jashtë qytetit kryeshefin e xhandarmërisë së Mitrovicës me dy të tjerë famëkeq, urdhërdhënësit dhe vrasësit e gjashtë grave dhe vajzave të njoma shqiptare, të cilët i pushkatuan jashtë qytetit në verën e vitit 1921.<sup>27</sup> *“Ky është aksioni më i njohur e më madhështor i sokoleshës së maleve të Kosovës”*.<sup>28</sup>

Gjatë viteve 1921-1923 u krijua “Zona Neutrale e Junikut”, e cila u bë një bazë e fuqishme prej nga niseshin për veprime luftarake me dhjetëra njësi çetash kryengritëse të malësive verilindore të shtetit shqiptar dhe të krahinave të Kosovës.<sup>29</sup> Midis tyre gjatë kohës së lirë u shqua edhe Shotë Galica si shenjëtare e dalluar. *“Ajo ndërhyri disa raste kur nxeheshin gjakrat mes luftëtarëve, duke reaguuar energjikisht që të mos shkactohej vëllavrasja etj.”*<sup>30</sup>

Në verën e vitit 1923, qeveria serbe ftoi për bisedime në Mitrovicë Azemin me shokë. Mirëpo këta nuk pranuan që bisedimet të zhvilloheshin në qytetin e Mitrovicës, por në katundet e Drenicës, që ishin nën kontrollin e çetave. Bisedimet u zhvilluan në një lëndinë të katundit Polacë në prani të shumë luftëtarëve dhe të një grupi grash drenicase të armatosura e të veshura me rroba burrash. Biseda në fakt nisi e ashpër dhe mjerani Ceroviq,

<sup>24</sup> Gazeta Populli, 14 gusht 1920.

<sup>25</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica*, Tiranë, 1976, fq. 144.

<sup>26</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica*, Tiranë, 1976, fq. 148.

<sup>27</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica*, Tiranë, 1976, fq. 171-179.

<sup>28</sup> Xheladin Shala, *Ngjarje dhe personalitete historike*, Prishtinë, 2009, fq. 296.

<sup>29</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica*, Tiranë, 1976, fq. 190.

<sup>30</sup> Xheladin Shala, *Ngjarje dhe personalitete historike*, Prishtinë, 2009, fq. 297.

duke parë se Azem Galica nuk lëkundej aspak prej ideve, u mundua të ofrojë disa dhurata të Beogradit. Kjo e keqësoi më tej bisedën dhe për më tej ai iu drejtua Shotës; “Ç’asht nevoja që edhe gratë me ba një jetë të egërsume si kjo?” Shota iu përgjigj: “Nuk ashtë egërsia jonë por e juaja, që nuk na leni me jetue të qeta si nana fëmijësh, por sillemi si ushtarë malesh për me krye detyrën ndaj atdheut... Krali asht gjakësi e ndrydhësi ma dinak, prandaj na nuk i kemi besue e nuk i besojmë kurrë. Le të tërbohet sa të doje, si krali edhe Pashiçi i Serbisë. Këtu jena. Nuk ikim. Burra e gra kena me luftue, rropatemi por s’dorzohemi. Dhe ka me ardh dita, që mbi gjakun tonë të derdhun, ka me mbi liria”<sup>31</sup>. Mbasi Ceroviçi parashitroi kërkesën për paqe, Shota iu përgjigj: “Me i lëshu armët, kjo është paqja, që don Beograd nga ne. Në çdo rrethim që na keni ba kemi ndigjue fjalën “dorëzohuni” e me sa shifet prapë keni ardh me na thanë “dorëzohuni”. Kurrë jo!.. paqen e duem, mbasi ta kemi sigurue lirinë... Po hoqëm pushkët prej dore, serbi ka me na vu shkelmin në bark e konopin në fyt”<sup>32</sup>.

Mihajllo Ceroviçi mbasi u bind se Azemi e Shota nuk kishin ndërmend të bënin asnjë lëshim, nxori fytyrën e tij e filloi të bënte kërcënime. Në këto çaste Shota u ngrit në këmbë dhe duke mbajtur dorën në nagant, iu afrua Ceroviçit e me zemërim i tha: “Mjaft fole, të vraftë mallkimi dhe pushka e Kosovës. Çou e ikë shpejt prej këtu, gjarpën! Ndryshe do t’ia fal dreqit shpirtin tand të ndymë.”<sup>33</sup>

Pas zhbërjes së “Zonës Neutrale” të Junikut, filluan bisedimet dypalëshe për një armëpushim të përkohshëm. “Nga pala shqiptare merrte pjesë Azemi dhe Shota etj.”<sup>34</sup>. Aty Shota me aktivitetin e vet tregoi zgjuarsin e pjekuri politike.

Pas vdekjes së Azemit Shota eci në ballë të çetës luftarake duke ruajtur në fshehtësi vrasjen e të shoqit. Pranë trupit të të shoqit, para burrave të çetës u betua: “Sa të jem gjallë, do mbetem nusja e maleve dhe e luftës për lirinë e Kosovës”<sup>35</sup>. Buzë varrit - shpellë, si një shqiponjë e plagosur rëndë, pëshpëriti: “Azem! Tash po e kuptojmë ma mirë pse Kosova asht e papërkulun. Ajo i ka rranjë të zemrën dhe në trupin e heronjve”<sup>36</sup>. Populli këndoi:

Kur u vra Azemi trim,  
Shota çetave po u prin.<sup>37</sup>

<sup>31</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica*, Tiranë, 1976, fq. 205.

<sup>32</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica*, Tiranë, 1976, fq. 206.

<sup>33</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica*, Tiranë, 1976, fq. 207.

<sup>34</sup> Xheladin Shala, *Ngjarje dhe personalitete historike*, Prishtinë, 2009, fq. 298.

<sup>35</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica*, Tiranë, 1976, fq. 242.

<sup>36</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica*, Tiranë, 1976, fq. 246.

<sup>37</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica*, Tiranë, 1976, fq. 244.

Shotë Galica, me heroizëm çau përpara, duke u përpjekur ditë e natë, me pushkë, me zemër e me mendje për ta thënë fjalën e vet, fjalën e gruas për lirinë e Kosovës. “Ajo ngriti më lart figurën e gruas shqiptare, nderin, trimërinë, dhe besnikërinë e pastër të nuses të Kosovës.”<sup>38</sup>

Të shkruash e të kumtosh për një luftëtare si Shote Galica, është nder e privilegj, por edhe detyrim, pasi me shembullin e saj heroik në sa e sa aksione është burim frymëzimi për brezat e sotëm dhe të ardhshëm. Vërtet historia e shqiptarëve njih mjaft gra luftëtare dhe prijëse, që nga ilirja Teuta, Mamica, Nora e Kelmendit, Tringë Smalja, Maro Kondi etj., por rasti i Shotës është disi ndryshe. Kjo për faktin e ngarkesave të veçanta ndjesore që ngërthen jeta e saj dhe që e bëjnë figurën e luftëtares kosovare sa interesante po aq edhe të admirueshme, si ikonë e emancipimit të hershëm jo vetëm të femrës shqiptare, por edhe të familjes së saj, shtysa bazë e të cilit ishte atdhedashuria. Ajo ishte pushka, protesta dhe britma e Kosovës. Kjo luftëtare sokoleshë nuk ishte vetëm guximtare në luftë, po edhe e kthjellët në mendime, me horizont e pjekuri politike. Fjalët e saj në biseda qëllonin si plumba. Me bëmat e saj admirohemi dhe shprehim respekt e mirënjohje.

Nga kjo kuptojmë se populli ynë nuk ka nxjerrë vetëm burra të pushkës, por edhe femra si Shotë Galicën, zëdhënëse e denjë e ndërgjegjes kombëtare dhe përçuese e shkëlqyer e lëvizjes patriotike shqiptare. Ajo u bë udhëheqëse e vërtetë e luftës së njësive çlirimtare dhe bija më e lavdishme e historisë së Kosovës në shek. XX.

Tingëllon mjaft domethënësi urimi i nënave kosovare “*M’u bafsh, o bijë, trimneshë si nusja e Azem Galicës!*”<sup>39</sup>

## LITERATURA

- Barleti, M.(1964): “Historia e Skënderbeut”, Tiranë.
- Gjakova, A. (1967): “Këngë për Kosovaren” (Shotën)- këngët e Drinit të Bardhë - vjersha dhe poema, Tiranë.
- Haxhiu, A. (1976): “Shota dhe Azem Galica”, Tiranë.
- Mjeda, N. (1964): “Juvenilja”, Tiranë.
- Shala, Xh. (2009): Ngjarje dhe personalitete historike, Prishtinë.
- Gazeta *Populli*, 14 gusht 1920.
- Gazeta 55, 30 gusht 2007.
- Politika, 17.VII. 1924, Beograd.

<sup>38</sup> Xheladin Shala, *Ngjarje dhe personalitete historike*, Prishtinë, 2009, fq. 36.

<sup>39</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica*, Tiranë, 1976, fq. 158.

## KONTRIBUTI I ALFRED SCHUTZ NË QARTËSIMIN E DISA KONCEPTEVE THEMELORE TË SOCIOLOGJISË KUPTIMORE

Visar Dizdari

*Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", departamenti Psikologji - Punë Sociale*

### ABSTRAKT

Ky artikull studimor ka në qendër kontributin e dhënë nga themeluesi i sociologjisë fenomenologjike, Alfred Schutz, në qartësimin e disa koncepteve themelore të sociologjisë kuptimore të Max Weber.

Nëpërmjet një qasjeje teorike, shtjellohen fillimisht konceptet kryesore weberiane *veprim*, *veprim me kuptim* dhe trajtohen, më pas në detaje, përpunimi i këtyre koncepteve nën analizën fenomenologjike të kryer nga Schutz. Qëllimi është të sillen refleksione mbi rrjedhojat që këto analiza kanë sjellë dhe sjellin për teorinë dhe kërkimin social.

Rezultatet e studimit tregojnë se kuptimi i një veprimi është kuptimi që subjektivisht ka ndërmend aktori. Një rezultat tjetër i analizave të Schutz është që lidhja kuptimore e një veprimi për aktorin është motivi final (qëllimi), jo motivi shkakësor. Analizat e Schutz mbi konceptet *veprim* dhe *veprim me kuptim* bëhen të rëndësishme, sepse i japin themele teorisë së veprimitarisë sociale dhe justifikojnë pozicionet e qasjes interpretative të kërkimit cilësor në shkencat sociale.

**Fjalët kyçe:** *veprim*, *veprim me kuptim*, *motiv final*, Max Weber, Alfred Schutz.

### Alfred Schutz's contribution to the clarification of some fundamental concepts of the comprehensive sociology

### ABSTRACT

This review article focuses on the contribution made by the founder of phenomenological sociology, Alfred Schutz, in clarifying some basic concepts of Max Weber's comprehensive sociology.

Through a theoretical approach, the main Weberian concepts of action, action with meaning, are first elaborated, and then the elaboration of

these concepts under the phenomenological analysis carried out by Schutz is treated in detail. The aim is to bring reflections on the consequences that these analyzes have brought and bring for theory and social research.

The results of the study show that the meaning of an action is the meaning that the actor subjectively intends. Another result of Schutz's analysis is that the meaningful connection of an action for the actor is the final motive, not the causal motive. Schutz's analyzes on the concepts of action and action with meaning become important because they give foundations to the theory of social action and justify the positions of the interpretive approach and qualitative research in the social sciences.

**Keywords:** action, action with meaning, final motive, Max Weber, Alfred Schutz.

### **Hyrje**

Emri i mendimtarit austriak Alfred Schutz është i lidhur me atë drejtim të teorisë dhe metodologjisë sociologjike të njohur si *sociologjia fenomenologjike*. Bota e jetës së përditshme, intersubjektiviteti dhe qëndrimi natyral u shqyrtuan nga Schutz (1932/1974) në atë që ai e quajti *fenomenologjia konstitutive e qëndrimit natyral*.

Sociologjia fenomenologjike e themeluar nga Schutz ka shtrirë ndikimin e saj mbi teorinë dhe kërkimin në shkencat sociale sidomos duke filluar nga vitet '60 të shekullit të kaluar. Konstruktivizmi social i autorëve Berger e Luckmann (1966), ndër të tjera, punimet e Cicourel (1964, 1974), mund të identifikohen me këtë qasje, si dhe ndikimi i Schutz është vendimtar për etnometodologjinë e Garfinkel (1967).

Sociologjia fenomenologjike zë vend mes një tradite të gjerë antinaturaliste, e zhvilluar fillimisht në mjedisin e historicizmit gjerman e të neokantizmit (Crespi, 1984: 243). Këto dy rryma mendimi rreken t'i japin themele metodologjike shkencave sociale, duke qenë në kundërshti qoftë me pozitivizmin, qoftë me idealizmin (Bruschi, 2005: 225). Sidoqoftë, vepra e Schutz është në qendër të këtyre kontributeve.

Alfred Schutz lindi në Vjenë në vitin 1899. Po në Vjenë u regjistrua në Fakultetin Juridik, ku në vitin 1921 u diplomua në drejtësi. Pas diplomimit punoi si këshilltar në kompani të ndryshme, duke u marrë me çështje që lidhen me menaxhimin dhe legjislacionin bankar. Gjatë kësaj periudhe Schutz do të ndajë kohën midis jetës së tij profesionale dhe jetës së tij intelektuale, duke marrë pjesë në klube dhe seminare të ndryshme vjeneze ku do të mbajë disa kumtesa mbi çështje bazike teorike e



metodologjike të shkencave sociale (Barber, 2004).

Përpyrkja e parë intelektuale e tij ka të bëjë me dhënien e përgjigjeve për pyetje të ndryshme të shkencave sociale që lidhen me konceptin e veprimit dhe kuptimit. Mënyrën për të zgjidhur çështjet e shkencave sociale Schutz do ta gjejë në fenomenologjinë e Husserl<sup>1</sup>. Është përmes mendimit të babait të filozofisë fenomenologjike që Schutz përpiket të sqarojë shumë koncepte të paqarta të sociologjisë Weberiane dhe të gjejë themelin filozofik për shkencat sociale.

Duke ndërmarrë analizimin e *kuptimit* në një nivel më të thellë, Schutz njëkohësisht saktëson dhe qartëson konceptet weberiane.

Ky artikull ka për objektiv të shtjellojë fillimisht konceptet kryesore weberiane *veprim*, *veprim me kuptim* dhe *kuptim subjektiv* e *kuptim objektiv* dhe të trajtojë, më në detaje, përpunimin e këtyre koncepteve nga sociologjia fenomenologjike e Alfred Schutz, duke reflektuar mbi rrjedhojat që këto analiza kanë sjellë dhe sjellin për teorinë dhe kërkimin social.

### **Pikënisja: idetë e sociologjisë kuptimore të Weber**

Ashtu si për autorët e tjerë antinaturalistë, edhe për Schutz, studimi i fenomeneve sociale nuk mund të ndjekë modelin neopozitivist dhe bibehaviorist të një metodologjie shkencore të huazuar nga shkencat e natyrës. Objekti i shkencave sociale është *veprimtaria sociale* së cilës aktorët i japin një kuptim, prandaj kategoria e shpjegimit shkakësor është e papërshtatshme për studimin e fenomeneve sociale. Të vendosurit në qendër të *të kuptuarit* nëpërmjet interpretimit, ashtu siç sociologjia kuptimore e Weber proklamon, sipas tij është rruga e duhur për të përshkruar botën sociale (1932/1974).

Sipas Schutz, natyra e objekteve të studimit të shkencave sociale është e ndryshme nga ajo e objekteve të shkencave të natyrës. Objektet e vrojtuesit nga studiuesi social janë veprime ose prodhime që vijnë nga veprimtaria njerëzore, të cilave aktorët që i kryejnë i mveshin një kuptim. Në të pasurit kuptim për vetë aktorin që vepron qëndron edhe dallimi i veprimit nga sjellja. Prandaj detyra e sociologjisë është të kuptojë, përmes interpretimit, domethënien që veprimet kanë për ata që i kryejnë (1932/1974).

---

<sup>1</sup> Për mënyrën në të cilën Schutz takon mendimin e Husserl, shih Schutz, A. (1977). Husserl and his Influence on Me. *The Annals of Phenomenological Sociology*, 2, pp. 41-44.

Shihet që pikënisje e Schutz është vetë ideja weberiane e detyrës që sociologjia ka. Schutz njih rëndësinë e madhe të Weber me të cilin ndan individualizmin metodologjik, parimin e reduktimit të fenomeneve sociale në veprimin e individëve. Por Schutz mendon që Weber nuk është thelluar sa duhet në analizimin e *veprimtarisë sociale të pajisur me kuptim*.

Në librin e tij të parë e më të rëndësishëm *Der sinnhafte Aufbau der sozialen Welt*, botuar fillimisht më 1932, Schutz evidenton një seri premisash të pashprehura në veprën e Weber, mbi të cilat duhet thelluar analiza, si mosdallimi ndërmjet veprimtarisë si kurs (rrjedhë) dhe veprimit të kryer, kuptimi i të prodhuarit dhe kuptimi i prodhimit, kuptimi i veprimit vetjak e kuptimi i veprimit të tjetrit.

### **Konceptet *veprim* dhe *veprim me kuptim* te Max Weber**

Përfytyrimi i Max Weber për sociologjinë është ai i një shkence që ka për qëllim të kuptuarit e veprimtarisë njerëzore. Ai e shpreh hapur këtë vizion që në paragrafin e parë të artikullit të tij të vitit 1913. Sipas Weber “sjellja njerëzore (e jashtme apo e brendshme) paraqet gjatë rrjedhës së saj lidhje dhe rregullsi, ashtu si çdo zhvillim. Por çka është e veçantë për sjelljen njerëzore, janë lidhje dhe rregullsi rrjedha e të cilave mund të interpretohet me anë të të kuptuarit” (Weber, 1913/1958: 241).

Në veprën që botohet në 1922, pas vdekjes së tij, përfytyrimi i Weber mbi sociologjinë del i shprehur edhe më qartë. Termi *sociologji* duhet të tregojë një shkencë e cila përpaket të kuptojë në bazë të një procedimi interpretues veprimtarinë sociale, e të shpjegojë në mënyrë shkakësore rrjedhën dhe pasojat e saj (Weber, 1922/1999).

Siç shihet objekti qendror i reflektimit sociologjik është veprimi social. Por çfarë nënkupton Weber me këtë term?

Weber (1922/1999: 4) kupton me *veprim* “një sjellje njerëzore (qoftë ajo një bërje apo heqje dorë apo një pësim, me karakter të jashtëm apo të brendshëm), nëse dhe për aq sa individë që vepron apo individët që veprojnë i bashkëngjitin asaj një kuptim subjektiv”.

Dhënia e një kuptimi në mënyrë intencionale nga ana e aktorit veprues, është për Max Weber kriteri i demarkacionit ndërmjet sjelljes *refleksive* dhe veprimit.

Për më tepër, në klasifikimin e tij të veprimit në katër tipe (racional përsa i përket qëllimit, racional përsa i përket vlerës, afektiv, tradicional), Weber njih si krejtësisht me kuptim veprimin racional përsa i përket qëllimit, ndërkohë që veprimi afektiv dhe tradicional qëndrojnë “në kufi e shpesh përtej veprimit të drejtuar me vetëdije në bazë të kuptimit (Weber,

1922/1999: 22).

Weber kupton me *motiv* “një lidhje kuptimore e cila i duket, vetë individit që vepron apo vëzhguesit, si një *themel* i pajisur me kuptim i një sjelljeje”. Ai quan si *në përputhje përse i takon kuptimit* “një sjellje e cila zhvillohet në mënyrë koherente, në shkallën në të cilën marrëdhënia e elementëve të saj njihet nga ne - sipas zakoneve të përhershme të të menduarit e të të ndjerit - si lidhje kuptimore tipike” dhe si *në përputhje shkakësore* “një ndjekje procesesh, në shkallën në të cilën ekziston, sipas rregullave të përvojës, një mundësi që ajo të zhvillohet faktikisht përherë në mënyrë të ngjashme” (Weber, 1922/1999: 10).

Interesi i Weber, siç e kemi parë, nuk ndalon vetëm në interpretimin e kuptimit, por merr në konsideratë dhe shpjegimin shkakësor të veprimit.

Ndonëse Weber nuk dëshiron të thotë asgjë për rëndësinë e veprimtarisë sociale në raport me fenomenet e tjera që studion sociologjia, për të, ky është fenomeni qendror i studimit të kësaj shkence. Në përcaktimin e termit *veprim shoqëror*, Weber nxjerr në pah dy elementët e pandashëm të kuptimit të konceptit: zotërimin e kuptimit, siç kuptohet nga vepruesi dhe orientimin ndaj qëndrimit të të tjerëve. Sipas tij, me veprim “social” duhet kuptuar një veprim që i referohet - sipas kuptimit të tij të synuar nga agjenti apo agjentët - qëndrimit të individëve të tjerë, dhe drejtohet në rrjedhën e tij në bazë të këtij (Weber 1922/1999: 4).

### **Konceptet veprim dhe veprim me kuptim te Schutz**

Detyra e parë që Schutz parashtron për të kryer është të qartësojë konceptet weberiane duke nisur nga koncepti *kuptim*.

Para së gjithash Schutz pyet çfarë është një përjetim i pajisur me kuptim, në përgjithësi. Duke u mbështetur në kërkimet filozofike të Bergson e të Husserl ai mbërrin në përfundimin se kuptimi është një vështrim reflektiv drejt përjetimeve të shkuara. Kështu, mund t’u atribuohet domethënie vetëm përjetimeve të përvojës së shkuar të cilat mund të kujtohen e të riprodhohen në kujtesë. Sipas Schutz domethënia nuk është në përjetimin, por në mënyrën e të kthyerit të vëmendjes drejt këtij përjetimi. Vështrimi reflektiv që i drejtohet një përvoje të kaluar, “e cila është kryer, dhe në këtë mënyrë e nxjerr në pah si një përvojë shumë të dallueshme nga të gjitha të tjerat e përjetuara në rrjedhën e kohës, e bën këtë përvojë një përvojë me kuptim” (1932/1974: 100).

Ky koncept i parë i kuptimit të një përjetimi në përgjithësi zgjerohet me kuptimin specifik të një përjetimi të veçantë. Schutz këtu përdor konceptin husserlian të *sintezë e rendit sipëror*. Sinteza e rendit sipëror

formon lidhje kuptimore ndërmjet përvojave të jetuara. Lidhjet kuptimore formojnë një rezervë të shtresëzuar të objektizimeve të përvojës. Atëherë kuptimi specifik që i jepet një përjetimi të kaluar bëhet nëpërmjet risjelljes së tij në një skemë specifike të kësaj rezerve përvoje. Funkcioni i skemave të përvojës është interpretimi i përjetimit, njohja e përkatësisë së këtij përjetimi në një kategori tashmë të dhënë përjetimesh.

Qartësuar koncepti *kuptim* kalohet në qartësimin e konceptit *veprim* i pajisur me *kuptim*.

Çka e bën të jetë njësi dhe i jep kuptim veprimit është projekti i veprimit. Projekti është një parashikim i sjelljes së ardhshme nëpërmjet përfytyrimit. Në projekt, veprimi shihet si i realizuar në kohën foljore të së ardhmes së përparme.

Konsiderimi i veprimit me kuptim si një sjellje e motivuar në termat e një projekti të paramenduar zgjidh vështirësitë e lidhura me konceptin e Weber të *kuptimit që autori i mveshë veprimit të tij*. Por interesi i Weber, siç e pamë më lart, nuk ndalej vetëm në interpretimin e kuptimit, por merrte në konsideratë edhe “shpjegimin” shkakësor të veprimit. Schutz bën disa kundërshtime ndaj konceptimit Weberian të motiveve për veprim. Duke analizuar natyrën kohore të projektit, ai arrin në përfundime të ndryshme lidhur me motivimin e veprimit.

Së pari, sipas përkufizimit të Weber-it, interpretimi nga aktori që vepron është i njëjtë me interpretimin nga vëzhguesi, por për Schutz vetinterpretimi dhe interpretimi nga një tjetër janë të pakrahasueshëm.

Së dyti, Weber bën një përdorim të dyfishtë të termit *motiv* duke treguar herë orientimin drejt të ardhmes të veprimit (motivi final) dhe herë orientimin drejt së shkuarës (motivi shkakësor).

Për Schutz, uniteti i veprimit konstituohet përmes projektit, prandaj veprimi i planifikuar si i kryer në të ardhmen, është motivi (dhe pikërisht “motivi final”) për aktorin. Në marrëdhënien sipas qëllimit (final), projekti tashmë i dhënë më parë është një faktor motivues, ai motivon veprimin, i cili kryhet në bazë të projektit. Në marrëdhënien e mirëfilltë shkakësore, një përvojë para projektit është një faktor motivues, projekti që formohet është i motivuar. Ky, sipas tij, është ndryshimi thelbësor midis motivit final dhe motivit të vërtetë shkakor. Në rrjedhën natyrore të veprimit nuk ekziston një “lidhje” midis një veprimi të mëparshëm dhe veprimit të cilit i kërkohet kuptimi (ose përpiqet të shpjegohet *pse*-ja), por vetëm një rrjedhë e pakthyeshme përvojash të jetuara.

Përfundimisht, kuptimi i veprimit nuk është procesi konstitutiv motiv shkakësor - veprim, por lidhja që ekziston ndërmjet të vepruarit dhe projektit, sepse aktori vetë konsideron si kuptim të të vepruarit të tij vetëm

raportin ekzistues ndërmjet të vepruarit të tij dhe projektit (Schutz, 1932/1974: 107).

Pas sqarimit të konceptit *veprim i pajisur me kuptim*, kalohet tek koncepti i *veprimtarisë sociale*. Schutz edhe në këtë rast nisat nga përkufizimi i Weber i veprimit me kuptim referuar qëndrimit të individëve të tjerë<sup>2</sup>. Në konceptin weberian të veprimtarisë sociale, sidoqoftë, ai sheh të përfshirë dy koncepte të dallueshëm nga njëri-tjetri: *qëndrimin ndaj tjetrit* dhe *veprimin efikas mbi tjetrin*. I pari i referohet thjesht një kthimi të vëmendjes drejt rrjedhës së kohës së brendshme të tjetrit. I dyti koncept i referohet një veprimi motivi final i të cilit përfaqësohet nga projekti i nxitjes së një qëndrimi të caktuar te tjetri. Schutz bën një dallim analog edhe për konceptin weberian të *relacionit social*. Në konstruktin schutzian një rëndësi të madhe ka koncepti *relacion social i qëndrimeve* ngaqë mbi *drejtimin reciprok për nga koha e brendshme e tjetrit* bazohet përvoja e ekzistencës së tjetrit (Schutz, 1932/1974: 136-225).

## PËRFUNDIME

Analizat e Alfred Schutz mbi konceptin *veprim i pajisur me kuptim*, nxjerrin në pah aspekte të ndryshme.

Kështu, kuptimi i një veprimi është kuptimi që subjektivisht ka ndërmend aktori: vetëm ai është në dijeni të gjerësisë së projektit të tij, prandaj vetinterpretimi i veprimit dhe interpretimi nga ana e një tjetri nuk janë të njëjtë. Siç me të drejtë vëren Leonardi (1986), kjo pikëpamje e Schutz, përfaqëson një radikalizim të individualizmit metodologjik tashmë të pranishëm te Weber.

Për më tepër, analiza e Schutz tregon se *kuptimi* nuk është një karakteristikë e brendshme e veprimit, por rezultati i një interpretimi duke u nisur nga një *tani* e caktuar.

Një rezultat tjetër i analizave të Schutz është që lidhja kuptimore e një veprimi për aktorin është motivi final (qëllimi), jo motivi shkakësor. Aktori konsideron si domethënie të veprimit të tij jo procesin konstitutiv që nga motivi i vërtetë shkakësor çon tek veprimi, por vetëm raportin ekzistues ndërmjet veprimit dhe projektit.

Për më tepër, vetëm aktori e di në çfarë lidhje kuptimore qëndron veprimi i tij, sepse lidhjen kuptimore të motivit final të një veprimi e jep me qartësi vetëm ai që duhet të veprojë për qëllimin e fundit të veprimit të

<sup>2</sup> Schutz i referohet para së gjithash Weber, M. (1922): *Wirtschaft und Gesellschaft*, Mohr, Tübingen.

projektuar. Këto rezultate të analizave të Schutz mbi motivin final dhe shkakësor bëhen të rëndësishme për atë që, siç nënvizon dhe Izzo (1979: ix), “çfarëdo pretendimi i padjallëzuar «objektivist», «pozitivist», i lidhur me supozime të një objektivizmi të papërpunuar, ndeshet domosdoshmërisht” kundër tyre.

Përsa i përket pandehmës së ekzistencës së një marrëdhënieje sociale të caktuar analizat schutziane tregojnë se ajo nuk është e njëjta për vëzhguesin dhe të vëzhguar: për aktorët socialë të vëzhguar është një mundësi subjektive; ndërsa për vëzhguesin është një mundësi objektive. Vetëm duke pyetur individët e vëzhguar, vëzhguesi mund të fitojë sigurinë e të ekzistuarit të një marrëdhënieje sociale.

Nëpërmjet qartësimit të koncepteve themelore të sociologjisë weberiane, analizat e Schutz i japin themel teorisë së veprimtarisë sociale në botën e jetës së përditshme, justifikojnë pozicionet epistemologjike të qasjes interpretative kundrejt asaj pozitivate në shkencat sociale dhe bëhen frymëzim për bazat metodologjike të kërkimit cilësor.

#### BIBLIOGRAFIA:

- Barber, M. D. (2004). *The Participating Citizen: A Biography of Alfred Schutz*. State University of New York Press.
- Berger, P.L. & Luckmann, T. (1966). *The Social Construction of Reality: a Treatise in the Sociology of Knowledge*. Garden City.
- Bruschi, A. (2005). *Metodologia della ricerca sociale*. Laterza.
- Cicourel, A. V. (1964). *Method and Measurement in Sociology*. The Free Press.
- Cicourel, A. V. (1974). *Cognitive Sociology*. The Free Press.
- Crespi, F. (1984). *Le vie della sociologia: problemi, teorie, metodi*. Il Mulino.
- Garfinkel, H. (1967). What is Ethnomethodology? *Studies in Ethnomethodology*, Prentice-Hall, Englewood Cliffs, New Jersey, pp. 1-35.
- Izzo, A. (1979). Introduzione, në A. Schutz: *Saggi sociologici*, UTET.
- Leonardi, F. (1986). La fondazione dell'individualismo metodologico, *Di che parla il sociologo?* FrancoAngeli, pp. 40-73.
- Schutz, A. (1974). *La fenomenologia del mondo sociale*. (F. Bassani), Il Mulino. (originali botuar më 1932).
- Schutz, A. (1977). Husserl and his Influence on Me, *The Annals of Phenomenological Sociology*, 2, pp. 41-44, në *Collected papers V. Phenomenology and the Social Sciences*, (L. Embree ed.), Springer, 2011, pp. 1-4.
- Weber, M. (1958). Alcune categorie della sociologia comprendente, *Il metodo delle scienze storico – sociali*, (P. Rossi), Giulio Einaudi Editore. (originali botuar më 1913).
- Weber, M. (1999). *Economia e società 1. Teoria delle categorie sociologiche*. (Bagiotti T., Casabianca F., Rossi P). Edizioni di Comunità. (originali botuar 1922).

## METODAT E MËSIMDHËNIES DHE MËSUESIT E SË ARDHMES

Zenel Sina, Lindita Lutaj

*Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, Fakulteti i  
Edukimit, departamenti i Pedagogjisë*

### ABSTRAKT

Fakultetet e Edukimit përgatisin studentët për përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies, të cilat i zbatojnë gjatë praktikës profesionale aktive dhe përmirësojnë përdorimin e tyre kur punësohen si mësues. Përdorimi i metodave dhe strategjive të duhura në organizimin e orës së mësimi, si pjesë përbërëse të metodologjisë së mësimdhënies, ndihmojnë në rritjen e efikasitetit të punës së tyre si dhe në krijimin e të nxënësve aktiv e konstruktiv tek nxënësve.

Ky studim është realizuar me 80 studentë të vitit të parë dhe të vitit të dytë, Master profesional, "Mësuesi Arsim Fillor" në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës. Për të realizuar këtë studim u shfrytëzuan literatura të ndryshme nga fusha e mësimdhënies bashkëkohore vendase dhe të huaj. Ky studim është eksplorues, pasi bazohet mbi të dhëna sasiore e cilësore të marra nga përvoja e studentëve gjatë kryerjes së praktikës profesionale. Metoda kryesore ishte ajo e anketimit me anë të pyetësorëve, si dhe fokus grupeve e intervistave individuale të realizuara me studentët. Materiali është produkt i analizës dhe përpunimit të të dhënave të nxjerra nga studimi.

Nga analiza e bërë rezultoi se vihet re një përmirësim në drejtim të përdorimit të metodave bashkëkohore nga ana e studentëve, kjo me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies gjatë praktikës profesionale, për t'iu përgjigjur më mirë kërkesave të kohës për një mësimdhënie efektive. Studimi evidentoi, se një numër i konsiderueshëm i studentëve, duke përdorur metodat e duhura mësimore e menaxhojnë mirë kohën gjatë mësimdhënies duke ndihmuar edhe në uljen e stresit në mësim. Studentët shprehin qëndrimet e tyre për lirinë e përzgjedhjes gjatë zbatimit të strategjive alternative në mësimdhënie. Studentët, mësues të së ardhmes, shprehën se përdorimi i metodave të duhura gjatë procesit të mësimdhënies i ndihmon shumë ata që të kenë besim të lartë gjatë menaxhimit të klasës. Ata evidentuan gjithashtu se një rol shumë të rëndësishëm luan edhe performanca e tyre si mësimdhënës në motivimin e nxënësve.

Nga ky studim u pa si domosdoshmëri koordinimi i njohurive të studentëve mësues me përvojën e mësuesve mentor në përdorimin e metodave të duhura në mësimdhënie. Rekomandohet të shikohet mundësia e pjesëmarrjes në konferenca e simpoziume, ku studentët të shprehin mendimet e tyre dhe të fitojnë nga përvoja e të tjerëve. Mbështetje e fuqishme duhet të jenë universitetet, pasi ato hedhin themelet e formimit shkencor dhe profesional të studentëve mësues. Trajnimet të realizohen nga universitetet që përgatisin mësues, me qëllim arritjen e standardeve evropiane të mësimdhënies. Përmirësime të bëhen edhe në kurrikulën universitare, me qëllim ngritjen cilësore të programeve në nivelet evropiane, për përballimin e sfidave të kohës dhe integrimin në shoqërinë demokratike.

**Fjalë kyçe:** metoda aktive të mësimdhënies, efektivitet i të nxënit, praktikë profesionale.

### **Teaching methods and teachers of the future**

#### ***ABSTRACT***

Education Faculties prepare students to use contemporary teaching methods, which they apply during active professional practice and improve their use when employed as teachers. The use of appropriate methods and strategies in organizing the class hour, as an integral part of the teaching methodology, aids in enhancing the efficiency of their work as well as in fostering active and constructive learning of the students.

This study was conducted with 80 first-year and second-year students of the Professional Master's program, "Primary Education Teaching" at Aleksandër Moisiu University, Durrës. Various local and foreign contemporary teaching literature was utilized to carry out this study. This study is exploratory as it is based on quantitative and qualitative data gathered from the students' experiences during their professional practice. The primary method was the survey using questionnaires, as well as focus groups and individual interviews conducted with the students. The material is a product of the analysis and the processing of the data extracted from the study.

From the conducted analysis, it was noted that there is an improvement in the use of contemporary methods by the students, aimed at enhancing the quality of teaching during professional practice, to better



meet the demands of the time for effective teaching. The study highlighted that a considerable number of students, by using the appropriate teaching methods, manage their time well during teaching classes, which also helps in reducing stress while learning. Students express their views on the freedom of choice during the implementation of alternative strategies in teaching. The students, future teachers, state that using the right methods during the teaching process greatly assists them in maintaining high confidence in classroom management. They also noted that a very crucial role is played by their performance as teachers in the motivation of the students.

This study highlighted the necessity of coordinating the knowledge of the student teachers with the experience of the mentor teachers in the usage of the appropriate teaching methods. It is recommended to consider the participation in conferences and symposiums, where students can express their thoughts and gain from others' experiences. Strong support should come from universities, as they lay the foundations of the scientific and professional formation of student teachers. Training should be conducted by universities that prepare teachers, aiming to achieve European teaching standards. Improvements should also be made in the university curriculum, with the goal of raising the quality of programs to European levels, to meet the challenges of the time and integrate into a democratic society.

**Keywords:** active teaching methods, learning effectiveness, professional practice.

### ***Hyrje***

Universitetet luajnë një rol të rëndësishëm në përf forcimin e marrëdhënies midis punës në auditor me punën në klasë duke reflektuar njohuritë e marra. Programet e studimit në profesionin e mësuesve duhet të mundësojnë dhe t'i paraprijnë formimit të kompetencave profesionale të mësuesve kandidatë për përdorimin me efektivitet të metodave bashkëkohore në mësimdhënie. Sjellja dhe qasja teorike mbi shumëllojshmëri përvojash e realitetesh në procesin e të nxënës dhe reflektimi mbi këto përvoja në aplikim e sipër, i ndihmon mësuesit kandidatë, në krijimin e individualitetit të tyre profesional dhe lehtësimin e integritetit të tyre në procesin mësimor në shkollë si mësues aktivë (Ferrier - Kerr, 2009).

Studentët mësues të së ardhmes kanë nevojë të aplikojnë modele efektive të mësimdhënies, strategji efektive në të nxënës e nxënësve, të jenë pjesë aktive e grupeve për shqyrtimin profesional të çështjeve të shtruara

për zgjidhje. Studentët mësues nëpërmjet praktikës profesionale mundohen që të vënë në jetë formimin shkencor lëndor, planifikimin e punës mësimore, zhvillimin efektiv të orës mësimore, aplikimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies në klasë, teknikat vlerësuese, komunikimin e ngrohtë duke siguruar një mjedis paqësor të nxëni. Kryerja e praktikës profesionale në Republikën e Shqipërisë zhvillohet sipas Ligjit Nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar”, Neni 57, pika 4, 5 mbi profesionin e mësuesit dhe ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, Neni 11 të ligjit “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” për praktikat profesionale.

Studentët mësues përpiqen të realizojnë nivelin e dëshiruar të mësimin nëpërmjet përdorimit të metodave të duhura të mësimdhënies, duke përdorur strategjitë më efektive në procesin e të nxënit. Nuk është e mjaftueshme që mësuesi të dijë vetëm ku do të arrijë, por edhe si do të veprojë për të arritur rezultatet e dëshiruara. Në dekadat e fundit të shekullit të kaluar shkolla dhe mësimdhënia në shkollën shqiptare është dalluar për metodën tradicionale të saj. Natyra e kësaj metode është karakterizuar nga mësimdhënia tek të nxënësit e fakteve, rregullave e veprimeve zbatuese për përvetësimin e njohurive. Ky lloj të mësuarit kishte në thelb të tij atë që nxënësi duhet të përvetësonte të gjithë materialin, pa pyetur nëse ai ishte i interesuar për të, pa pyetur cilat ishin mundësitë e përvetësimit të tij në faza të ndryshme të zhvillimit. Interesimi i vetëm ishte se sa dhe çfarë duhet të dinë nxënësit. Në praktikë nxënësit ishin pasivë në procesin e të mësuarit.

Ndryshimet e vazhdueshme jo vetëm në arsim kërkojnë që mësimdhënia të përqendrohet më shumë në dhënien e koncepteve, modeleve duke përdorur strategji që vënë theksin në shfrytëzimin dhe zgjidhjen e problemit. Kjo për një arsye të thjeshtë, sa më shumë shoqëria të jetë e zhvilluar teknologjikisht, kërkon gjithnjë e më shumë qytetarë që jo vetëm mbajnë mend fakte, sepse këtë e bën mirë kompjuteri, por duhet të dinë të gjejnë lehtë atë informacion që ju duhet dhe të jenë të zotë të mësojnë gjatë gjithë jetës. Gjithçka përcaktohet në metodë. Pra, rëndësia, qëndron jo vetëm në dhënien e informacionit, por edhe në mënyrën se si përcillet tek nxënësit, dhe kjo mënyrë e dhënies së informacionit përfshihet në metodën bashkëkohore të mësimdhënies.

Ky hulumtim është i rëndësishëm, sepse në thelb na paraqet një panoramë mbi kuptimin e mësimdhënies dhe shtjellimin e metodave më efektive që përdoren nga studentët, si dhe hulumton efikasitetin dhe dobinë e metodave të mësuarit në auditorët studentorë, si ndikojnë në aktivizimin e nxënësve në klasë, në përmbushjen e rezultateve të të nxënit dhe krijimin e sa më shumë hapësirave për rrahjen e mendimeve të nxënësve.

Shoqëria e sotme njerëzore është shumë e interesuar për pasurimin e individit me njohuri dhe dije, në veçanti të brezit të ri, të cilit këto njohuri do t'i nevojiten gjatë gjithë jetës. Fëmijët janë ata të cilët kanë më shumë nevojë për dije, që i marrin në forma dhe mënyra të ndryshme. Metodat aktive të mësimdhënies janë faktor i rëndësishëm në procesin e mësimi, për vetë faktin e rëndësisë dhe vlerave që kanë në realizimin e orës mësimore në mënyrë të suksesshme.

### Shqyrtimi i literaturës

Trajtesa teorike mbi studime për mësuesit e rinj bazohet në teorinë konjitive sociale të Bandura (1986) dhe modelin e mentorimit me pesë faktorë të propozuar nga Hudson (2004). Duke u bazuar në fokusin e Bandura vëzhgimi dhe modelimi si burim i të mësuarit, teoria konjitive sociale, përshkruan se si besimi në kompetencën e dikujt për të pasur sukses në një detyrë i njohur si vetefikasiteti, ndikon fuqishëm në të mësuarit dhe rezultatet.

Sipas Erlich dhe Russ-Eft (2011), vetefikasiteti i referohet besimit të një studenti ose mësuesi. Shumë kërkime tregojnë se ekziston një lidhje pozitive, domethënëse midis besimeve të vetefikasitetit të nxënësve dhe performancës së tyre akademike (Bandura, 1986, 2008; Chemers et al., 2001; Honicke & Broadbent, 2016; Lent et al., 2008; Nasir & Iqbal, 2019).

Në procesin kognitiv, Bandura (2008), deklaroi se zakonet vetëpenguese të të menduarit dhe përkushtimi ndaj vlerave, përcaktuan qëllimin individual të jetës. *“Përmes qëllimeve të tyre, aspiratat, angazhimet sociale dhe planet e veprimit, njerëzit projektojnë veten në të ardhmen dhe formësojnë kursin që merr jeta e tyre.”* (Bandura, 2008, f.22).

Brouwers dhe Tomic (2000) shpjegojnë vetefikasitetin në menaxhimin e klasës si mësues, besimet në aftësinë e tyre për të organizuar dhe kryer aktivitetet e nevojshme për të arritur rendin në klasë. Sipas këtyre studiuesve, besimi i mësuesve rritet gjatë programit të trajnimit të mësuesve, si dhe aftësia për të menaxhuar sjelljen përçarëse mund të zhvillohet dhe të gjitha këto çojnë drejt një rritje të nivelit të vetefikasitetit të mësuesve. Menaxhimi i klasës është mënyra se si mësuesit organizojnë dhe strukturojnë klasat e tyre me qëllim të bashkëpunimit dhe angazhimit të nxënësve dhe minimizimi i sjelljes përçarëse (Arends, 1997). Menaxhimi efektiv i klasës është kritik për krijimin e mjediseve mësimore që nxisin suksesin akademik (Rosas & West, 2010).

Sipas Giallo dhe Little (2003), përvojat në klasë dhe gatishmëria e perceptuar, parashikojnë ndjeshëm vetefikasitetin e mësuesve në menaxhimin e klasës. Gjithashtu, ndërveprimet ndërmjet emocioneve të

mësuesve të nxënësve dhe aftësisë së tyre për menaxhimin e klasës gjatë mësimit në praktikë janë mjaft të rëndësishme në zhvillimin e vetefikasitetit.

Sipas Frenzel (2014), siç citohet nga Hascher dhe Hagenauer (2016), emocionet e mësuesit kanë një ndikim të madh në mësimit, kompetencat në klasë, veçanërisht, në stimulimin kognitiv dhe motivues në klasë, menaxhimin dhe mbështetjen sociale. Është konstatuar se efikasiteti i lartë i mësuesve lidhet me këmbënguljen e mësuesit ndaj detyrave sfiduese të tilla, si çështjet e menaxhimit dhe klasa pozitive menaxhimi (Romi & Leyser, 2006).

Bilali (2013) ekzaminoi lidhjen midis ankthit të studentëve mësues dhe nivelit të vetefikasitetit para dhe pas vendosjes në shkollë. Studimi zbuloi se angazhimi i studentëve është aspekti në të cilin nxënësit ndihen më pak efikas. Gjithashtu, niveli i ankthit të mësimit tek mësuesit studentë u rrit gjatë mësimit, veçanërisht në fund të vendosjes në shkollë. Gjithashtu, studentët mësues, të cilët raportuan më shumë besime të orientuara drejt zhvillimit, raportuan gjithashtu një vetefikasitet më të lartë të mësuesit. Në mënyrë të ngjashme, rezultatet e studimit Senler dhe Sungur-Vural (2013), treguan se pajtueshmëria, neurotizmi, qëllimet e qasjes së performancës dhe përdorimi i strategjive metakognitive janë të lidhura pozitivisht në dimensionet të ndryshme të vetefikasitetit të mësimit, ndërsa Ozonur (2021), gjeti një pozitiv të moderuar korrelacioni midis niveleve të vetefikasitetit të mësimit të mësuesve studentë dhe ankthit në punë.

Rupp dhe Becker (2020), identifikoi përvojat e zotërimit të lidhura me mësimin si kontribuesin më të mirë në vetefikasitetin, ndërsa Alsarawi dhe Sukonthaman (2021), theksojnë qëndrimet dhe njohuritë rreth përfshirjes si ndikuesit më të mirë në besimet e vetefikasitetit të mësuesve dhe të studentëve. Pearman et al., (2021), gjeti atë klasë dhe diskutimet individuale dhe reflektimet mbi mësimit në jetën reale, të cilat mund të nxisin zhvillimin e vetefikasitetit të kandidatëve të tyre për mësues.

Në literaturën që lidhet me metodat e të mësuarit në vendin tonë dhe më gjerë, vërehet një prirje e theksuar për t'i dhënë përparësi metodave që vënë në qendër nxënësit dhe që kanë si element dallues shumë të rëndësishëm ndërveprimin midis palëve që marrin pjesë në mësimit. (QTKA, Qendra e Trajnimit dhe Kualifikimit për Arsimin, “*Mësimit me në qendër nxënësin*”, Tiranë, 2005, f. 49).

Një koncept madhor që i kalon kufijtë e të nxënës bashkëpunues ka të bëjë me faktin që anëtarët e grupit janë të lidhur së bashku dhe në këtë mënyrë: secili mund të ketë sukses... e shprehur ndryshe në mënyrë

figurative se të gjithë “mbyten” ose “notojnë”. (Bardhyl Musaj, “*Mësimdhënia dhe të nxënët ndërveprues*”, Tiranë, PEGI, 2005, f.30)

Mësuesi model monitorohet në çdo moment të veprimtarisë së tij në shkollë, që nga mënyra e komunikimit, sjellja, lëvizjet, gjestet etj., dhe është i skanuar nga sytë e përqendruar në një pikë nga nxënësit e tij. Kështu, ai duhet të zotërojë situatën, për të shmangur çdo thyerje disipline dhe mbi të gjitha të realizojë me sukses procesin mësimor, i cili çon në prodhimin e vlerave edukative. Jensen i këshillon mësimdhënësit që: “*Mos supozoni kurrë se çfarëdo që është e rëndësishme për ju, do të jetë e rëndësishme edhe për nxënësit tuaj.*” ( Bardhyl Musaj, *Mësimdhënia dhe të nxënët ndërveprues*, Tiranë, 2005, f. 132)

Mësimi bashkëkohor kërkon që të jetë i hapur ndaj risive që inkurajojnë zhvillimin e shkathtësive krijuese tek nxënësit. Në mësimdhënien bashkëkohore ka elemente të caktuara të mësimit aktiv. Shkolla bashkëkohore përpaket të mbajë baraspeshë mes metodologjisë analitike dhe sintetike, mes detyrave materiale dhe funksionale në mësim, mes konkretizimit dhe abstraksionit etj. Të mësuarit e nxënësve ndërtohet duke u mbështetur tek njohuritë, shprehjet dhe vlerat që ofron një kurrikul. Mësuesi duhet të marrë parasysh llojshmërinë e njohurive bazë, aftësitë, sjelljet konfidenciale ku nxënësit ndihmojnë e zhvillojnë në mënyrë pozitive njëri-tjetrit. “*Ne jetojmë në një botë që ndryshon*” shkruan Fullan. (Fullan, Michael: Revista Pedagogjike, shkurt, 2011, f.19)

Në mësimdhënien bashkëkohore nxënësit janë më të interesuar për të dhënë mendimet e tyre dhe pjesëmarrja në orën e mësimit është më e kënaqshme se në një orë të zakonshme tradicionale. Mësuesit duhet të jenë të përgjegjshëm për të arritur sa më shumë cilësi në një mësimdhënie bashkëkohore. ( Revista Pedagogjike, tetor, 2011, f.17)

Mjedisi i të nxënët në bashkëpunim mundëson në çdo rast ndihmë për njëri-tjetrit, krijon mjedis më të përshtatshëm nga pikëpamja kulturore për grupet e nxënësve më të ndrojtur sesa në klasat tradicionale ku ekziston konkurrenca. Studimet dëshmojnë se këta nxënës të ndrojtur dhe me rezultate më të dobëta, përparojnë më mirë në klasat që mbështesin ndërveprimin dhe parimet demokratike. (Musaj, Bardhyl: *Mësimdhënia dhe të nxënët ndërveprues*, Tiranë, 2005, f.3)

Në literaturën që lidhet me metodat e të mësuarit në vendin tonë dhe më gjerë, vërehet një prirje e theksuar për t'i dhënë përparësi metodave që vënë në qendër nxënësit dhe që kanë si element dallues shumë të rëndësishëm ndërveprimin midis palëve që marrin pjesë në mësim. (QTKA “*Mësimdhënia me në qendër nxënësin*”, Tiranë, 2005, fq.49)

Nëse mësuesi është i pasur me njohuri të shumta lidhur me lëndën e tij, ai mund të zhvillojë një orë mësimi të qartë dhe të organizuar. (W. Anita, “*Psikologji e Edukimit*”, Tiranë, 2011, fq. 454). Rolet e mësuesit gjatë procesit të mësimi kanë qenë dhe vazhdojnë të rriten dita-ditës. Njohja e rolit të mësuesit në mësimdhënie është një element i rëndësishëm, pasi nëse ne i zbulojmë këto role, kemi më shumë mundësi që të shohim se cili rol është mbizotërues në klasë. Po në të njëjtën mënyrë ne shohim dhe punën e mësuesit me komplekset dhe vështirësitë e saj. Roli kryesor i mësuesit është që të përgatisë një individ me të gjitha cilësitë, vlerat dhe normat që i duhen për të hyrë në një jetë tjetër akoma dhe më të vështirë dhe më komplekse, e cila është jeta e të rriturve.

Përveç tij mësuesi mund të marrë gjatë mësimi shumë role të tjerë, si: këshilluesin, mbështetësit, organizuesin, udhëheqësin, motivuesin, nxitësin, vlerësuesin, diagnostikuesin, shokun e shumë role të tjera.

Në qoftë se do t’i referoheshim librit të Jeff Zwiers “*Zhvillimi i shprehive të të menduarit*” në klasat e 6-12, do të shihnim që shprehitë që do të zhvilloheshin në këtë rast do të ishin të shumta. Sigurisht, analiza dhe krahasimi, por do të zhvillohej dhe argumentimi bindës, ku nxënësit në këtë rast kanë arritur nivelet e larta të të menduarit duke përfshirë dhe shprehitë e tjera, si : analizën, krahasimin, vlerësimin, komunikimin.

### **Metodologjia**

Fokusi i këtij studimi është kuptimi mbi mësimdhënien e studentëve mësues të së ardhmes, si dhe shtjellimi i metodave më efektive që ata përdorin në punën me nxënësit, për të mbajtur të përqendruar vëmendjen e tyre në orët mësimore. Hipoteza e ngritur në këtë studim është se përdorimi i metodave bashkëkohore të mësimdhënies ndikon në rritjen e efektivitetit të orës së mësimi, duke siguruar rezultate më të larta në procesin mësimor.

Ky studim është realizuar me 80 studentë të vitit të parë dhe të vitit të dytë, Master profesional, “Mësuesi Arsim Fillor” në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës. Në këtë studim u përdor metoda eksploruese, pasi është bazuar në të dhënat sasiore e cilësore, të marra nga përvoja e studentëve, gjatë kryerjes së praktikës profesionale.


Pyetësori është ndërtuar i tillë që të marrë të dhëna të sakta dhe të bëjë lidhjen mes tyre, për të nxjerrë konkluzionet e nevojshme për vërtetimin e hipotezës. Ai përmban gjithashtu pyetje të drejtpërdrejta në lidhje me fokusin e studimit. Nga studimi rezultoi se metodat bashkëkohore janë efikase dhe kanë zëvendësuar më së miri ato tradicionale, duke u përdorur nga studentët gjatë praktikave profesionale në shkollat e Durrësit. Popullata e këtij studimi janë studentët e Fakultetit të Edukimit në Universitetin

“Aleksandër Moisiu” Durrës. Kampioni i studimit janë studentët e vitit të parë dhe të vitit të dytë të Masterit profesional, “Mësuesi Arsim Fillor”. Metoda kryesore ishte ajo e anketimit me anë të pyetësorëve, si dhe fokus grupeve dhe intervistave individuale të realizuara me studentët e përfshirë në studim.

### Rezultatet dhe diskutimi

Nga analiza e të dhënave të grumbulluara nga pyetësorët, si dhe nga të dhënat e mbledhura nga intervistat dhe fokusgrupet e realizuara u vunë re rezultatet e mëposhtme.


Grafiku i mëposhtëm, “*Menaxhimi efektiv i kohës dhe përdorimi i metodave mësimore*”, sjell në pah përgjigjet e studentëve mbi ndjesinë e stresit që lidhet me menaxhimin e kohës në mënyrë efektive, duke përdorur metodat e duhura bashkëkohore gjatë orëve të praktikës. Shumica e respondentëve, me një përqindje prej 49%, ndiejnë “Pak” stres nga menaxhimi i kohës. Një grup tjetër prej 38% e përshkruan ndikimin e menaxhimit të kohës si “Aspak” stresues, që tregon një qasje të qetë dhe të organizuar ndaj kohës së tyre. Në anën tjetër, një minoritet prej 12% ndiejnë një sasi “Shumë” të lartë të stresit në lidhje me këtë çështje, që tregon se për një pjesë të vogël të të anketuarve, menaxhimi i kohës mbetet një burim i rëndësishëm i stresit. Ky grafik në formë trekëndëshi tregon që pavarësisht se menaxhimi i kohës mund të jetë një sfidë për disa, një pjesë e madhe e respondentëve e menaxhojnë atë me një nivel të ulët të stresit ose aspak, kjo nga përdorimi i metodave efektive të mësimdhënies.



**Grafiku 1: Menaxhimi efektiv i kohës dhe përdorimi i metodave mësimore.**

Lidhur me pyetjen se sa i përdorin strategjitë alternative në praktikën e tyre mësimore studentët përgjigjen në këtë mënyrë: rreth 74% e

studentëve deklaruan se ata janë “Shumë të lirë” në zbatimin e këtyre strategjive, duke treguar mundësi të mëdha për inovacion dhe fleksibilitet në mënyrën se si ata punojnë me nxënësit e tyre. Kjo përqindje reflekton një qasje progresive dhe të hapur ndaj përdorimit të metodave të reja për të përmirësuar angazhimin dhe arritjet e nxënësve në klasë. Pjesa prej 22%, ndiejnë se kanë “Pak hapësirë” për të praktikuar këto ndryshime, kjo për vetë faktin se mund të kenë disa kufizime ose sfida përballë, të cilat mund t’i pengojnë ata për t’i zbatuar plotësisht këto strategji alternative. Vetëm një përqindje e kufizuar, përkatësisht 2% dhe 3% ose nuk shohin nevojën për zbatimin e strategjive alternative, ose thjesht nuk kanë mundësinë që t’i zbatojnë ato në punën e tyre me nxënësit. Këto rezultate paraqiten në grafikun 2.




**Grafiku 2: Qëndrimet ndaj zbatimit të strategjive alternative në mësimdhënie.**

Përsa i përket “Vetëbesimit të studentëve në menaxhimin e klasës, nëpërmjet përdorimit të metodave të duhura”, më poshtë jepet grafiku që tregon nivelet e vetëbesimit të studentëve në aftësitë e tyre për të menaxhuar një klasë, duke përdorur metodat e duhura në procesin mësimor. Me një përqindje mbizotëruese prej 86.5%, shumica dërrmuese e mësimdhënësve ndjehen plotësisht të sigurt në aftësitë e tyre për menaxhimin e klasës, ç’ka tregon një nivel të lartë të vetëbesimit profesional dhe një qëndrim pozitiv ndaj sfidave që vijnë me rolin e tyre nëpërmjet përdorimit të metodave efektive në orët mësimore. Një përqindje më e vogël, 13%, ndjehen të sigurt vetëm ndonjëherë, që sugjeron se ka raste ose situata të caktuara që i bëjnë ata të ndihen më pak të sigurt.



Interesant është se vetëm 0.5% e mësimdhënësve nuk ndjehen kurrë të sigurt në menaxhimin e klasës së tyre. Ky rezultat tregon një nivel të lartë të përgjithshëm të vetëbesimit në mesin e studentëve, me vetëm një fraksion të vogël që përjeton pasiguri të vazhdueshme gjatë përdorimit të një metode të caktuar mësimore.




**Grafiku 3: Vetëbesimi i studentëve në menaxhimin e klasës, nëpërmjet përdorimit të metodave të duhura.**

“Ndikimi i performancës së studentëve në motivimin e nxënësve” ilustron qartë besimin e tyre në lidhje me rëndësinë e performancës dhe entuziazmit të tyre si faktorë motivues për nxënësit. Me një shumicë dërrmuese prej 70%, studentët janë të bindur se sjellja dhe energjia e tyre pozitive gjatë mësimdhënies e kombinuar me përdorimin e metodave që pëlqehen nga nxënësit, ka një ndikim të drejtpërdrejtë në motivimin e nxënësve, duke e parë këtë si një element kyç për të nxitur pjesëmarrjen dhe interesin e tyre. Një përqindje të ndjeshme, 27%, e mendojnë këtë të vërtetë vetëm “Ndonjëherë”, që tregon një njohje të ndikimit të tyre dhe matje efektive. Vetëm një minoritet i vogël, 4%, mendojnë se sjellja e tyre si mësimdhënës “Asnjëherë” nuk ndikon në motivimin e nxënësve, duke sugjeruar se ata mund të besojnë se faktorë të tjerë janë më të rëndësishëm për angazhimin e nxënësve dhe jo përdorimi i metodave të duhura. Përgjithësisht, grafiku tregon se studentët e vlerësojnë lart ecurinë metodike dhe qasjen e tyre gjatë mësimdhënies si elemente vendimtare për të nxitur

një mjedis mësimor pozitiv dhe të frytshëm.

**Grafiku 4: Ndikimi i performancës së studentëve në motivimin e nxënësve.**



## KONKLuzionET

Shpresa e vërtetë mbi reformimin dhe zhvillimin e shkollës janë pikërisht nxënësit. Ata kanë një interes dhe dëshirë që shkolla të funksionojë dhe mendojë për të ardhmen ndryshe nga të rriturit. Kanë një imagjinatë që i lejon t'i shohin gjërat ndryshe, të pandikuar nga procesi formal i edukimit. Nxënësit janë duke kërkuar të përfshihen në procesin e ndryshimit të shkollës dhe të marrin më tepër përgjegjësi në mjedisin e tyre. Nga pyetësorët me studentët vihet re se mësuesi luan një rol të rëndësishëm, ky i fundit orienton nxënësit, i vëzhgon ata, si dhe është i përfshirë gjatë gjithë kohës në bashkëbisedim dhe bashkëpunim me ta. Pra sot po i kushtohet shumë rëndësi përdorimit të metodave të mësimdhënies me në qendër nxënësin. Bashkëpunimi nxënës-mësues është kusht i mbarëvajtjes së mësimdhënies dhe krijimit të lehtësirave në punën dypalëshe. Duke i bërë një analizë të hollë studimit të realizuar me studentët, mund të arrijmë në disa përfundime:

-Kurrikula e re krijon hapësira dhe mundësi për përdorimin nga ana e studentëve të metodave të larmishme në orën mësimore, duke i dhënë mundësi mësuesit që të realizojë orë sa më efektive në procesin mësimor. Përdorimi i tyre dhe përshtatja sipas temave mësimore rrit mundësinë për bashkëpunim e bashkëveprim midis mësuesve dhe nxënësve.

-Mësimdhënia e mirë vjen nga përdorimi i metodave dhe strategjive të mira, të cilat evoluojnë me kalimin e kohës, ashtu si dhe vetë njerëzimi. Për të ushtruar të nxënit në bashkëpunim kërkohet të zhvillohen më tepër trajnime, të orientuara këto nga universiteti, si dhe nga institucionet e tjera arsimore, me qëllim sigurimin e menaxhimit

efektiv të kohës në dobi të nxënësve.

-Të zhvillohen shkëmbime eksperiencash midis studentëve dhe mësuesve mentorë, qoftë në përdorimin e literaturave bashkëkohore për përdorimin e metodave të mësimdhënies, por dhe në gjetjen e ekuilibrave për të nxënë të një nivel më të lartë të të nxënësve, duke siguruar përdorimin e strategjive alternative në orët mësimore.

-Metodat aktive janë të domosdoshme për zhvillimin e një procesi mësimor efektiv dhe të suksesshëm. Ato janë forma të ndryshme të realizimit të mësimin dhe për këtë ato e “zhduk” monotoninë në klasë dhe krijojnë një pjesëmarrje aktive të nxënësve në orën e mësimin, duke siguruar ndjenjë të lartë vetëbesimi të studentët në menaxhimin efektiv të klasës, pasi nxënësit mërzojnë nga veprimet rutinë dhe të njëjta.

-Mësuesit dhe nxënësit kanë një marrëdhënie shumë të mirë mes tyre, dhe kjo vjen si rezultat i shpjegimit të mirë që mësuesi bën. Kjo, sepse, ai përdor metoda të larmishme të mësimdhënies, të cilat mundësojnë rritjen e përqendrimit të nxënësit dhe zhvillimin e aftësive të shumta tek individit nxënës, por dhe tek njeriu i së ardhmes. Kjo e gjitha realizohet nëpërmjet rritjes së performancës së mësuesit, duke siguruar efektivitetin në mësimnxënje.

Institucione të ndryshme arsimore të mobilizohen më shumë për nxitjen e përdorimit të metodave aktive në mësimdhënje, nëpërmjet organizimit dhe zhvillimit të më shumë trajnimeve dhe manualeve ndihmëse për mësuesit.

Studenti mësues duhet që gjithmonë të përdorë ato metoda aktive, të cilat janë efektive në punën me nxënësit e tij, që do të thotë se duhet të përshtasë metoda me nivelin e nxënësve. Ai duhet të ketë parasysh strategjitë alternative që do të përdorë me nxënësit, të ketë besim tek aftësitë e nxënësve të tij dhe të bashkëpunojë me ta për t’i motivuar ata në realizimin sa më të mirë të procesit mësimor.

Studentët e vlerësojnë praktikën profesionale si një domosdoshmëri në formimin profesional të tyre. Përfundimet e ndalojnë tri pika kyçe të procesit të përdorimit të metodave bashkëkohore të mësuesve të rinj gjatë praktikës profesionale: a) pajisjen e studentëve me kompetenca profesionale teorike dhe praktike si refleksion i përdorimit të metodave bashkëkohore, b) fuqizimin e marrëdhënieve profesionale midis eksperiencës së mësuesve mentorë dhe njohurive akademike të studentëve praktikantë dhe c) krijimin e një komuniteti aktiv të të gjithë aktorëve që përfshihen në realizimin e praktikave profesionale.

Të ketë sa më shumë bashkëpunim mes studentëve gjatë praktikës profesionale, duke siguruar komunikim profesional dhe dëshirën për të

përcjellë pozitivisht te nxënësit e tyre, aftësitë që zotërojnë në përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies.

## BIBLIOGRAFIA

- Alsarawi, A., & Sukonthaman, R. (2021) Pre-service teachers' attitudes, knowledge, and self-efficacy of inclusive teaching practices. *International Journal of Disability, Development and Education*. Advance online publication. <https://doi.org/10.1080/1034912X.2021.1922992>
- Ambrosetti, A. (2010). Mentoring and learning to teach: What do pre-service teachers expect to learn from their mentor teachers? *International Journal of Learning*, 17(9), 117-132. <https://doi.org/10.18848/1447-9494/CGP/v17i09/472>
- Bandura, A. (1994). Self-efficacy. In V. S. Ramachaudran (Ed.), *Encyclopedia of human behaviour*. Academic Press.
- Bandura, A. (2008). An agentic perspective on positive psychology. In S. J. Lopez (Ed.), *Praeger perspectives. Positive psychology: Exploring the best in people*, Vol. 1. Discovering human strengths (pp. 167–196). Praeger Publishers/Greenwood Publishing Group.
- Bandura, A. (2012). On the functional properties of perceived self-efficacy revisited [Editorial]. *Journal of Management*, 38(1), 9-44. <https://doi.org/10.1177/0149206311410606>
- Charles Temple, Alan Crawford, Wendy Saul, Samuel R. Mathews, James Makinster, (2006) *Strategji të mësimdhënies dhe të të nxënës për klasat mendimtare*.
- Dean. C. B., Hubbell. E.R., Pitler. R., Stone. B., (2012), *Classroom Instruction That Works: Research-Based Strategies for Increasing Student Achievement*, 2nd Edt., New York.
- Fullan, M., (2011), *Revista Pedagogjike*.
- Fuller, F., & Bown, O. (1975). Concerns of teachers: A developmental conceptualization. *American Educational Research Journal*, 6, 207–226.
- Jacobsen. D. A., Eggen. P., Kauchak. D., (2005), *Methods for teaching: Promoting student learning in K-12 classrooms*, 7th Edt., Columbus, Ohio, Pearson.
- Musai, B., (2021), *Mësimdhënia dhe të nxënësit ndërveprues*, Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë.
- Musaj. B., (2003), “Metodologjia e Mësimdhënies”. Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë.
- Ozonur, M. (2021). Determining pre-service teachers' levels of self-efficacy and occupational anxiety. *Education Quarterly Reviews*, 4(1), 607-616. <https://doi.org/10.31014/aior.1993.04.02.270>
- QTKA, Qendra e trajnimit dhe kualifikimit për arsimin, “Mësimdhënia me në qendër nxënësin”. Tiranë, 2005.
- Rupp, D., & Becker, E. S. (2020). Situational fluctuations in student teachers' self-efficacy and its relation to perceived teaching experiences and cooperating teachers' discourse elements during the teaching practicum. *Teaching and Teacher Education*, 99, 1-17. <https://doi.org/10.5167/uzh-196876>
- Woolfok, A., (2011). *Psikologji e Edukimit*. Botimi i njëmbëdhjetë (*Educational Psychology, Eleventh edition*, 2010). Botuar: Qendra për Arsim Demokratik.
- Zwiers, J., (2005). *Zhvillimi i shprehjeve të menduarit në shkollë*. Botuesi: Bardhyl Musaj nga Qendra për Arsim Demokratik.

## VLERAT E LIQENIT TË SHKODRËS NË FOKUSIN E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Lulzime Dhora<sup>1</sup>, Dritan Dhora<sup>2</sup>

<sup>1</sup>Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi“, Qendra e Studimit të Ujërave të  
Rajonit të Shkodrës

<sup>2</sup>Agjencia Rajonale e Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës

### ABSTRAKT

Në këtë artikull jepen për shkollarët 21 karakteristika të liqenit të Shkodrës, si dhe disa përfundime dhe detyra konkrete që kanë të bëjnë me njohjen dhe menaxhimin e liqenit të Shkodrës. Materiali bazë i marrë nga botimet shkencore të kohëve të fundit është përshtatur për shkollarët, duke e redaktuar, përmbledhur, renditur dhe thjeshtuar në problematikë, shpjegime dhe terminologji.

**Fjalët kyç:** liqeni i Shkodrës, ekosistem, habitat, biodiversitet, menaxhim.

### Basic knowledges on the Lake Shkodra for schoolars

### ABSTRACT

In this article, 21 characteristics of the Lake Shkodra are given to schoolars, as well as some conclusions and concrete tasks related to the recognition and management of the Lake Shkodra. The basic material taken from recent scientific publications has been adapted for schoolars, by editing, summarizing, ordering and simplifying in issues, explanations and terminology.

**Keywords:** Lake Shkodra, ecosystem, habitat, biodiversity, management.

### 1. Hyrje

Liqeni i Shkodrës konsiderohet si një prej liqeneve të mëdhenj, me origjinë karstike, më të njohur në Rruzullin Tokësor. Njihen mbi 2 mijë botime të bëra për këtë liqen gjatë historisë njerëzore.

Njohja dhe menaxhimi i çdo liqeni duhet të bëhet në përshtatje me karakteristikat e tij. Ndonëse prej shekujve janë bërë botime të shumta për këtë liqen nga studiues shqiptarë dhe të huaj, deri vonë nuk ka ekzistuar ndonjë studim dhe botim i veçantë mbi karakteristikat e tij.

I pari botim i veçantë i plotë për karakteristikat e liqenit të Shkodrës është bërë nga Dh. Dhora në vitin 2016.

Në vitin 2022, po ky autor, shtoi edhe disa karakteristika të tjera të lidhura me një koncept të ri për njohjen e liqenit të Shkodrës në përshtatje me vetërregullimin, stabilitetin dhe resiliencën, dinamikat, komponentët kryesorë përgjegjës për stabilitetin e qëndrueshëm në alternativën që e karakterizon, si dhe formuloi detyrat për menaxhimin e liqenit në përshtatje të këtij koncepti.

Një prej problemeve më të mëdha që konstatohet në lidhje me liqenin është njohja e kufizuar që njerëzit kanë për të, ndërkohë që për liqenin duhet të mendojnë dhe të punojnë të gjithë banorët e Shkodrës dhe përreth tij.

Në përpjekje për të zgjuar interesin e popullit, menduam që të përgatisim dhe botojmë këtë artikull për liqenin e Shkodrës, posaçërisht për shkollarët, të cilët vetë ose të organizuar në procesin mësimor dhe edukativ të shkollës, do ta mësojnë me dëshirë. Ky punim është edhe në përputhje me objektivat e Kornizës Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar në Shqipëri (MAS, 2014) ku një vëmendje e veçantë i jepet njohurive të nevojshme për mbrojtjen e mjedisit dhe theksohen kompetencat kyçe përfshirë kompetencën për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Shkollarët janë armata më e organizuar dhe më e rëndësishme që kemi dhe që premtan për sot dhe për të ardhmen.

## **2. Metodologjia**

Shpjegimi i karakteristikave të liqenit të Shkodrës dhe menaxhimit të tij në një koncept të ri, me pikësynim që të sigurohet stabiliteti i qëndrueshëm në alternativën që e karakterizon, është bazuar kryesisht tek DHORA, D. (2014), DHORA, DH. (2016, 2020, 2022), DHORA, DH. et al. (2016), DHORA, L. (2021, 2023), MARIĆ (2018), GROUP AUTHORS 2001 (Editor: Kashta, L.), GROUP AUTHORS 2007 (Editor: Buscovic, V.), RAKAJ et al. (2015), si dhe shumë punime për probleme të veçanta ose të përgjithshme, që shënohen tek referencat.

Materiali i përgatitur është redaktuar, përmbledhur, renditur dhe thjeshtuar në problematikë, shpjegime, terminologji në përshtatje me moshën e shkollarëve.

### 3. Rezultate dhe diskutime

#### 3.1 Karakteristikat e liqenit të Shkodrës

##### *Ekosistem liqenor*

Liqeni i Shkodrës përmendet në histori si sistem lumor, ku liqeni ishte vazhdim i lumit Moraça, por edhe si sistem kënetor, përgjatë pjesës fushore të lumit.

Sot liqeni i Shkodrës përfaqëson një sistem liqenor, pra me një sipërfaqe të madhe ujore të përhershme. Ujërat e tij ripërtërihen relativisht ngadalë, krahasuar me lumenjtë; lëvizjet e ujit, që shkaktohen prej erërave dhe nxehtësisë, nuk janë njëdrejtimëshe.

##### *Pozitë gjeografike mjaft interesante*

Liqeni i Shkodrës ndodhet në koordinatën gjeografike 42° 10' të gjerësisë gjeografike veriore dhe 19°15'të gjatësisë gjeografike lindore, sipas Grenviçit.

Liqeni i Shkodrës ndodhet në kontinentin e Evropës, i cili ka rol të rëndësishëm në zhvillimet globale.

Liqeni i Shkodrës ndodhet në Nënrajonin e Mesdheut, ndër më interesantët në gjerësinë e vet gjeografike.

Liqeni i Shkodrës ndodhet në gadishullin e Ballkanit, i cili përfaqëson një prej sipërfaqeve refugjiale më të mëdha të Evropës.

Liqeni i Shkodrës përfshihet në Pellgun e detit Adriatik, një prej deteve më interesante të Mesdheut.

Liqeni i Shkodrës, si dhe gjithë ujërat e Shqipërisë, bën pjesë në Rajonin ujqor zoogeografik të Adriatikut Jugor – Jonian, me karakteristika të veçanta.

##### *Origjinë tektonike – karstike*

Liqeni i Shkodrës është formuar prej zhvillimeve tektonike dhe zhvillimeve të fuqishme karstike.

Lëvizja zbritëse e bllokut mbi të cilin është liqeni i Shkodrës filloi në përfundim të Paleogjenit dhe fillim të Neogjenit. Këto dukuri janë në zhvillim edhe sot. Mendohet se lëvizja zbritëse kompensohet me ngritjen prej mbushjes nga prurjet e ngurta.

##### *Liqeni i Shkodrës është liqeni më i madh në Ballkan*

Liqeni i Shkodrës, me sipërfaqe përafërsisht 360 – 540 km<sup>2</sup>, përfshihet në grupin e liqeneve të mëdhenj të Rruzullit Tokësor (100 – 10.000 km<sup>2</sup>).

Liqeni i Shkodrës është liqeni më i madh në gadishullin e Ballkanit.

Liqeni i Shkodrës së bashku me lumenjtë Moraça, Buna, Drini etj., si dhe liqenin e Ohrit, të Prespës së Madhe dhe Prespës së Vogël, që shtrihen në

katër shtete të Ballkanit Perëndimor, përbëjnë një kompleks hidrologjik që derdh ujin nëpërmjet lumit Buna në detin Adriatik.

#### *Pellgu Ujëmbledhës*

Pellgu Ujëmbledhës i liqenit të Shkodrës ka sipërfaqe të konsiderueshme, prej 5490 km<sup>2</sup>.

Liqeni i Shkodrës është liqen fushor, por furnizohet me ujë nga lartësitë me shumë reshje, që llogariten në 2500 – 3100 mm shi në vit dhe ky është një faktor tjetër i qëndrueshmërisë së prurjeve ujore në liqen. Lartësia mesatare mbi nivelin e detit e Pellgut Ujëmbledhës të liqenit të Shkodrës është 770 m.

Uji vjen në Liqen nëpërmjet lumenjve, përrenjve, burimeve të ndryshme etj. Vetëm lumi Moraça sjell në liqen 210 m<sup>3</sup>/sek ose rreth 62% të krejt prurjeve.

#### *Stabilizues hidrologjik*

Lumi Drini derdhet në lumin Buna në rreth 1.5 km nga dalja prej Liqenit. Liqeni i Shkodrës funksionon si stabilizues i shkëlqyer hidrologjik. Kur Drini sjell pak ujë, Liqeni derdh lirshëm ujin e tij në lumin Buna. Përkundrazi, kur Drini sjell furishëm ujë, pengohet rrjedhja normale e lumit Buna, pra pengohet derdhja e ujit të Liqenit në lumin Buna, për pasojë Liqeni zhvillohet duke rritur nivelin, sipërfaqen dhe vëllimin e tij.

#### *Kriptodepresion i rrallë*

Liqeni zë pjesën më fundore të Ultësirës të Zeta – Shkodrës. 165 km<sup>2</sup> e sipërfaqes së liqenit të Shkodrës, çka i takon rreth 44,3 % e sipërfaqes minimale të pasqyrës së tij, ka fundin nën nivelin e detit. Kjo dukuri e karakterizon liqenin si një kriptodepresion (basen i thellë, me fundin e “fshehur”, nën nivelin e detit) të rrallë në Evropë dhe në gjithë Rruzullin Tokësor.

#### *Arqipelag unikal në Evropë*

Në pjesën perëndimore, prej daljes së Bunës e deri në Kepin e Radushës, bregu është përgjithësisht shkëmbor. Ka shumë gjire, kepe dhe ishuj të shumtë, që kanë interes studimi nga pikëpamja gjeologjike, gjeografike dhe ekologjike. Arqipelagu prej 53 ishujsh pranë brigjeve perëndimore është unikal në Evropë. Ishujt lozin rol të rëndësishëm në biologjinë e liqenit, pasi janë mjedise relativisht të izoluara, me bimësi interesante, strehë dhe vende riprodhimi për shpendët dhe kafshët e tjera.



*Liqen subtropikal, ekosistem me zhvillime stinore*

Temperaturat mesatare nga janari në gusht ndryshojnë me rreth 20° C. Shumë rrallë temperatura e ujit ka zbritur nën 0° C. Ky regjim temperature e karakterizon Liqenin si subtropikal.

Liqeni i Shkodrës karakterizohet nga luhatje stinore të mëdha të nivelit të ujit, që shkojnë deri në rreth 5 metra. Ekosistemi e ka të domosdoshme këtë luhatje, brenda kufijve të pranueshëm, minimalë dhe maksimalë.

Me ardhjen e stinëve të ngrohta dhe uljen e nivelit të ujit, zhvillohet bimësia ujore, ndodh riprodhimi i gjallesave, migrimi biologjik etj.

Me ardhjen e stinëve të ftohta, kur niveli i ujit rritet deri në nivelin maksimal, ekosistemi zhvillohet me kahje të kundërt. Kafshët gjejnë strehët e sigurt për dimërim ose migrojnë. Sa vjen vjeshta ndodh kalbëzimi i bimësisë. Masa e kalbur shpërndahet në sedimentin e krejt liqenit dhe një pjesë e madhe ikën nëpërmjet lumit Buna për në det.

*Mjedis i karakterit litoral (bregor)*

Cektësia është karakteristikë e liqenit. Cektësia dhe luhatjet e nivelit të ujit e bëjnë të pamundur zhvillimin e zonave vertikale të liqenit. Ky Liqen konsiderohet thjesht si mjedis i cekët, i karakterit litoral.

*Kompleks habitatesh*

Liqeni i Shkodrës përbëhet nga tre sisteme habitatesh: sistemi liqenor, sistemi kënetor, sistemi lumor.

Sipas stinëve liqeni i Shkodrës zhvillohet prej një kompleksi habitatesh të sistemit liqenor në një kompleks habitatesh të sistemeve liqenore – kënetore. Bregu i Liqenit, gjatë stinëve të ngrohta spostohet drejt thellësisë, duke i lënë vendin sistemit të habitateve kënetore.

*Bollshmëri makrofitesh*

Makrofitet janë tipari më karakteristik i liqenit të Shkodrës. Në liqenin e Shkodrës njihen mbi 240 lloje bimësh ujore. Makrofitet e liqenit zhvillohen nga bregu drejt thellësisë, duke filluar prej shoqërimeve mbiujore, ku mbizotëron kallamishtja, tek shoqërimet me gjethe në sipërfaqe, si zambakët e ujit etj., dhe më tej në një larmi bimësh nënujore.

*Mbizotërojnë peshqit e familjes së krapit*

Lista e peshqve të liqenit të Shkodrës përmban 52 lloje. Familja e krapit ka 25 lloje, ose 48 % të totalit, çka konsiderohet përqindje e lartë. Në ujërat përreth janë gjetur 9 lloje të familjes së troftave (17.3 %).

Zënia e peshkut në liqenin e Shkodrës bazohet në tri grupe specimesh. Një vlerë të rëndësishme kanë për peshkimin dy speciet vendase: gjuca dhe krapit. Në grupin tjetër bëjnë pjesë llojet migruese për në det nëpërmjet

lumi Buna, ku më të rëndësishmit janë kubla, ngjala dhe dy qefujt. Grupi i tretë përfshin llojet që kanë hyrë vonë në liqen dhe këtu mund të përmendim karasin dhe sharmakun.

Biologjia e peshqve të liqenit të Shkodrës dhe peshkimi kanë tipare intriguese. Stoku i konsiderueshëm i peshqve kapet në syre ose disa vende të veçanta, ku dimëron. Riprodhimi i peshqve bëhet në të shumtën brigjeve. Rënia e popullatave të peshqve të tregut ka lidhje me veprimtarinë e njeriut, kryesisht me peshkimin e jashtëligjshëm.

#### *Larmi e madhe shpendësh*

Në liqenin e Shkodrës dhe pellgun e tij ujëmbledhës janë evidentuar 283 specie shpendësh, prej të cilëve 168 janë të habitateve ujore. Prej këtij numri, më tepër se gjysma janë folezuese. Në liqenin e Shkodrës gjendet dhe folezon lloji globalisht i rrezikuar, pelikani kaçurrel. Liqeni i Shkodrës plotëson kriterin e Ramsarit për numrin e çifteve folezuese të dallëndysheve së detit gushëbardhë dhe karabullakut të vogël.

Më shumë se 2/3 e numrit të përgjithshëm të llojeve të habitateve ujore janë shpend shtegtues. Liqeni i Shkodrës është ndër ekosistemet ujore më të rëndësishme në Evropë për dimërimin e shpendëve, me kapacitet të njohur prej rreth çerekmilioni individësh, duke plotësuar kështu kriterin e Ramsarit për numrin total të individëve. Numrin më të madh të individëve e përbëjnë bajukla, karabullakët, zhytërrat, disa rosorë, pulëbardhat etj. Rënia e numrit të llojeve dhe individëve ka lidhje kryesisht me ndikimin negativ të njeriut, në prishjen e regjimit ushqimor dhe shqetësimet e ndryshme.

#### *Faunë me endemizma*

Dukuria e endemizmit është më e theksuar tek disa grupe kafshësh të liqenit. Disa lloje molusqesh, të klasës Gastropoda, të liqenit shfaqin dukurinë e endemizmit. Gjithashtu 9 lloje gaforresh Amphipoda, që përbëjnë gati gjysmën e numrit total të specieve të këtij grupi në këtë liqen, janë endemike.

Një interes të veçantë paraqesin 20 lloje peshqish ose 38,5% e totalit të numrit të tyre, të cilat shfaqin dukurinë e endemizmit. Prej tyre 5 janë endemike të liqenit të Shkodrës, 4 specie janë endemike të ekosistemeve ujore të Shqipërisë, 5 specie janë endemike të Sistemit liqeni i Shkodrës – lumi Drini - liqeni i Ohrit, 4 specie janë endemike të Ballkanit Perëndimor, si dhe 2 specie janë endemike të liqenit me luhatje drejt veriut.

Tek bimët e larta, shpendët dhe tek një numër i madh grupesh të tjera, endemizmi shfaqet në nivelin e nënllujt.

*Përcaktimi i liqenit të Shkodrës*

Ndër liqenet e cekëta eutrofike (me shumë lëndë ushqyese) mund të ekzistojnë dy gjendje alternative. Liqenin e Shkodrës mund ta karakterizojmë qartazi, si liqen i cekët eutrofik, që i përket alternativës si një liqen i kthjellët dhe i mbizotëruar prej makrofiteve me rrënjë. Rritja masive e bimësisë së liqenit pengon riciklimin e lëndëve ushqyese prej sedimentit në ujë.

Përballë kësaj alternative të liqenit të Shkodrës ekziston alternativa tjetër, ajo e një liqeni të turbullt dhe të mbizotëruar prej fitoplanktonit (mikroskopik), që lejon riciklimin e lëndëve ushqyese prej sedimentit në ujë, çka pengon rritjen e makrofiteve me rrënjë.

*Me stabilitet dhe resiliencë të lartë*

Me stabilitet ekologjik kuptojmë aftësinë që ka një ekosistem për t'u kthyer në pozicionin e vet të ekuilibrit, pas një shqetësimi të përkohshëm. Ekosistemi ka resiliencën ekologjike, që mbron liqenin prej pamjaftueshmërisë së veprimeve menaxhuese, që merr shqetësime dhe realizon ndryshime, por duke ruajtur të njëjtat funksione, struktura, vetërregullime etj.

Faktorët që influencojnë për stabilitet dhe resiliencë të lartë të liqenit janë: luhatja e madhe e përmbajtjes së lëndëve ushqyese në liqen, zinxhirët ushqimorë relativisht me pak hallka, numri i madh i llojeve, veçanërisht i peshqve që transferojnë fosforin nga bregu në thellësi.

Makrofitet konsiderohen faktor kyç i stabilitetit. Ato prodhojnë lëndët ushqyese, shërbejnë si hallkë e zinxhirëve ushqimorë, janë habitatet më të rëndësishme për kafshët, janë faktorët frenues të riciklimit të nutrientëve (veçanërisht fosforit) nga sedimenti në ujë etj.

Resilienca e lartë mbahet prej variableve të ngadalta, si faktorët klimaterikë afatgjatë, marrëdhëniet ushqimore, strukturat e habitateve, prodhimi i lëndëve ushqyese dhe niveli i tyre në sediment etj. Makrofitet me rrënjë janë faktor variabël i ngadaltë që promovon resiliencë. Edhe mekanizmat që mbajnë cilësinë e ujit në parametra normalë mbahen nga resilienca,

*Tri përballje që rregullojnë cilësinë e ujit*

Normaliteti i cilësisë së ujit mbahet nga tri përballje ndërmjet faktorëve kryesorë të stabilitetit, të cilët janë: përmbajtja e lëndëve ushqyese në ujë përballë prodhimit humik në ujërat kënetorë; përmbajtja e lëndëve ushqyese në ujë përballë prodhimitarisë së pyjeve të bregut; strukturat e zinxhirit ushqimor që transferojnë fosforin prej ujërave të bregut në ujërat e thella

përballë mekanizmave që pengojnë riciklimin e fosforit prej sedimentit në ujë.

Cilët janë faktorët kërcënues të cilësisë së ujit?

Luhatjet e mëdha të nivelit të ujit janë faktorë destabilizues. Së bashku me prurjet e mëdha të ujërave, në liqen hyjnë edhe lëndë ushqyese dhe sedimente prej sipërfaqeve përreth tij.

Plehrat kimikë me fosfor dhe azot, që përdoren në bujqësi dhe që drenojnë nga pellgu ujëmbledhës për në liqen, janë një burim tjetër lëndësh ushqyese.

Si burim kryesor i prishjes së cilësisë së ujërave janë edhe derdhjet e ujërave të zeza direkt në liqen. Duhet shtuar se përmbajtje fosfori kanë edhe detergjentët që shkarkohen në liqen, së bashku me ujërat e zeza.

Duhet marrë parasysh edhe zhvillimet afatgjata, siç janë ndryshimet klimatike.

#### *Makrofitet, grupi funksional kryesor*

Makrofitet e Liqenit zhvillohen nga bregu drejt thellësisë, duke filluar prej shoqërimeve të zhytura pjesërisht në ujë, që vazhdojnë me shoqërimet me gjethë notuese, më tej në ato të zhytura krejtësisht në ujë dhe që shkojnë tek shoqërimet e thellësive më të mëdha.

Nëse abundanca e makrofiteve ulet përkohësisht, azoti dhe fosfori favorizojnë zhvillimin e algave kryesisht mikroskopike, çka çënon stabilitetin e zhvillimit të qëndrueshëm në alternativën e parë, të trajtuara më lart.

Luhatja e madhe e lartë e lëndëve ushqyese është faktor për stabilitet dhe resiliencë të lartë. Kjo luhatje e madhe ndodh si rrjedhojë e luhatjes së madhe të nivelit të ujit, i cili është refleks i zhvillimeve stinore hidrologjike, me maksimumin në muajt me reshje dhe minimumin në muajt e thatë dhe të nxehtë.

Në stinët e ngrohta në liqenin e Shkodrës prodhohet një biomasë kolosale makrofitesh ujore. Në fund të verës dhe vjeshtës kjo biomasë kalbet. Proceset e mëtejshme shkaktojnë shtim të lëndëve ushqyese me fosfor, azot etj. Ndryshimi nivelit të ujit nga minimal në maksimal ndihmon që kjo masë të shpërndahet në sedimentin e krejt liqenit, ku shërben për zhvillimin e makrofiteve dhe parruazorëve të vitit të ardhshëm, ndërsa një pjesë e biomasës ikën në rrugë sipërfaqësore nëpërmjet lumit Buna. Më tej, makrofitet, që zhvillohen në sipërfaqe të mëdha janë faktori kryesor pengues i riciklimit të lëndëve ushqyese, veçanërisht i fosforit, nga sedimenti në ujë, çka shkakton zbritjen e lëndëve ushqyese dhe kjo bën që në liqen të ketë vazhdimisht ujë të kthjellët.

*Peshqit, grup funksional i rëndësishëm*

Peshqit përbëjnë grupin funksional më të rëndësishëm që transferon mijëra tonë biomasë që përmban fosfor dhe lëndë të tjera ushqyese nga bregu në thellësi të liqenit.

Kompleksi i regjimeve ushqimore të peshqve të liqenit, që ndikon në ruajtjen e stabilitetit të liqenit, karakterizohet nga një strukturë bimore dhe detritike. Lloska, karasi, krapë, skorta etj., janë peshq bimëngrënës. Detriti, që prodhohet kryesisht prej kalbjes së bimeve, përbën bazën ushqimore për qefujt, karasin, njilen, mëlyshin dhe shumë parruazorë me të cilët ushqehen krapë, karasi, ngjala, mëlyshi, sharmaku etj.

Dobësimi i popullatave të peshqve të liqenit mund të sjellë destabilizimin e liqenit. Një dukuri e tillë konstatohet sot në popullatën e gjucës dhe njilës së liqenit.

Menaxhimi duhet të pikësojë në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit të peshqve të liqenit, sidomos të popullatave të peshqve kryesorë të tregut, që sigurojnë peshkim të qëndrueshëm.

*Ruajtja e habitateve është ruajtja e llojeve dhe popullatave*

Për menaxhimin e suksesshëm kërkohet të bëhet zonimi i sipërfaqeve në hartë. Zonimi i sipërfaqeve bazohet në konceptin e Rezervë Biosferës.

Në zonën kryesore, që kërkon mbrojtje të fortë ligjore për ruajtjen e biodiversitetit nga ndikimi njerëzor, përfshihen pyjet gjetherënës, si dhe shkurret në Zogaj (Tarabosh); habitatet ujore me funde zhavorri, rëre dhe çakëlli të liqenit të Shkodrës, nga Shiroka deri Zogaj, janë habitate të riprodhimit dhe strehimi të gjucës; sipërfaqet në livadhet e liqenit të Shkodrës, ato me vegjetacion floatues, me lloje të kërcënuara bimore, pyjet e brigjeve të liqenit etj., që janë habitate të rëndësishme për shpendët; ujërat e bregut të butë lindor, me bimësi të harlisur, ku ndodh riprodhimi i shumë specieve peshqish.

Në zonën tampon, që rrethon zonën kryesore dhe ku realizohen aktivitete që nuk pengojnë ruajtjen, si për hulumtimin e mjedisit, çlodhje dhe turizëm, përfshihen: sipërfaqja e ujit të liqenit, që është habitat i rëndësishëm për peshqit dhe shpendët, zona që përmytet dhe që përfshin ligatinat dhe livadhet mjaft interesante, qendrat e banuara, sipërfaqet e kultivuara, Mali i Taraboshit.

Në zonën e tranzicionit, ku promovohen praktikatat e menaxhimit të resurseve të qëndrueshme përfshihen sipërfaqja urbane e qytetit të Shkodrës dhe sipërfaqet përreth zonës së mbrojtur në përdorim intensiv.

Ruajtja e llojeve të rëndësishme në habitatet e jetesës, strehimit, riprodhimit dhe ushqimit është një punë e vështirë, aq më tepër kur numri i llojeve që

duhen mbrojtur sa vjen e rritet. Prandaj rruga më e sigurt dhe më efikase është të ecet sipas principit “ruajtja e habitateve është ruajtja e llojeve”.

Sipërfaqet e zonuara mund të përfshijnë një ose më shumë nivele të hierarkisë së habitateve. Këto reflektohen tek plani i menaxhimit të integruar të habitateve. Në këtë plan përfshihen, për shembull, masa për ruajtjen e qetësisë në brigje në kohën e riprodhimit të krapit dhe llojeve të tjera të peshqve, për ndalimin e përkohshëm të peshkimit, për ruajtjen e qetësisë dhe sigurimin e strehimit dimëror në burime (syre) dhe gjire, siç mund të themi: të Syrit të Sheganit, gjirit të Shirokës dhe gjirit të Zogajve, për gjucën etj.

### **3.2 Mbi ruajtjen dhe menaxhimin e liqenit të Shkodrës**

Dijet mbi identitetin, karakteristikat, stabilitetin dhe resiliencën, vetërregullimin, dinamikat dhe skemat funksionale, komponentët përgjegjës, problemet dhe situatat etj., të liqenit të Shkodrës, janë të nevojshme të njihen nga të gjithë të interesuarit, veçanërisht drejtuesit dhe ata që merren me menaxhimin e këtij ekosistemi. Me këto dije bindemi dhe bëhemi pjesëmarrës aktivë për reformimin e menaxhimit të Liqenit, me pikësynim që të sigurohet stabiliteti i qëndrueshëm, në alternativën që e karakterizon.

Prodhi i lëndëve ushqyese është dukuri vetërregulluese e ekosistemit të liqenit të Shkodrës. Kur këto lëndë hyjnë prej jashtë liqenit, si: derdhjet e ujërave të zeza, detergjentët me fosfor, plehrat fosforikë dhe azotikë, prurjet me ujë nga pellgu ujëmbledhës etj., vetërregullimi dhe stabiliteti çenohen dhe degradojnë. Prandaj ka rëndësi të theksohet nevoja e ndërtimit të impianteve të pastrimit të ujërave të zeza, që derdhen në lumenjtë Moraça dhe Buna.

Kompleksi i habitateve të liqenit të Shkodrës duhet menaxhuar sipas kriterëve bazë. Është e nevojshme të ndërtohet harta e habitateve ku të bëhet zonimi i sipërfaqeve të rëndësishme për ruajtjen e llojeve të kërcënuara, habitateve të riprodhimit, strehimit etj. Harta dhe të dhënat krijojnë mundësi për menaxhimin e integruar të habitateve.

Një aspekt jetik për forcimin e edukimit mjedisor në kontekstin lokal është bashkëpunimi i qëndrueshëm ndërmjet komunitetit shkencor dhe mësuesve të arsimit parauniversitar. Ndërsa studiuesit ofrojnë njohuri të thelluara mbi biodiversitetin, ekosistemet dhe ndikimet antropogjene në liqenin e Shkodrës, mësuesit kanë aftësinë për ta përshtatur dhe transmetuar këtë informacion në mënyrë të kuptueshme dhe edukative për brezat e rinj. Krijimi i urave lidhëse përmes trajnimeve të përbashkëta, projekteve të

orientuara drejt shkollës dhe përfshirjes së shkencëtarëve në aktivitetet arsimore mund të rrisë ndjeshëm cilësinë dhe ndikimin e edukimit mjedisor.

Monitorimi i faktorëve kryesorë të stabilitetit, vetërregullimit, dinamikës së zhvillimit dhe ripërtëritjes së makrofiteve, zhvillimit të qëndrueshëm të komunitetit të peshqve të liqenit të Shkodrës duhet të jenë si pikësnyime parësore në menaxhim. Si detyra kryesore të planit të menaxhimit të liqenit të Shkodrës mund të veçojmë:

- Të ngrihet grupi i monitorimit të liqenit të Shkodrës, në Shkodër nga Administrata e Zonave të Mbrojtura të Shkodrës dhe Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, si dhe në Malin e Zi nga drejtoria respektive e Zonës së Mbrojtur të liqenit të Shkodrës dhe Universitetit të Podgoricës, për të monitoruar liqenin nëpërmjet analizave kimike, bakteriologjike, llojeve indikatore, si dhe për të kontrolluar çdo javë krejt bregun e liqenit.
- Të parandalohen derdhjet e ujërave të zeza në liqen. Derdhjet e ujërave të zeza të Podgoricës në lumin Moraça dhe e ujërave të zeza të Shkodrës në lumin Buna, mbeten problemi më me rrezik për Liqenin, prandaj instancat shtetërore kompetente duhet ta shohin me përparësi ndërtimin e impianteve të pastrimit.
- Drejtoritë e Zonave të Mbrojtura në të dy anët e Liqenit të hartojnë plane të veçanta të përbashkëta të menaxhimit të sipërfaqeve të zonuara me objektiva dhe detyra konkrete, veçanërisht për ruajtjen e brigjeve në kohën e riprodhimit të peshqve dhe shpendëve. Të unifikohen harta e zonimit dhe detyrat vjetore për menaxhimin e krejt Liqenit. Kompleksi i habitateve të liqenit të Shkodrës duhet menaxhuar sipas kriterëve bazë, në mënyrë të integruar.
- Monitorimi i makrofiteve, i dinamikës së zhvillimit dhe ripërtëritjes së tyre, si dhe monitorimi i shoqërimeve bimore, duhet të jenë çështje parësore në menaxhim, që duhet të realizohet në bashkëpunim me specialistët botanistë më të kualifikuar. Për këtë duhen detajuar detyrat, si dhe të ruhen raportet dhe hartat për situatat dhe problemet e konstatuara.
- Instancat kompetente duhet që studimin e gjendjes së popullatave të peshqve të tregut dhe hartimin e planit të detajuar të zënies, t’ia besojnë institucioneve shkencore. Me akte shtetërore dhe rregullore duhet që licencimi i zënies së peshkut të organizohet i detajuar për çdo lloj. Zënia sipas licencës duhet vënë nën kontroll të vazhdueshëm, të dokumentuar zyrtarisht në çdo licencë dhe në statistikën shtetërore. Çdo peshkatar i licencuar duhet të shkarkojë peshkun e zënë në një prej pikave të

caktuara në breg. Administratorët duhet të shënojnë në fletoren e licencës sasinë e peshkut të zënë, sipas llojeve. Kur peshkatari ka realizuar zënien sipas licencës, administratori mbyll licencën për atë vit. Të gjitha këto kërkojnë akte ligjore dhe nënligjore, të cilat garantojnë zbatim të përgjegjshëm. Këto çështje duhet të unifikohen për të dy palët, pas diskutimit të përbashkët dhe miratimit nga të dy palët.

- Punonjësit e administratave të çdo niveli, si dhe punonjësit që kanë të bëjnë me ruajtjen ose shfrytëzimin e Liqenit, përfshi peshkatarrët etj., duhet të kualifikohen për një kohë të shkurtër, në mënyrë të organizuar për njohjen e liqenit të Shkodrës, problemet e tij, si dhe detyrat e veçanta të tyre.
- Menaxhimi duhet të përqendrohet tek realizimi i objektivave për shmangien e faktorëve kërcënues. Si të tillë përmendim situatën problematike të popullatave të peshqve dhe të peshkimit, luhatjet ekstreme të nivelit të ujit, pasojat e ngrohjes globale, erozionin, shkarkimin e ujërave të zeza dhe detergjentëve, përdorimin pa kriter të plehrave kimikë etj.
- Shpallja dhe menaxhimi i liqenit të Shkodrës si “Rezervë Biosferë Ndërkufitare” do të ishte rruga më e sigurt që do të sillte mbrojtje dhe zhvillim të qëndrueshëm. Ky hap do të zgjidhte gjithashtu mjaft nga problemet e sipërpërmendura. Është e nevojshme të bëhet një marrëveshje ndërkufitare mbi menaxhimin e integruar të liqenit të Shkodrës.
- Rishikimi i kompetencave mbi peshqit dhe peshkimin në Liqen, zgjidhja e problemeve financiare për detyrat që dalin jashtë sferës së një dikasteri etj., duhet të evidentohen dhe të ndiqen për t’u zgjidhur në instancat kompetente.

#### 4. KONKLUSIONE

Shkollarët janë grupmosha më e rëndësishme që do të kenë në dorë zhvillimin e vendit në të ardhmen. Njohja dhe edukimi kryesisht i shkollarëve të rajonit të Shkodrës, por edhe më gjerë, me disa dije bazë mbi liqenin e Shkodrës, si ekosistemi ujor ndoshta më i rëndësishmi në Gadishullin Ballkanik, do të ndihmojë në rritjen e ndërgjegjes publike dhe marrjes së njohurive të nevojshme nga ky brez për të iniciuar projekte apo fushata më të mëdha edukimi në këtë drejtim.

Njohja me karakteristikat kryesore të liqenit të Shkodrës është një nga bazat kryesore për ndërgjegjësimin dhe ndërmarrjen e veprimeve konkrete në drejtim të ruajtjes së këtij ekosistemi.



Kompleksi i habitateve dhe i gjithë liqeni i Shkodrës në tërësi duhen menaxhuar, sipas kriterëve bazë që ai prezanton. Kjo do të sigurojë një mbrojtje efektive dhe menaxhim të integruar të këtij burimi natyror.

Mësimdhënia e vendosur në kontekstin lokal (place-based learning) duhet të inkurajohet në mënyrë që liqeni i Shkodrës të përdoret si një laborator natyror për të konkretizuar temat e lidhura me mjedisin, biodiversitetin, zhvillimin e qëndrueshëm dhe trashëgiminë natyrore.

Metodat ndërdisiplinore dhe të të nxënësve aktiv duhet të zënë vend qendror në procesin mësimor, përmes projekteve me karakter kërkimor, punës në grup, vizitave në terren, dhe përfshirjes së aktorëve lokalë në jetën shkollore.

Hartuesit e kurrikulës duhet të rrisin përfaqësimin e trashëgimisë natyrore dhe ekosistemeve lokale në përmbajtjen e programeve mësimore, në mënyrë që të stimulohet një lidhje më e thellë e nxënësve me mjedisin përreth tyre.

Duhet të nxitet zhvillimi i moduleve zgjedhore dhe ndërlëndore që trajtojnë çështje të ruajtjes së liqenit të Shkodrës dhe të përdoren teknologjitë digjitale për të fuqizuar procesin mësimor, veçanërisht në shkollat e largëta nga zona e liqenit.

## 5. REFERENCA

- Bushati, N. (2013): Vlerësimi i cilësisë së ujërave të liqenit të Shkodrës dhe lumenjve Drini e Buna nëpërmjet analizave mikrobiologjike dhe fiziko-kimike (pjesa shqiptare). Disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor”. UT, Fak. Shkencave Natyrore, Dep. Biologjisë. Tiranë.
- CANU (1997): Prirodne vrijednosti i zaštita Skadarskog Jezera. Radovi Naucnog skupa, Podgorica 8 - 9 Novembar 1995), NS, Knjiga 44. Podgorica.
- CANU & ASHSH (2011): Skadarsko Jezero - Stanje i perspective / Liqeni i Shkodrës - Gjendja dhe perspektivat, I, II. Podgorica.
- Dhora, D. (2014): Shpendët e sistemeve të habitateve ujore të liqenit të Shkodrës dhe Pellgut Ujëmbledhës të tij. Birds of water habitat systems of the Lake of Shkodra and it's Catchment Area. Buletin Shkencor i USH “Luigj Gurakuqi”, Nr. 64, Seria e Shkencave të Natyrës, fq. 190-203.
- Dhora, Dh. (2016): Review of the characteristics of Shkodra Lake with a new vision. Buletin Shkencor USH “Luigj Gurakuqi”, Nr. 66, Seria e Shkencave të Natyrës, 97-113, Shkodër.
- Dhora, Dh. (2017): Karakteristikat e Kompleksit Hidrologjik të lumenjve Drini dhe Buna, si dhe liqeneve të Shkodrës, Ohrit, Prespës së Madhe dhe të Vogël. Florentia, 64 fq. Shkodër.
- Dhora, Dh. (2020): Listat e përditësuara të specieve të peshqve të ujërave të ëmbla të Shqipërisë. Buletin Shkencor USH “Luigj Gurakuqi”, Nr. 70, Seria e Shkencave të Natyrës, fq. 46-74. Shkodër.

- Dhora, Dh. (2022): Koncept i ri për njohjen dhe menaxhimin e liqenit të Shkodrës. Në: Shkencë dhe fantazi. Fiorentia. Fq. 28 – 55.
- Dhora, Dh., Mani (Beqiri), E., Bekteshi, A., Ulqini, D. (2009): *Euglena gracilis* Klebs 1883 në dy terrene ushqimore interesante. Bul. Shk. USh. “Luigj Gurakuqi”, Nr. 59, Seria e Shkencave të Natyrës, fq. 81-89.
- Dhora, Dh. & Rakaj, M. (2010): Lista e specieve të bimëve dhe kafshëve të liqenit të Shkodrës / List of plant and animal species of the Shkodra Lake. Camaj - Pipa. 95 pp.
- Dhora, Dh., Bekteshi, A., Rakaj, M. (2013): A new concept for recognizing of the eutrophication phenomenon in Lake of Shkodra. Buletin Shkencor i USh “Luigj Gurakuqi”, Nr. 63, Seria e Shkencave të Natyrës, fq. 66 - 84.
- Dhora, Dh., Dhora, D., Dhora, A. (2016): Liqeni i Shkodrës. Shtëpia botuese “Fiorentia”, Shkodër, 208 fq.
- Dhora, L. (2021): Situatat e popullatave të peshqve të tregut, që ndikojnë në stabilitetin e liqenit të Shkodrës, cilësinë e ujit dhe peshkimin e qëndrueshëm. Projekti: Vlerësimi i cilësive ekologjike (kimike, mikrobiologjike dhe biologjike) të ujërave të liqenit të Shkodrës sipas standardeve të BE-së. Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Instituti i Studimeve të Ujërave të Shkodrës.
- Dhora, L. (2023): Overview of the parameters serving for recognition, conservation and regeneration of Shkodra Lake. Twenty-ninth International Conference on “Social and Natural Sciences – Global Challenge 2023” (icsns xxix-2023), Stockholm, 20 September 2023, Book of proceedings, p. 117 – 123.
- Group Authors (Editor: Kashta, L.) (2001): Bibliography on Shkodra / Skadar Lake. REC Project: Promotion of networks and exchanges in countries of the South Eastern Europe. Shkodra & Podgorica.
- Group Authors (Editor: Buscovic, V.) (2007): Bibliography on Skadar / Shkodra Lake. REC Project: Transboundary cooperation through management of shared natural resources – Skadar Lake Site”, REC, financed by SDC.
- Karaman, G. & Beeton, A. (1981): The Biota and Limnology of Lake Skadar. Posebno izdanje (comp.). Biološki zavod Titograd & Smithsonian Institute Washington.
- Ministria e Arsimit dhe Sportit (2014): Korniza Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë. Tiranë.
- Pešić, V., Karaman, G. & Kostiano, A. G. (Editors) (2018): The Skadar / Shkodra Lake Environment. The Handbook of Environmental Chemistry. Vol. 80.
- Rakaj, M. & Kashta, L. (2010): The Threatened and Rare Plant Species of the Lake Shkodra – Delta Buna Hydrological System. BALWOIS 2010 - Ohrid, Republic of Macedonia - 25, 29 May 2010.
- Rakaj, M., Dhora, Dh. & Smajlaj, Rr. (2015): Habitatet dhe speciet më të rëndësishme të makrofiteve, peshqve, shpendëve etj., të liqenit të Shkodrës (pjesa shqiptare). Në kontekstin e Raportit të Projektit “Mbështetja e menaxhimit të qëndrueshëm afatgjatë të Liqenit Ndërkufitar të Shkodrës”. Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri.

## **DISIPLINA E GJEOGRAFISË DHE VENDI I SAJ NË KURRIKULËN MËSIMORE TË ARSIMIT TË MESËM TË ULËT DHE TË ARSIMIT TË MESËM TË LARTË**

Ylber Dylli, Dritan Rustja

*Shkolla Jopublike "Haxhi Sheh Shamia", Shkodër,  
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", departamenti i Gjeografisë*

### **ABSTRAKT**

Gjatë tri dekadave të fundit, me transformimin e jetës politike, ekonomike dhe shoqërore në Shqipëri edhe sistemi arsimor parauniversitar u përfshi në cikle ndryshimesh në nivel sistemi dhe përmbajtje. Ndryshimi i sistemit arsimor dhe korrektimi në përmbajtje nga ideologjizmat e sistemit komunist drejt një arsimi cilësor dhe demokratik përfshiu gjithashtu edhe lëndën e gjeografisë, e cila është një shkencë multidimensionale që studion tiparet fizike të tokës, dukuritë që ndodhin në të, mjediset jetësore dhe shoqërinë njerëzore dhe pavarësisht se është dinamike dhe gjithmonë në zhvillim, vihet re se ka një tendencë të ngushtimit të vendit të saj në kurrikulën arsimore parauniversitare. Gjeografia dhe gjeografi kanë vend për kontribut në shumë sfera të jetës sonë të përditshme dhe nuk duhet të mbeten të izoluar vetëm në aspektin mësimdhënës në nivelin parauniversitar dhe universitar. Gjeografët duhet të bashkohen dhe të marrin përsipër misionin për të qenë promotori i ndryshimeve në strukturë dhe përmbajtje të kurrikulës së lëndës së gjeografisë, duke e përshtatur me nevojat që sferat e ndryshme të shoqërisë kanë për ta. Janë pikërisht këto çështje dhe tematika që trajtohen më gjerësisht në këtë artikull.

**Fjalë kyçe:** Sistem parauniversitar, kurrikulë lëndore, reformë arsimore, mjete didaktike.

### **The discipline of Geography and its place in the curriculum of Lower Secondary Education and Higher Secondary Education**

### **ABSTRACT**

Over the past three decades, with the transformation of political, economic, and social life in Albania, the pre-university education system

has also undergone cycles of changes at both the system and content levels. The transformation of the educational system and the correction of content from the ideologies of the communist system towards a quality and democratic education have also included the subject of geography. Geography is a multidimensional science that studies the physical features of the earth, the phenomena that occur on it, the living environments, and human society. Despite being dynamic and ever evolving, there is a noticeable tendency for its place in the pre-university educational curriculum to be narrowed. Geography and geographers have a role to contribute to many areas of our daily lives and should not remain isolated only within the teaching aspect at the pre-university and university levels. Geographers should unite and undertake the mission of being the promoters of changes in the structure and content of the geography curriculum, adapting it to the needs that various spheres of society have for it. These are precisely the issues and topics that are more extensively addressed in this article.

**Keywords:** Pre-university system, curriculum content, educational reform, didactic tools.

## 1. Hyrje

Gjatë tri dekadave të fundit sistemi arsimor parauniversitar është përfshirë në një cikël ndryshimesh reformuese në nivel sistemi dhe në praktikën mësimore duke kaluar në katër faza:

*Faza e parë:* ajo e korrektimit të brendësisë së arsimit, që zgjati deri në vitin 1995. Gjatë kësaj faze u synua pastrimi i sistemit nga trashëgimia dhe ndikimet ideologjike komuniste, duke e çliruar kurrikulën nga manipulimet politike dhe deformimet.

*Faza e dytë:* përgatitjet për ndryshim, bazuar në ligjin Nr.7952, datë 21.06.1995 “*Për sistemin arsimor parauniversitar (1995-2000)*”.

Kjo fazë synonte përgatitjen e bazës ligjore për nevojën për ndryshimin e përgjithshëm duke analizuar cilësinë e kurrikulës dhe duke u njohur më mirë me përvojën dhe zhvillimet bashkëkohore. Këto ndryshime prekën strukturën e sistemit arsimor, kurrikulën dhe sistemet e menaxhimit. Zhvillimet e vitit 97-të në Shqipëri e shtynë përtej parashikimeve.

*Faza e tretë:* faza e reformimit të mëtejshëm të sistemit arsimor parauniversitar, bazuar në ligjin 69/2012, datë 21.06. 2012 “*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*”.

Në këtë fazë është synuar, që sistemi arsimor parauniversitar të ofrojë arsim demokratik, duke marrë parasysh kërkesat e parimeve themelore të barazisë së mundësive për arsim cilësor dhe të respektimit të dallimeve individuale.

*Faza e katërt:* hartimi i Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021 - 2026, e cila synon integrimin e arsimit parauniversitar dhe atë të lartë. Kjo strategji si objekt të saj ka koherencën e saj me objektivat strategjike të Kornizës së Edukimit dhe Trajnimit 2020 për bashkëpunimin midis vendeve të BE-së në fushën e arsimit dhe të formimit, me kuadrin e ri të BE-së për kompetenca kyçe të të nxënësve gjatë gjithë jetës, si dhe me OZHQ (Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm) të axhendës së vitit 2030 për zhvillim të qëndrueshëm.

Në vitin 2018, BE miratoi kuadrin e ri të kompetencave kyçe për të mësuarit gjatë gjithë jetës, si:

- a. Kompetencën e komunikimit dhe të të shprehurit;
- b. Kompetencën e të menduarit;
- c. Kompetencën e të menduarit për të nxënë;
- d. Kompetencën për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin;
- e. Kompetencën personale;
- f. Kompetencën qytetare;
- g. Kompetencën digjitale.

Sot, ky kuadër (arritjet e të nxënësve me kompetenca), është detyrim ligjor në arsimin parauniversitar shqiptar në bazë të ligjit 56/2015 të Nenit 2, pika 10 dhe Nenit 13, “kompetencat themelore”.

## **2. Lënda e gjeografisë gjatë reformave kurrikulare**

*Gjatë periudhës së reformës kurrikulare në sistemin arsimor parauniversitar gjeografia ka pësuar ndryshime, qoftë në strukturë, po ashtu dhe në përmbajtje.*

Gjatë fazës së parë ajo u përfshi nga pastrimi i përmbajtjes ideologjike, e cila nuk ishte e pakët në materialet lëndore të gjeografisë së periudhës komuniste. Për të krijuar një tablo dhe analizë më të qartë të ndryshimit të lëndës së Gjeografisë në AMU dhe AML kemi marrë në shqyrtim planin mësimor të lëndës së gjeografisë sipas kurrikulave në vite të ndryshme.

*Viti shkollor 1995-1996*

| Klasa | Orë/javore | Tematika                      |
|-------|------------|-------------------------------|
| 5-të  | 2          | Gjeog. fizike                 |
| 6-të  | 2          | Gjeog.fizike dhe e Shqipërisë |
| 7-të  | 2          | Gjeografi Bote                |
| 8-të  | 2          | Gjeografi e Shqipërisë        |
| 9-të  | 2          | Gjeografi fizike              |
| 10-të | 2          | Gjeografi e Botës             |
| 11-të | 2          | Gjeografi e Shqipërisë        |
| 12-të | 2          | -                             |

*Viti shkollor 1999-2000*

| Klasa | Orë/javore | Tematika                 |
|-------|------------|--------------------------|
| 5-të  | 1          | Gjeografi e përgjithshme |
| 6-të  | 2          | Gjeografi fizike         |
| 7-të  | 2          | Gjeografi Bote           |
| 8-të  | 2          | Gjeografi e Shqipërisë   |
| 9-të  | 2          | Gjeografi fizike         |
| 10-të | 2          | Gjeografi e Botës        |
| 11-të | 2          | Gjeografi e Shqipërisë   |
| 12-të | 2          | -                        |

Siç e shohim, nuk ka pasur ndryshime thelbësore në planin mësimor brenda 5-vjeçarit 1995-2000 në bazë të kurrikulës bazuar në ligjin Nr. 7952.

*Viti shkollor 2004 - 2005*

| Klasa | Orë/javore | Tematika                    |
|-------|------------|-----------------------------|
| 5-të  | 1          | Gjeografi e përgjithshme    |
| 6-të  | 2          | Gjeografi fizike            |
| 7-të  | 2          | Gjeografi Bote              |
| 8-të  | 2          | Gjeografi e Shqipërisë      |
| 9-të  | 2          | Gjeografi fizike            |
| 10-të | 2          | Gjeografi rajonet kulturore |
| 11-të | 2          | Gjeografi e Shqipërisë      |
| 12-të | 2          | -                           |

*Viti shkollor 2009 - 2010*

| Klasa | Orë/javore | Tematika                           |
|-------|------------|------------------------------------|
| 6-të  | 2          | Gjeog.fizike                       |
| 7-të  | 2          | Gjeografi e Evropës                |
| 8-të  | 2          | Gjeografi Bote                     |
| 9-të  | 2          | Gjeografi e Shqipërisë             |
| 10-të | 2          | Shkenca e Tokës                    |
| 11-të | 1          | Gjeografi e trashëgimisë kulturore |
| 12-të | 2          | Gjeografi e Shqipërisë             |

Në vitin 2004 - 2005 mbyllet cikli i kurrikulës së vjetër dhe zbatimi i asaj të resë për periudhën 2005-2012 duke kaluar nga arsimi i detyruar 8 - vjeçar në 9 - vjeçar.

Kurrikula e re solli ndryshime në strukturë dhe në përmbajtje. Arsimi i Mesëm i Ulët (AMU) përfshin klasat 6-9-të duke kaluar klasën e 5-të në ciklin fillor, ndërsa në Arsimin e Mesëm të Lartë (AML), kemi ndarjen e lëndëve sipas fushave dhe futet sistemi i krediteve, një orë mësimore javore e barasvlefshme me një kredit.

Me kurrikulën e re, lënda e gjeografisë do të bëhej nga 2 orë në javë, por risia është ndarja e gjeografisë së shteteve në dy vite studimi, në klasën e 7-të gjeografia e Evropës, ndërsa në klasën e 8-të gjeografia e Amerikës së Jugut, Azisë, Afrikës dhe Australisë.

Ndryshime më thelbësore pëson lënda e gjeografisë në AML, ku tani në klasën e 10-të bëhet lënda “Shkenca e Tokës”, e cila në vetvete është e ngjashme me Gjeografinë fizike të viteve paraardhëse. Risia tjetër është përfshirja e Shkencës së Tokës të fusha e lëndëve Shkencore, ndërsa gjeografia e klasave të 11-ta dhe 12-ta përfshihet të fusha e lëndëve Shoqërore.

Ndryshim pësoi struktura dhe përmbajtja e Gjeografisë së klasës së 11-të, e cila do të realizohej 1 orë në javë dhe njihet si “Gjeografia e Trashëgimisë Kulturore”.





Kjo kurrikulë me sistemin e krediteve dhe me këtë strukturë të njohurive gjeografike (Shkencë Toke & Gjeografi) në AML është zbatuar deri në vitin shkollor 2015-16.

Një risi tjetër është sistemi i teksteve alternative ose siç do të njihet ndryshe “Altertektst”, pasi u jepte liri stafeve akademike për të përzgjedhur tekstin që do të zbatoni në procesin mësimdhënës.


Reforma e kurrikulës së Arsimit Parauniversitar në Shqipëri u rishikua në vitin 2014 dhe vazhdon edhe sot.

| <i>Klasa</i> | <i>Ore /javore</i> | <i>Tematika</i>               |
|--------------|--------------------|-------------------------------|
| 6-të         | 1                  | Gjeografi tematike            |
| 7-të         | 2                  | Gjeografi fizike              |
| 8-të         | 2                  | Gjeografi rajonale botërore   |
| 9-të         | 2                  | Gjeografi e trevave shqiptare |
| 10-të        | 2                  | Gjeografi fizike              |
| 11-të        | 2                  | Gjeografi e Shqipërisë        |
| 12-të        | 4                  | Gjeografi rajonale botërore   |

*Disa tekste të lëndës së gjeografisë të përdorura në kurrikula gjatë viteve të ndryshme.*







(Foto. 1: burimi Y. Dyli)

Kurrikula e re me bazë kompetencat kyçe ka filluar të implementohet në vitin shkollor 2017-2018, duke sjellë reduktim të strukturës në gjeografinë e klasës së 6-të, e cila tani realizohet një herë në javë.

Gjithashtu ka ndryshuar edhe struktura e lëndës së gjeografisë në AML, pasi në vitin e tretë lënda e Gjeografisë zhvillohet katër herë në javë, por është lëndë me zgjedhje.

Kjo kurrikulë me bazë kompetence (të cilat i kemi trajtuar më lart) në trajtimin e materialit lëndor ka të veçantë se në planet mësimore ka lënë hapësira për punë praktike dhe projekte, të cilat nxisin tek nxënësi aplikimin e metodave të ndryshme të gjeografisë, si: hulumtimin, vëzhgimin, konstatimin, analizën, vlerësimin dhe qëndrimin qytetar ndaj dukurive negative të raporteve njeri - mjedis.

Sa për ta konkretizuar, ju prezantoj një model projekti nga lënda Gjeografi, klasa e 7-të,<sup>1</sup> me temë: “Çështje mjedisore të ujërave pranë vendbanimit tim”. Rezultatet e këtij projekti:

- Nxënësi arrin të diskutojë potencialet turistike, ekonomike, mjedisore;
- Hulumton mbi çështje mjedisore;
- Përcakton faktorët që shkaktojnë ndotjen;
- Identifikon zgjidhjet e mundshme;
- Vlerëson përfitimet dhe rreziqet e zgjidhjeve;
- Nxist interesim të moshatarët dhe komuniteti për të qenë aktiv në zgjidhjet e problemeve.

## 2. KONKLUSIONE

Gjeografia si shkencë ka karakter multidimensional në fusha të gjera studimi dhe kontributesh. Sot, ndikimi i gjeografisë, është prezent vetëm në nivel arsimor në shkolla, si lëndë mësimdhënie dhe në nivele akademike në punën shkencore të universiteteve.

Misioni i gjeografisë dhe i gjeografit për vetë dinamikat që kanë dukuritë gjeografike, që janë koherente dhe të vazhdueshme, është që ata duhet ta luajnë rolin e tyre të rëndësishëm edhe në institucione të tjera administrative dhe vendimmarrëse. Gjeografi duhet të jetë prezent në institucionet e menaxhimit të ujërave, në zyrat e bujqësisë, në klimatologji, në emergjencat civile, në drejtorinë mjedisore, në INSTAT, në menaxhimin e turizmit dhe agjencitë turistike etj.

Ndryshimi i kurrikulës në tërësi dhe të lëndës së gjeografisë në veçanti, krahas përmirësimit, ka evidentuar edhe mangësi. *Një nga mangësitë kryesore që vërehet është mungesa e mjeteve didaktike, si: harta apo makete në përputhje me kurrikulën e re, videoprojektorë, smartboard, etj.*

Konceptimi dhe trajtimi i materialeve lëndore mbi bazën e rajoneve apo ndarjet e reja administrative (rasti i Republikës së Shqipërisë) nuk është konkretizuar me harta të reja. Kjo përgjegjësi bie mbi institucionet përgjegjëse, të cilat nuk i kushtëzojnë shtëpitë botuese, që krahas botimit të teksteve mësimore të marrin përsipër edhe përpilimin e hartave respektive.

Mungesa e pajisjeve didaktike në funksion të mësimdhënies digjitale, si projektor dhe smartboard, janë të theksuara në shumë shkolla të vendit, si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale.

---

<sup>1</sup> Hoti. M., Ziu. M “Gjeografia 7”, botime Pegi, Ribotim 2022.

### 3. REKOMANDIME

Përmirësimi i programeve mësimore të lëndës së gjeografisë në nivel parauniversitar dhe jo vetëm, përbën sfidën e së ardhmes, që gjeografia të mos braktiset nga nxënësit dhe studentët dhe që gjeografi të thotë fjalën e tij në sektorë të ndryshëm të jetës ekonomike dhe shoqërore.

*Në funksion të përmbushjes së rolit të gjeografisë dhe misionit të saj, rekomandojmë:*

- Tekstet mësimore të hartohen në përputhje me moshën dhe kapacitetin e nxënësve, pasi shpesh ka material të panevojshëm.
- Shtëpitë botuese dhe hartuesit e teksteve të marrin përsipër botimin e mjeteve didaktike, si: harta, globe në përputhje me ndryshimet që ndodhin në kohë.
- Pajisjen e shkollave me internet dhe Smartboarde si nevoja imediate për një arsim bashkëkohor.
- Kualifikimin e mësuesve të gjeografisë më programet e GIS-it (Sistemit të Informacionit Gjeografik).
- Lënda e gjeografisë me zgjedhje në klasën e dymbëdhjetë t'i nënshtrohet një ndryshimi rrënjësor në përmbajtje, duke u larguar nga trajtimi i Gjeografisë regjionale të botës. Trajtimi i njohurive në grupe kapitujsh apo modulesh për klimatologjinë, hidrologjinë, pedologjinë, mjedisin, turizmin, menaxhimin e rreziqeve natyrore etj., do të nxiste interesin për gjeografinë në të gjitha nivelet e arsimit.
- Rritjen e “trysisë pozitive” ndaj institucioneve përgjegjëse që gjeografët të japin kontributin e tyre në shoqëri dhe të zënë vendin që u takon.

### BURIMET E SHFRYTËZUARA:

1. “Fletorja zyrtare e Republikës së Shqipërisë”, ligji nr. 69/2012, “Për ndryshime në ligjin nr.7952, për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.
2. “Fletorja zyrtare e Republikës së Shqipërisë”, ligji nr.56/2015, “Për ndryshime në ligjin nr. 69/2012 për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.
3. “Fletorja zyrtare e Republikës së Shqipërisë”, ligji nr.7952, datë 21.06.1995, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.
4. Dokumenti i strategjisë së zhvillimit të arsimit parauniversitar, Ministria e Arsimit dhe e Sportit, 2014-2020, Tiranë, 2014.

5. Hoti, Mahir, Ziu, Majlinda: “Gjeografia 7”, botime Pegi, 2022.
6. Strategjia e zhvillimit të arsimit parauniversitar në Shqipëri (2003-2013), Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë, 2003.
7. Strategjia Kombëtare e Arsimit 2004-2015, Ministria e Arsimit dhe e Sportit, Tiranë, 2014.
8. Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026, Ministria e Sportit dhe e Rinisë, Tiranë, prill 2021.
9. Strategjia kombëtare e arsimit parauniversitar 2009-2013, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Tiranë, korrik 2009.
10. Udhëzues për kurrikulën e re të gjimnazit për vitin shkollor 2010-2011, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Tiranë, 2010.
11. Udhëzues për zhvillimin e kurrikulës me zgjedhje në gjimnaz, Ministria e Arsimit, Sportit dhe e Rinisë, IZHA, Tiranë, 2018.
12. Udhëzues për zhvillimin e kurrikulës së re në arsimin e mesëm të ulët, Ministria e Arsimit dhe e Sportit, IZHA, Tiranë, 2017.

## **EKSPLORIMI I NDIKIMIT PEDAGOGJIK TË EDPUZZLE NË KLASAT ME MËSIM TË INTEGRUAR TË PËRMBAJTJES DHE GJUHËS – KUR CLIL BËHET DIGJITAL**

Gerda Sula, Merita Hoxha

*Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, departamenti i Pedagogjisë  
dhe Psikologjisë*

*Universiteti i Elbasanit Aleksandër Xhuvani, Fakulteti i Shkencave Humane,  
departamenti i Gjuhëve të Huaja*

### **ABSTRAKT**

Ky studim eksploron perceptimet dhe përvojat e mësuesve të shkollave të mesme në Shqipëri, të cilët implementuan Mësimdhënien e IntegrUAR të Përmbajtjes dhe Gjuhës (CLIL) në kombinim me mjetet digjitale, në mënyrë specifike EdPuzzle, në arsimin online të lëndëve të shkencave natyrore gjatë dhe pas pandemisë së COVID-19. Hulumtimi përqendrohet në kuptimin e ndikimit afatgjatë të këtyre metodologjive në praktikën mësimdhënëse dhe potencialit të tyre për përdorim të vazhdueshëm në një peizazh arsimor në ndryshim të vazhdueshëm. Një qasje fenomenologjike u përdor për të mbledhur të dhëna të thelluara përmes intervistave, duke kapur reflektimet e mësuesve mbi përfitimet, sfidat dhe mundësitë e ardhshme të integrimit të CLIL-së me mjetet e të mësuarit me bazë video. Rezultatet zbulojnë se mësuesit vunë re përmirësime të konsiderueshme në angazhimin, kuptimin dhe autonominë e nxënësve përmes përdorimit të CLIL-së dhe EdPuzzle. Megjithatë, ata theksuan gjithashtu sfida të lidhura me aksesin teknologjik dhe nevojën për zhvillim profesional të vazhdueshëm. Studimi konkludon se, megjithëse metodat inovative të mësimdhënies të promovuara gjatë pandemisë kanë potencial për përdorim të qëndrueshëm, suksesi i tyre varet nga mbështetja dhe përshtatja e vazhdueshme me kontekstin arsimor në Shqipëri. Rekomandimet përfshijnë integrimin e CLIL-së në dizajnin më të gjerë të kurrikulës, ofrimin e burimeve dhe trajnimeve për mësuesit, dhe hulumtime të mëtejshme mbi shkallëzueshmërinë e këtyre praktikave në ambiente të ndryshme arsimore.

**Fjalë kyçe:** Mësimdhënia e IntegrUAR e Përmbajtjes dhe Gjuhës (CLIL), arsimi online, perceptimet e mësuesve, EdPuzzle, arsimi i shkencave natyrore, Shqipëria, angazhimi i nxënësve, mjetet digjitale, mësimdhënia pas pandemisë, zhvillimi profesional.

### **Exploring the Pedagogical impact of EdPuzzle in Content Language Integrated classrooms – when CLIL goes digital**

#### **ABSTRACT**

This research explores the perceptions and experiences of secondary school teachers in Albania who implemented Content and Language Integrated Learning (CLIL) in combination with digital tools—specifically EdPuzzle—in online science education during and after the COVID-19 pandemic. The research focuses on understanding the long-term impact of these methodologies on teaching practices and their potential for continued use in an ever-evolving educational landscape.

A phenomenological approach was employed to collect in-depth data through interviews, capturing teachers' reflections on the benefits, challenges, and future opportunities of integrating CLIL with video-based learning tools. The findings reveal that teachers observed significant improvements in student engagement, comprehension, and autonomy through the use of CLIL and EdPuzzle. However, they also highlighted challenges related to technological access and the need for ongoing professional development.

The study concludes that while the innovative teaching methods promoted during the pandemic hold potential for sustainable use, their success depends on continued support and adaptation to the Albanian educational context. Recommendations include integrating CLIL into broader curriculum design, providing resources and training for teachers, and conducting further research on the scalability of these practices across diverse educational settings.

**Keywords:** Content and Language Integrated Learning (CLIL), online education, teacher perceptions, EdPuzzle, natural sciences education, Albania, student engagement, digital tools, post-pandemic teaching, professional development.

#### ***Hyrje***

Pandemia e COVID-19 shkaktoi një ndryshim të shpejtë dhe të përhapur në drejtim të të mësuarit online, duke detyruar mësuesit në të gjithë botën të përshtaten me shpejtësi. Në Shqipëri, ku qasjet tradicionale pedagogjike kanë qenë dominuese për një kohë të gjatë, kalimi në mësimdhënien në distancë, krijoi një mundësi të re për të eksploruar metoda inovative të mësimdhënies që mund të përmbushin disa sfida të

sistemit arsimor. Njëra prej këtyre metodave është Mësimdhënia e Integruar e Përmbytjes dhe Gjuhës (CLIL), e cila kombinon përmbytjen lëndore me të mësuarin e gjuhës, duke nxitur zhvillimin njohës dhe përmirësuar kompetencat gjuhësore të nxënësve përmes një qasjeje të zhytur dhe dygjuhëshe (Polishchuk et al., 2024). Kur kombinohet me mjetet digjitale si EdPuzzle—I, cili u lejon mësuesve të krijojnë përmbytje videointeraktive që stimulojnë të mësuarin aktiv,—CLIL paraqet një qasje premtuese për të ripërtëritur arsimin shqiptar.

Megjithatë, sistemi arsimor në Shqipëri përballet me sfida sistematike, duke përfshirë:

- Akses të kufizuar në teknologji,
- Mundësi të pabarabarta të zhvillimit profesional,
- Një kurrikulë që tradicionalisht ka prioritetizuar mësimin përmendësh në vend të të menduarit kritik dhe angazhimit (UNESCO, 2018).

Pavarësisht këtyre vështirësive, pandemia shërbeu si katalizator për integrimin e mjeteve digjitale dhe pedagogjive inovative, duke ofruar një kontekst unik për të studiuar efektivitetin dhe potencialin e tyre për adoptim afatgjatë.

Për shkak të pandemisë, arsimi në internet u bë një domosdoshmëri globale, duke sjellë sfida dhe mundësi të reja për arsimtarët. Një nga përgjigjet më inovative ndaj këtyre sfidave ka qenë integrimi i CLIL-së me mjete mësimore me bazë video, si EdPuzzle. Në mënyrë tradicionale, CLIL është përdorur në mjediset fizike të klasës, duke kombinuar të mësuarin e gjuhës me përmbytjen lëndore për të përmirësuar të dyja. Megjithëse efektiviteti i tij në klasat tradicionale është i dokumentuar mirë, aplikimi i tij në mjediset virtuale mbetet i paeksploruar mjaftueshëm.

Ky studim synon të mbushë këtë boshllëk duke hetuar ndikimin e CLIL-së dhe integritet të videos në arsimin online të shkencave natyrore, me fokus të veçantë në përvojat e mësuesve dhe nxënësve në Shqipëri. Qëllimi i tij është të sqarojë se si këto risi ndikuan në:

- Praktikën mësimdhënëse,
- Angazhimin e nxënësve,
- Rezultatet e të mësuarit.

Gjithashtu, studimi merr në konsideratë implikimet më të gjera për reformat arsimore në Shqipëri. Duke dokumentuar përvojat e këtyre mësuesve, ky hulumtim kontribuon në literaturën në rritje mbi potencialin e CLIL-së dhe mjeteve digjitale për të modernizuar arsimin në kontekste tradicionalisht konservatore, si dhe ofron njohuri rreth efektivitetit të këtyre metodave në:

- Rritjen e angazhimit të nxënësve,
- Përmirësimin e kuptimit,

- Nxitjen e autonomisë së tyre.

Në përgjithësi, ky studim hedh dritë mbi rrugën përpara për arsimin shqiptar, duke theksuar nevojën për mbështetje të vazhdueshme dhe përshtatje ndaj realiteteve në ndryshim.

### **Rishikimi i literaturës**

Integrimi i Mësimdhënies së Integruar të Përmbajtjes dhe Gjuhës (CLIL) në praktikat arsimore ka tërhequr vëmendje të konsiderueshme, veçanërisht si mjet për të përmirësuar njëkohësisht njohuritë specifike të lëndës dhe kompetencat gjuhësore. Kjo qasje, e cila kombinon të mësuarin e një lënde me përvetësimin e një gjuhe të dytë, është studiuar gjerësisht në ambiente tradicionale të klasës, me një theks të veçantë në ndikimin e saj në motivimin dhe angazhimin e nxënësve. Studimet e fundit kanë zgjeruar këtë eksplorim në mjediset virtuale, veçanërisht si përgjigje ndaj kalimit në të mësuarin online për shkak të pandemisë së COVID-19.

Në kontekstin shqiptar, vendimmarrja profesionale në fushat e psikologjisë dhe punës sociale shfaqet si një proces shumëfaktorësh, i ndërthurur nga dinamika psikologjike, sociale dhe ekonomike. Ky studim u zhvillua në Universitetin “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës me një kampion prej 60 studentësh, ku është ndërthurur korniza teorike e zhvillimit të karrierës me një qasje sasore empirike, me qëllim identifikimin e determinantëve kryesorë të zgjedhjes profesionale. Gjetjet sugjerojnë se motivimi i brendshëm zë rolin primar në këtë proces, pasuar nga konsideratat për mundësitë e karrierës. Faktori ekonomik, ndonëse në plan të dytë, shfaq një lidhje pozitive statistikisht domethënëse me motivimin e brendshëm, gjë që sfidon pritshmëritë klasike të teorisë së autodeterminimit dhe ngre pyetje mbi ndikimin e konteksteve socio-ekonomike në motivimin e individit. Këto rezultate nënvizojnë nevojën për politika të mirëstrukturuara mbështetëse, për reforma në orientimin profesional dhe për thellim kërkimor nëpërmjet metodave cilësore dhe kampioneve më të gjera e të larmishme.

**Fjalë kyçe:** profesion, motivimi i brendshëm, motivimi i jashtëm, psikologji, punë sociale.

**Career choice in psychology and social work:  
an analysis of psychological and socio-cultural factors**

### ABSTRACT

In the Albanian context, career decision-making in the fields of psychology and social work emerges as a multifaceted process, shaped by psychological, social, and economic dynamics. This study, conducted at the University of Shkodër “Luigj Gurakuqi” with a sample of 60 students,

integrates theoretical frameworks of career development with a quantitative empirical approach to identify the main determinants of professional choice. Findings suggest that intrinsic motivation plays a primary role in this process, followed by considerations related to career opportunities. Although economic factors appear secondary, they show a statistically significant positive correlation with intrinsic motivation, challenging classical expectations of self-determination theory and raising questions about the influence of socio-economic contexts on individual motivation. These results highlight the need for well-structured support policies, reforms in career guidance systems, and further research through qualitative methods and broader, more diverse samples.

**Keywords:** profession, personal motivation, external motivation, psychology, social work.

### ***Hyrje***

Interesi për të studiuar faktorët që ndikojnë në zgjedhjen e profesionit nga studentët e psikologjisë dhe punës sociale ka ardhur si rezultat i rritjes së dukshme të kërkesës për profesionistë të shëndetit mendor dhe mirëqenies sociale, veçanërisht në kontekste si ai shqiptar, ku nevoja për mbështetje psikologjike dhe sociale në komunitet është në rritje. Megjithatë këto profesione po fitojnë rëndësi gjithnjë e më të madhe në shoqëri, shpeshherë ato perceptohen si profesione “ndihmëse” dhe jo gjithmonë si zgjedhje të favorshme për përfitim ekonomik apo status social të lartë.

Në Shqipëri, karriera në psikologji dhe punë sociale shpesh perceptohet si një thirrje më shumë sesa si një investim ekonomik. Stereotipet shoqërore, mungesa e politikave mbështetëse dhe kufizimet në tregun e punës janë faktorë që ndikojnë drejtpërdrejt në këtë zgjedhje. Studentët përballen me një realitet ku pasioni për ndihmën sociale mund të mos shoqërohet me siguri financiare apo rritje të shpejtë profesionale. Megjithatë, për disa individë, këto profesione përfaqësojnë një mënyrë për të realizuar vlerat personale dhe për të ndikuar pozitivisht në komunitet.

### **Pyetjet kërkimore**

1. Cili është faktori kryesor që ndikon në zgjedhjen e profesionit nga studentët e psikologjisë dhe punës sociale në Universitetin “Luigj Gurakuqi”?
2. Në ç’mënyrë ndikojnë faktorët ekonomikë dhe perceptimet për mundësitë profesionale në zgjedhjen e profesionit?

3. A mbështetet teoria e autodeterminimit (Deci & Ryan, 2000) tek zgjedhjet e studentëve të psikologjisë dhe punës sociale në Universitetin “Luigj Gurakuqi”?

### **Problematikat aktuale në kontekstin shqiptar**

Zgjedhja e profesionit në fushën e psikologjisë dhe punës sociale në Shqipëri ndikohet nga faktorë të ndryshëm që pasqyrojnë sfidat e mjedisit shoqëror, ekonomik dhe institucional. Megjithatë këto profesione po fitojnë rëndësi të shtuar për shkak të rritjes së nevojave për shërbime të shëndetit mendor dhe mirëqenie sociale, realiteti i punësimit dhe zhvillimit profesional në këto fusha mbetet i vështirë.

Së pari, mungesa e njohjes së plotë institucionale dhe sociale për rolin e këtyre profesionistëve paraqet një pengesë të konsiderueshme. Psikologët dhe punonjësit socialë shpesh nuk përfshihen në mënyrë të qëndrueshme në strukturat publike, si: shkollat, spitalet, qendrat komunitare apo strukturat e mbrojtjes sociale, duke e bërë të pasigurt zhvillimin profesional të tyre dhe duke kufizuar mundësinë për t'u afirmuar si profesionistë kyçë në sistemin social dhe shëndetësor të vendit.

Së dyti, stigma shoqërore ndaj shëndetit mendor ndikon drejtpërdrejt në perceptimin që ka publiku për profesionistët e këtyre fushave. Stigmatizimi i problemeve psikologjike jo vetëm që frenon kërkesën për ndihmë, por e vë në pikëpyetje dhe legjitimitetin e profesionit të psikologut apo punonjësit social në sytë e komunitetit, duke e bërë më të vështirë për të rinjtë të ndërtojnë një identitet profesional të qëndrueshëm në këto fusha. (Bracke, 2019 & Harrison, 2017)

Një tjetër problem madhor është mungesa e këshillimit profesional gjatë arsimit parauniversitar. Zgjedhja e degës universitare shpesh nuk mbështetet në një proces të informuar dhe të strukturuar, dhe kjo çon në vendime spontane ose të ndikuara nga presione të jashtme familjare dhe shoqërore. Kjo rrit gjasat që studentët të përballen me zhgënjim ose të ndërpresin studimet, për shkak të mungesës së përputhjes ndërmjet pritshmërive dhe realitetit profesional (Parola et al., 2024).

Mungesa e lidhjes së arsimit me tregun e punës vazhdon të jetë shqetësuese (European Training Foundation, 2022). Të rinjtë ndryshojnë shpesh statusin nga të punësuar në të papunësuar dhe anasjelltas, ata fillojnë karrieren kryesisht në punë me kualifikim të ulët që shpesh nuk kanë të bëjnë me diplomat e tyre (Haçkaj, 2015). Mundësitë për punësim në psikologji dhe punë sociale janë të pakta, shpesh të bazuara në projekte afatshkurtra dhe jo në struktura të mirëfillta institucionale. Puna në kushte

jo të sigurta, me kontrata të përkohshme dhe shpërblime të ulëta, ndikon negativisht në motivimin dhe angazhimin afatgjatë të profesionistëve të rinj. Për më tepër, presionet familjare dhe pritshmëritë shoqërore shpesh dekurajojnë të rinjtë për të ndjekur profesione që nuk lidhen drejtpërdrejt me fitimin ekonomik ose prestigjin shoqëror. Psikologjia dhe puna sociale, ndonëse të rëndësishme, nuk perceptohen si profesione “të suksesshme” në kuptimin tradicional, çka ndikon në vetëvlerësimin profesional të studentëve.

Së fundi, edhe vetë sistemi arsimor përballet me sfida të brendshme. Kurrikulat universitare shpesh nuk ofrojnë një lidhje të fortë ndërmjet teorisë dhe praktikës, ndërsa praktikat profesionale janë të kufizuara në kohë dhe cilësi. Kjo pamundëson zhvillimin real të kompetencave praktike dhe ndikon në përgatitjen e mangët të studentëve për realitetin e tregut të punës.

### **Lidhja me teoritë e zhvillimit të karrierës**

Sipas Dibabe et al., (2015), zgjedhja e profesionit është një proces kompleks që ndikohet nga balanca ndërmjet interesave personale, vlerave, mundësive në tregun e punës dhe kompetencave të individit. Në të njëjtën linjë, Carpenter dhe Foster (1977), i ndajnë faktorët në të brendshëm (interes personal dhe kënaqësi në punë), të jashtëm (pagesa dhe mundësitë për punësim), dhe ndërpersonalë (ndikimi i familjes, mësuesve dhe miqve). Këta faktorë konvergojnë me Teorinë e Tipave të Karrierës së Holland-it (1959, 1997), e cila sugjeron se njerëzit kërkojnë mjedise pune që përputhen me tiparet e tyre të personalitetit, duke ndikuar kështu në kënaqësinë dhe qëndrueshmërinë në karrierë.

Holland identifikoi gjashtë tipa themelorë: realist, hetues, artistik, social, ndërmarrës dhe konvencional (RIASEC). Në kontekstin e psikologjisë dhe punës sociale, individët që kanë tendencë drejt tipit Social dhe Artistik janë më të prirur të zgjedhin këto profesione, pasi ato lidhen me ndihmën ndaj të tjerëve, empatinë dhe kreativitetin në zgjidhjen e problemeve. Kjo përputhet me gjetjet e Csikai dhe Rozensky (1997), të cilët kategorizuan motivet për karrierë në punë sociale, si: altruiste, profesionale dhe eksploruese.

Në mënyrë specifike, Blome and Espvall (2023), theksojnë se zgjedhjet e studentëve të punës sociale ndërlidhen me motive altruiste, shqetësime profesionale dhe faktorë eksplorues. Ndërkohë, studime të tjera (Agarwala, 2008; Najar & Yousuf, 2019) kanë theksuar ndikimin e faktorëve, si: statusi shoqëror, pritshmëritë për karrierë, sfondi familjar dhe

shpërblimet ekonomike, të cilat përputhen me tipin Ndërmarrës apo Konvencional në modelin RIASEC. Ndërsa individët të tërhequr nga ndihma ndaj të tjerëve dhe që kanë vlera sociale të theksuara janë më afër tipit social, ata që ndjekin siguri ekonomike dhe rritje të qëndrueshme mund të jenë më të ndikuar nga faktorët e jashtëm dhe struktura e tregut të punës (Busque-Carrier et al., 2021).

Në përputhje me këtë teori, Karaca et al., (2016) dhe Hanson & McCullagh (1995), theksojnë rëndësinë e interesit personal, karakteristikave të personalitetit dhe përputhshmërisë me mjedisin e punës. Për më tepër, faktori i ndikimit të familjes, mësuesve dhe miqve, i përmendur nga shumë autorë, pasqyron dimensionin ndërpersonal të vendimmarrjes që lidhet ngusht me zgjedhjen e një profesioni me natyrë sociale dhe bashkëpunuese. Për më tepër, një studim i Karaca et al., (2016) tregoi se ndikimi i familjes, preferencat personale, struktura e personalitetit, potenciali për të ardhura, siguria në punë dhe mundësitë e karrierës, ndikojnë në zgjedhjen e profesionit të punonjësit socialë. Një studim i Hanson dhe McCullagh (1995) tregoi se studentët e punës sociale i vlerësuan faktorët për zgjedhjen e kësaj karriere nga më i larti tek më i ulëti, si: puna me njerëzit, sfidat dhe dinamika në punë, mundësitë e mira për punësim, kushtet e mira të punës, siguria në punë, statusi dhe prestigji, dhe më pas pagat e mira.

### **Lidhja me Teorinë Sociale-Kognitive të Karrierës (SCCT)**

Për të pasur një kuptim më të thelluar të faktorëve që ndikojnë në zgjedhjen e karrierës në këto fusha, është e rëndësishme të përfshihet Teoria Sociale-Kognitive e Zhvillimit të Karrierës (SCCT), e zhvilluar nga Lent, Brown dhe Hackett (1994). Kjo teori ndërtohet mbi parimet e teorisë së të mësuarit social të Bandura-s (1986) dhe sjell një model ndërveprues të vendimmarrjes në karrierë.

Vetefikasiteti: besimi që ka individ në aftësinë e tij për të kryer detyra specifike dhe për të pasur sukses në një fushë të caktuar. Pritshmëritë për rezultate: çfarë beson individ se do të fitojë nga ndjekja e një profesioni (p.sh.: përmbushje personale, stabilitet ekonomik, pranim shoqëror); qëllimet personale: objektivat konkrete që individ vendos për zhvillimin e tij profesional.

Një element dallues i kësaj teorie është fokusi në faktorët kontekstualë, të ndarë në:

- **Faktorë lehtësues** (si mbështetja familjare, mundësitë arsimore, shembujt pozitivë në rreth),

- **Barriera strukturore** (si mungesa e informacionit, paragjykimet gjinore, statusi social i ulët i një profesioni).

Në përmbledhje, literatura ekzistuese, ofron një kuadër teorik të pasur për të kuptuar kompleksitetin e faktorëve që ndikojnë në zgjedhjen e profesionit në fushat e psikologjisë dhe punës sociale. Teoritë klasike si ajo e Holland-it ndihmojnë në identifikimin e përputhshmërisë mes tipareve të personalitetit dhe mjedisit të punës, ndërsa qasja sociale-kognitive e SCCT thekson rëndësinë e vetefikasitetit, pritshmërive për rezultat dhe faktorëve kontekstualë në formësimin e zgjedhjeve profesionale. Në mënyrë të veçantë, literatura sugjeron se për studentët që zgjedhin këto profesione, motivet shpesh lidhen me vlera altruiste, dëshirë për ndihmë, ndikime ndërpersonale dhe sfida strukturore. Në kontekstin shqiptar, ku sfidat ekonomike dhe mungesa e njohjes institucionale janë të pranishme, kuptimi i këtyre faktorëve është thelbësor për hartimin e politikave mbështetëse dhe ndërhyrjeve që nxisin zgjedhje të informuara dhe të qëndrueshme në karrierë. Kjo përbën edhe bazën teorike për analizën empirike të këtij studimi.

## METODOLOGJIA

### Qëllimi i studimit

Ky studim ka si synim të eksplorojë faktorët psikologjikë dhe socio-kulturorë që ndikojnë në zgjedhjen e profesionit nga studentët e programeve të Psikologjisë dhe Punës Sociale në Shqipëri. Qëllimi kryesor është të evidentojë në mënyrë empirike se cilat janë shtysat kryesore që orientojnë vendimmarrjen profesionale të kësaj kategorie studentësh, si dhe të vlerësojë rolin e motivimit të brendshëm, faktorëve ekonomikë, ndikimit të jashtëm dhe perceptimit të mundësive profesionale në këtë zgjedhje.

### Hipotezat e studimit

1. Motivimi i brendshëm është faktori me ndikim më të lartë në zgjedhjen e profesionit tek studentët e psikologjisë dhe punës sociale në Universitetin “Luigj Gurakuqi”.
2. Motivimi i jashtëm ka ndikim më të vogël në vendimmarrjen profesionale të studentëve tek studentët e psikologjisë dhe punës sociale në Universitetin “Luigj Gurakuqi”.
3. Faktorët ekonomikë kanë ndikim në perceptimin për të ardhmen profesionale tek studentët e psikologjisë dhe punës sociale në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, por nuk janë vendimtare në zgjedhje.



4. Motivimi i brendshëm është i korreluar në mënyrë negative me faktorin ekonomik tek studentët në zgjedhjen e profesionit.

#### **Dizajni i kërkimit**

Ky studim mbështetet në parimet e metodologjisë sasiore, nëpërmjet një anketimi me pyetësorë. Analizimi i të dhënave të mbledhura synon të nxjerrë në pah rezultatet përshkruese, të cilat vlerësojnë në mënyrë statistikore hipotezat e studimit. Kjo qasje është e bazuar në filozofinë empirike dhe pozitiviste, dhe promovon hetimin e fenomeneve nëpërmjet strategjive kërkimore në një kampionim më të gjerë dhe të dhëna të matshme.

#### **Pjesëmarrësit dhe përzgjedhja e kampionit**

Është aplikuar kampionimi i qëllimshëm, duke përfshirë të gjithë studentët e vitit të parë të programeve të Psikologjisë dhe Punës Sociale në Universitetin “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës viti akademik 2024-2025 (N = 74). Norma e përgjigjes ishte 81% (n = 60), ku përbërja është e balancuar në mënyrë të barabartë ndërmjet studentëve të Psikologjisë (n = 30) dhe atyre të Punës Sociale (n = 30).

#### **Instrumenti i përdorur**

Të dhënat janë mbledhur nëpërmjet një instrumenti të strukturuar të tipit pyetësor, i përbërë nga 17 pohime, të organizuara në katër shkallë që matin:

1. **Motivimin e brendshëm** (*kënaqësi personale, vetëpëmbushje, kontribut në mirëqënien sociale, vetërealizim, siguri në aftësitë personale*),
2. **Motivimin e jashtëm** (*ndikimi i prindërve, miqve, rrjeteve sociale, mentorë/mësues*),
3. **Faktorin ekonomik** (*paga, mundësi punësimi, përfitime ekonomike, mënyrë e mirë e jetesës ekonomike, kërkesë e qëndrueshme që siguron të ardhura*),
4. **Mundësitë profesionale** (*orët fleksibël të punës, mundësi trajnimesh, mundësi përmirësimi profesional*).

Siç rekomandohet nga Likert (1932), për çdo pohim studentët janë udhëzuar të japin vlerësimin e tyre përmes një shkalle Likert me 5 nivele (nga 1 = Aspak dakord deri 5 = Plotësisht dakord). Instrumenti është ndërtuar mbi bazën e modeleve ekzistuese teorike, si teoria e vetëdeterminimit (Deci & Ryan, 1985), modelin e vlerës dhe pritshmërisë në zgjedhjen e karrierës (Eccles & Wigfield, 2002) dhe është testuar paraprakisht për qartësi dhe përshtatshmëri në kontekstin lokal.

#### **Procedura e mbledhjes së të dhënave**

Të dhënat janë mbledhur në mënyrë elektronike, përmes platformës Google Forms, dhe janë shpërndarë online në kanalet e komunikimit akademik të

studentëve. Formulari përfshinte një sqarim të detajuar mbi qëllimin e kërkimit, vullnetarizmin e pjesëmarrjes dhe të drejtat e pjesëmarrësve, përfshirë të drejtën për t'u tërhequr në çdo moment. Pjesëmarrësit dhanë pëlqimin e informuar përmes një deklarate të qartë në fillim të formularit.

### ANALIZA & DISKUTIME

Koeficienti i besueshmërisë për secilën shkallë, siç shihet edhe në tabelën nr. 1, fillon nga  $\alpha = .812$  për shkallën e mundësive profesionale, në  $\alpha = .833$  për shkallën e faktorit ekonomik,  $\alpha = .852$  për shkallën e motivimit të jashtëm dhe  $\alpha = .881$  për shkallën e motivimit të brendshëm.

**Tabela nr. 1: Cronbach's Alpha për secilin faktor**

|          | <b>Faktori</b>       | <b>Cronbach's Alpha</b> |
|----------|----------------------|-------------------------|
| <b>1</b> | Motivim i brendshëm  | .881                    |
| <b>2</b> | Motivim i jashtëm    | .852                    |
| <b>3</b> | Ekonomik             | .833                    |
| <b>4</b> | Mundësi profesionale | .812                    |

Për të testuar tri hipotezat e para është përdorur analiza deskriptive e të dhënave, për të llogaritur mesataret përkatëse për secilën shkallë. Siç paraqiten në grafikun nr. 1 (dhe tabelën nr. 2), mesataret e shkallëve janë: motivimi i brendshëm = 4.516, faktori ekonomik = 3.6, motivimi i jashtëm = 2.45, mundësi profesionale = 4.12. Motivimi i brendshëm ka një mesatare të lartë, duke sugjeruar kështu një faktor rëndësie të lartë në arsyet e zgjedhjes së drejtimit profesional nga studentët e psikologjisë dhe punës sociale në Universitetin e Shkodrës. Pas motivimit të brendshëm vijon faktori i mundësive profesionale me mesatare = 4.12. Nga shifrat në rritje të problematikave psikosociale në vendin tonë dhe më gjerë, si edhe nga ulja në dukje e stigmës përkundrejt ofrimit dhe marrjes së shërbimeve psikosociale, mundësitë profesionale janë në rritje për këto profesione. Faktori ekonomik, që qartazi lidhet edhe me mundësitë e punësimit në pozicione që lidhen me profesionin, ka një mesatare prej 3.6, duke indikuar kështu një rëndësi të lartë për studentët që kanë zgjedhur këto dy drejtime studimi.

**Tabela nr. 2: Të dhënat përshkruese**

|                       | N  | Minimum | Maximum | Mean  | Std. Deviation |
|-----------------------|----|---------|---------|-------|----------------|
| Motivimi i brendshëm  | 60 | 1.00    | 5.00    | 4.516 | 2.46530        |
| Faktori ekonomik      | 60 | 1.00    | 5.00    | 3.6   | 3.58434        |
| Motivacioni i jashtëm | 60 | 1.00    | 5.00    | 2.45  | 3.51988        |
| Mundësi profesionale  | 60 | 1.00    | 5.00    | 4.12  | 1.79422        |
| Valid N (listwise)    | 60 |         |         |       |                |

Mesatarja 2.45, është rezultat i llogaritur nga të dhënat empirike për faktorin e motivimit të brendshëm. Për shkak se faktori ekonomik nuk ka ndikim potencialisht të lartë, po ashtu edhe stigma ndaj profesionit të psikologut dhe punonjësit social si një profesion jofitimprurës, ndikojnë në rezultate relativisht të ulëta të motivimit të jashtëm, në shqyrtimin e arsyeve për zgjedhjen e profesionit nga studentët.

**Grafiku nr. 1: Mesatarja e secilës shkallë**

Bazuar në teorinë e autodeterminimit (Deci & Ryan, 2000), siç është përmendur edhe në shqyrtimin e literaturës së këtij punimi, individët janë më të prirur të angazhohen në veprimtari që u përgjigjen nevojave të tyre të brendshme, si: autonomia, kompetenca dhe ndjesia e lidhjes me të tjerët. Prandaj, është zhvilluar një analizë korrelacionale Pearson për të testuar hipotezën se ekziston një korrelacion negativ mes motivacionit të brendshëm dhe faktorit ekonomik. Përkundrazi, rezultatet (grafiku nr. 2) treguan një lidhje pozitive mesatare dhe statistikisht të rëndësishme ( $r = .361$ ,  $p = .005$ ) mes faktorit të brendshëm dhe ekonomik. Ky rezultat

qëndron në kundërshtim me hipotezën fillestare të këtij studimi si dhe me parashikimet e teorisë së autodeterminimit. Ndikimet e faktorit kulturor rezultojnë të jenë në mospërputhje me teorinë duke ngritur pikëpyetje mbi mënyrën se si motivimi i brendshëm ndërvepron me kufizimet ekonomike aktuale në realitetin shqiptar. Duke qenë se teoria e autodeterminimit bazohet në marrëdhënie probabilistike, kjo mospërputhje nuk e zbeh vlefshmërinë e saj, por justifikohet me numrin e vogël të kampionit dhe specifikohet nevoja për studime të mëtejshme.

**Grafiku nr. 2: Korrelacioni mes motivimit të brendshëm dhe faktorit ekonomik**

| Correlations         |                     | motivimi_i_br<br>endshëm | faktori_ekono<br>mik |
|----------------------|---------------------|--------------------------|----------------------|
| motivimi_i_brendshëm | Pearson Correlation | 1                        | .361**               |
|                      | Sig. (2-tailed)     |                          | .005                 |
|                      | N                   | 60                       | 60                   |
| faktori_ekonomik     | Pearson Correlation | .361**                   | 1                    |
|                      | Sig. (2-tailed)     | .005                     |                      |
|                      | N                   | 60                       | 60                   |

\*\*. Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).

## KONKLUZIONE

Ky studim ka theksuar rëndësinë e faktorëve motivues në zgjedhjen e profesionit nga studentët e Psikologjisë dhe Punës Sociale, duke nxjerrë në pah ndikimin e motivimit të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe faktorët ekonomikë e të punësimit. Gjetjet e studimit kanë konfirmuar se motivimi i brendshëm është elementi kryesor që nxit zgjedhjen e këtyre profesioneve, pasi studentët e Psikologjisë dhe Punës Sociale janë të udhëhequr nga dëshira për të ndihmuar të tjerët dhe për të kontribuar në përmirësimin e shoqërisë.

Ndërkohë, motivimi i jashtëm ka një ndikim të kufizuar, që tregon se, edhe pse presionet sociale dhe ekonomike mund të luajnë një rol, ato nuk janë faktorë vendimtarë për angazhimin e thellë dhe të qëndrueshëm në këto profesione. Për më tepër, mundësitë profesionale janë të rëndësishme.

Në përfundim, ky studim tregon se zgjedhja e profesionit të studentët e Psikologjisë dhe Punës Sociale është një proces kompleks, i cili përfshin një ndërveprim të faktorëve të ndryshëm psikologjikë dhe socio-kulturorë. Rëndësia e motivimit të brendshëm dhe nevoja për të ofruar mundësi profesionale që respektojnë dhe mbështesin interesat dhe qëllimet personale të studentëve janë elemente kyçe për të siguruar një angazhim të qëndrueshëm dhe të kënaqshëm në këto profesione.

**REKOMANDIME (për studime të ardhshme):**

Sugjerohet që studimi të zgjerohet për të përfshirë programe studimi të shkencave ekzakte (siç është inxhinieria etj.) në mënyrë që të ketë një krahasim më të gjerë ekonomik midis llojeve të ndryshme të opinioneve që janë në profesione në fusha të ndryshme. Mendoj se kjo qasje do të ndihmojë në identifikimin e tipareve të përbashkëta ndihmëse dhe dallimeve midis degëve të orientuara socialisht dhe atyre të fokusuara ekonomikisht, duke na bërë të mundur të zhvillojmë një krahasim midis tyre.

Rekomandohet dhe realizimi i një studimi eksplorues me karakter cilësor, i cili synon të analizojë më në thellësi përvojat individuale, motivimet personale dhe ndikimet socio-kulturore që formësojnë zgjedhjen e profesionit. Një qasje e tillë do të ishte më e përshtatshme për të zbuluar dimensione që nuk mund të kapen nëpërmjet metodave sasiore, sidomos duke përfshirë një kampion më të gjerë dhe më përfaqësues.

**REKOMANDIME (në nivel institucional, arsimor):**

Duke qenë se motivimi i brendshëm rezultoi të jetë faktori dominues në zgjedhjen e profesionit nga studentët e Psikologjisë dhe Punës Sociale dhe duke pasur parasysh se mundësitë profesionale dhe motivimi i jashtëm kishin ndikim më të kufizuar, institucionet arsimore duhet të luajnë një rol më proaktiv në orientimin dhe përgatitjen e studentëve. Për këto arsye rekomandohet zhvillimi i programeve të orientimit profesional që në arsimin parauniversitar, pasi është thelbësor për të ndihmuar nxënësit të identifikojnë interesat, vlerat dhe prirjet e tyre personale. Kjo do të ndihmojë në një zgjedhje më të ndërgjegjshme të fushës së studimit dhe do të minimizojë zhgënjimin apo ndërprerjen e studimeve për shkak të pritshmërive të gabuara.

Gjithashtu, sugjerohet përforcimi i praktikave profesionale në kurrikulën universitare, duke rritur kohëzgjatjen dhe cilësinë e tyre, pasi është i nevojshëm për të ndërtuar kompetenca reale dhe për të lehtësuar kalimin nga teoria në praktikë. Studentët në këtë studim shfaqën një orientim të fortë drejt vlerave personale dhe ndihmës ndaj të tjerëve, por për ta përmbushur këtë mision, ata kanë nevojë për përgatitje praktike më të mirë.

**REFERENCA**

- Agareala, T. (2008). Factors influencing career choice of management students in India. *Career Development International*, 13(4), 362–376. <https://doi.org/10.1108/13620430810880844>
- Bandura, A. (1986). Social learning theory and its impact on career development. *Psychological Review*, 93(1), 45–66. <https://doi.org/10.1037/0033-295X.93.1.45>

- Blomé, H., and Espvall, M. (2023). Social work students' professional preferences. *Social work Education*, 43(6), 1713-1731. <https://doi.org/10.1080/02615479.2023.2216209>
- Bracke, P., Delaruelle, K., & Verhaeghe, M. (2019). Dominant cultural and personal stigma beliefs and the utilization of mental health services : A cross-national comparison. 4(May), 1–12.
- Busque-Carrier, M., Ratelle, C. F., and Le Corff, Y. (2021). Linking work Values Profiles to Basic Psychological Need Satisfaction and Frustration. *Psychological Reports*, 125(6), 3183-3208. <https://doi.org/10.1177/00332941211040439>
- Carpenter, J., & Foster, D. (1977). Factors influencing career choice. *Journal of Career Development*, 3(1), 45–58.
- Dibabe, D., Wubie, A. W., & Wondmagegn, G. A. (2015). Career choice and the impact of psychological and socio-cultural factors. *Journal of Psychology and Career*, 10(2), 100–112.
- Dibabe, T. M., Wubie, A. W., & Wondmagegn, G. A. (2015). Factors that affect students' career choice in accounting: A case of Bahir Dar University students. *Research Journal of Finance and Accounting*, 6(5), 146–153.
- European Training Foundation. (2022). Developments in vocational education policy in Albania. <https://www.etf.europa.eu/en/publications-and-resources/publications/developments-vocational-education-policy-albania>
- Exploring the Adolescents' Career Development and Career- Related Teacher Support: the NEFELE Career Guidance Model (Parola et al., 2024)
- Haçkaj, A. (2015). Trendet e punësimit rinor në Shqipëri: Çfarë kërkon tregu? Friedrich Ebert Stiftung & Cooperation and Development Institute (CDI). <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/12168.pdf>
- Hanson, M., & McCullagh, M. (1995). Congruence between personal characteristics and employment opportunities. *Journal of Career Development*, 22(4), 211–224. <https://doi.org/10.1177/089484539502200402>
- Holland, J. L. (1959). The theory of career types and career choice. *Psychological Review*, 66(1), 35–46. <https://doi.org/10.1037/h0042554>
- Holland, J. L. (1997). The theory of career types and the congruence of individuals with work environments. *Journal of Vocational Behavior*, 51(1), 1–14. <https://doi.org/10.1006/jvbe.1997.1616>
- Lent, R. W., Brown, S. D., & Hackett, G. (1994). Social cognitive theory of career development. *Career Development Quarterly*, 42(4), 279–293. <https://doi.org/10.1002/j.2161-0045.1994.tb00588.x>
- Lent, R. W., Brown, S. D., & Hackett, G. (1994). Toward a unifying social cognitive theory of career and academic interest, choice, and performance. *Journal of* –122. <https://doi.org/10.1006/jvbe.1994.1027>
- Najjar, S., & Yousuf, M. (2019). Factors influencing career choice in the field of social work. *International Journal of Social work*, 24(3), 140–153. <https://doi.org/10.1080/13691128.2018.1511994>
- Eccles, J. S., & Wigfield, A. (2002). *Motivational beliefs, values, and goals*. *Annual Review of Psychology*, 53, 109–132. <https://doi.org/10.1146/annurev.psych.53.100901.135153>
- Likert, R. (1932). *A technique for the measurement of attitudes*. *Archives of Psychology*, 140, 1–55. [https://legacy.voteview.com/pdf/Likert\\_1932.pdf](https://legacy.voteview.com/pdf/Likert_1932.pdf)

## **MOTIVIMI I BRENDSHËM NË PUNË: ROLI I FAKTORËVE SOCIO-DEMOGRAFIKË TEK PUNONJËSIT NË SEKTORIN E TURIZMIT NË SHQIPËRI**

Jeta Lila<sup>1</sup>, Lediana Xhakollari<sup>2</sup>, Xhevaire Dulja<sup>3</sup>

<sup>1</sup>Universiteti Bujqësor i Tiranës

<sup>2</sup>Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

<sup>3</sup>Universiteti Bujqësor i Tiranës

### **ABSTRAKT**

Ky artikull shqyrton rolin e motivimit të brendshëm në punë, sipas karakteristikave socio-demografike të punonjësve në sektorin e turizmit në Shqipëri. Duke kombinuar qasje teorike dhe empirike, studimi identifikon ndikimin e moshës, gjinisë, nivelit arsimor, statusit familjar, përvojës profesionale dhe formës së punësimit mbi nivelin e motivimit të brendshëm. Të dhënat u mbledhën përmes një ankete të bazuar mbi shkallën WEIMS dhe u analizuan me mjete statistikore përmes SPSS. Gjetjet tregojnë se motivimi i brendshëm ndikohet ndjeshëm nga arsimi, mosha dhe forma e punësimit, duke ofruar sugjerime konkrete për menaxhimin e burimeve njerëzore në turizëm. Artikulli kontribuon në literaturën mbi menaxhimin e burimeve njerëzore duke ofruar një pasqyrë të detajuar të faktorëve që nxisin motivimin e brendshëm në kontekstin shqiptar.

**Fjalët kyç:** motivimi i brendshëm, turizmi, Shqipëri, variabla demografikë, burime njerëzore.

**Intrinsic motivation at work: The role of socio-demographic factors  
among employees in the tourism sector in Albania**

### **ABSTRACT**

This article examines the role of intrinsic motivation at work, based on the socio-demographic characteristics of employees in the tourism sector in Albania. By combining theoretical and empirical approaches, the study

identifies the impact of age, gender, educational level, marital status, professional experience, and employment type on the level of intrinsic motivation. Data were collected through a survey based on the Work Extrinsic and Intrinsic Motivation Scale (WEIMS) and analyzed using statistical tools in SPSS. The findings show that intrinsic motivation is significantly influenced by education, age, and employment type, offering concrete suggestions for human resource management in tourism. The article contributes to the literature on human resource management by providing a detailed overview of the factors that drive intrinsic motivation within the Albanian context.

**Keywords:** intrinsic motivation, tourism, Albania, demographic variables, human resources.

### ***Hyrje***

Turizmi është një nga sektorët më strategjikë dhe me rritje më të shpejtë në Shqipëri, duke u kthyer në një motor të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik, punësimit dhe tërheqjes së investimeve. Rritja e numrit të turistëve vit pas viti dëshmon potencialin e lartë të këtij sektori për të krijuar vende pune, për të ndikuar në zhvillimin e zonave rurale dhe për të përmirësuar imazhin ndërkombëtar të vendit. Sipas Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Shqipëria ka pritur mbi 10 milionë turistë në vitin 2023, një rritje domethënëse në krahasim me vitet e mëparshme, duke sjellë rreth 4.1 miliardë euro të ardhura në ekonomi. Këto shifra tregojnë jo vetëm potencialin ekonomik të sektorit, por edhe sfidat që lidhen me cilësinë e shërbimeve dhe menaxhimin e burimeve njerëzore.

Me rritjen e kërkesës për shërbime turistike cilësore, lind nevoja për një forcë punëtore të motivuar, të përgatitur dhe të qëndrueshme. Ndaj, një nga faktorët më të rëndësishëm që ndikon drejtpërdrejt në performancën dhe përkushtimin e punonjësve është motivimi. Në veçanti, motivimi i brendshëm, i cili lidhet me dëshirën për të punuar për kënaqësinë që ofron vetë puna, është kyç për të siguruar cilësi, qëndrueshmëri dhe përmbushje personale në vendin e punës. Motivimi i brendshëm përfshin ndjenja të autonomisë, përkatësisë dhe kompetencës, që janë elemente të rëndësishme për mirëqenien në punë dhe për arritjen e objektivave organizative.

Ndryshe nga motivimi i jashtëm, që bazohet në shpërblime materiale, presione ose frikë ndëshkimi, motivimi i brendshëm buron nga vetë individi dhe është më i qëndrueshëm në kohë. Në kontekstin e turizmit, ku dinamika, ndërveprimi me klientin dhe përballimi i situatave të



paparashikuara janë të përditshme, motivimi i brendshëm është një faktor thelbësor për të siguruar shërbim cilësor dhe për të reduktuar nivelin e lodhjes emocionale.

Ky studim merr në shqyrtim ndikimin e karakteristikave demografike, si: moshën, gjininë, arsimin, statusin familjar dhe formën e punësimit në nivelin e motivimit të brendshëm, me qëllim që të kuptohen grupet e punonjësve që kanë më shumë predispozitë për të qenë të motivuar nga brenda dhe atyre që kanë nevojë për ndërhyrje më të thelluara motivuese. Gjetjet e këtij studimi mund të ndihmojnë menaxherët e sektorit të turizmit dhe politikëbërësit për të zhvilluar strategji të personalizuar të menaxhimit të burimeve njerëzore, duke forcuar motivimin dhe angazhimin e punonjësve.

### ***Kuadri teorik***

Motivimi në punë përbën një nga faktorët themelorë që ndikon në performancën, qëndrueshmërinë dhe kënaqësinë e punonjësve, sidomos në sektorë me intensitet të lartë ndërveprimi si turizmi. Brenda literaturës shkencore, motivimi i brendshëm është përkufizuar si nxitja për të kryer një detyrë për hir të kënaqësisë së brendshme që ajo sjell, pa varësi nga shpërblimet e jashtme (Deci & Ryan, 1985). Kjo qasje merr një rëndësi të veçantë në kuadër të Teorisë së Vetëvendosjes (*Self-Determination Theory*), e cila thekson rolin e tri nevojave bazë psikologjike – autonomia, kompetenca dhe përkatësia – në nxitjen e sjelljeve të motivuara në mënyrë të brendshme (Deci & Ryan, 2000).

Në veçanti në sektorin e turizmit, ku ndërveprimi me klientin, fleksibiliteti dhe zgjidhja e problemeve janë të përditshme, motivimi i brendshëm është i lidhur ngusht me cilësinë e shërbimit dhe me nivelin e përkushtimit të punonjësve (Pink, 2009; Deci, Olafsen & Ryan, 2017).

Studiues të ndryshëm kanë theksuar rolin e karakteristikave demografike në nivelin e motivimit të brendshëm. P.sh., arsimi i lartë rrit ndjesinë e kompetencës dhe vetëfikasitetit, që janë thelbësore për përfshirje të brendshme në punë (Kuvaas, 2006). Statusi familjar gjithashtu mund të ndikojë në mënyrën se si individët e konceptualizojnë dhe përjetojnë përkushtimin në punë, sidomos në kontekste ku struktura sociale luan një rol të fortë në identitetin profesional (Van den Broeck et al., 2010; Gursøy et al., 2011).

Sipas Benabou & Tirole (2003), motivimi i brendshëm nuk është vetëm një burim individual, por edhe një rezultat i ndërveprimit mes faktorëve të brendshëm dhe strukturës institucionale. Kjo mbështet qasjen

që menaxhimi i burimeve njerëzore duhet të ndihmojë në krijimin e një mjedisi që nxit ndjenjën e autonomisë dhe kuptimësisë në punë. Këtu përfshihen mundësitë për rritje profesionale, pjesëmarrja në vendimmarrje dhe trajtimi i drejtë, elemente që janë të lidhur ngusht me ndërtimin e një klime organizative që favorizon motivimin e brendshëm (Battistelli et al., 2013).

Në përputhje me këtë literaturë, instrumenti i përdorur në këtë studim – The Work Extrinsic and Intrinsic Motivation Scale (WEIMS) – i zhvilluar nga Tremblay et al., (2009), është i bazuar në teorinë e vetëvendosjes dhe mat komponentët e ndryshëm të motivimit, duke përfshirë motivimin e brendshëm dhe lloje të ndryshme të motivimit të jashtëm. Studime të mëparshme kanë vërtetuar vlefshmërinë dhe besueshmërinë e këtij instrumenti në kontekste të ndryshme organizative dhe kulturore (Chai et al., 2017; Grabowski et al., 2021).

Ky studim gjithashtu është ndërtuar mbi nevojën për të analizuar motivimin e brendshëm në mënyrë të ndarë nga motivimi i jashtëm, me qëllim të kuptohet më mirë cilët faktorë kontribuojnë në ndërtimin e një force punëtore të angazhuar në mënyrë autentike në punën e saj. Kjo ka rëndësi të veçantë në sektorin turistik shqiptar, i cili ndodhet në një fazë intensive rritjeje dhe ka nevojë për politika të personalizuar në menaxhimin e kapitalit njerëzor.

### **Metodologjia**

Qëllimi i këtij studimi është të analizojë nivelin e motivimit të brendshëm dhe marrëdhënien e tij me karakteristikat socio-demografike të punonjësve në sektorin e turizmit në Shqipëri. Pyetjet kërkimore janë:

- A ndryshon niveli i motivimit të brendshëm në varësi të moshës, gjinisë, arsimit dhe përvojës?
- A ka ndikim forma e punësimit dhe statusi familjar në motivimin e brendshëm?

Për realizimin e këtij studimi u përdor “Shkalla e Motivimit në Punë”, The Work Extrinsic and Intrinsic Motivation Scale WEIMS (Tremblay et al., 2009), me fokus te komponentët e motivimit të brendshëm. U anketuan 384 punonjës nga gjashtë klastera turistike në Shqipëri, përzgjedhur përmes kampionimit stratifikues proporcional. Instrumenti kishte koeficient të lartë besueshmërie ( $\alpha = .942$ ).

Variablat demografikë të analizuar përfshijnë:

- Moshën,
- Gjininë,
- Arsimin,

- Statusin familjar,
- Përvojë në vite,
- Formën e punësimit.

Analizat statistikore janë realizuar përmes SPSS, duke përdorur testet e korrelacionit dhe ANOVA për të zbuluar ndryshimet dhe lidhjet midis grupeve.

### **Rezultate**

Në funksion të objektivit kërkimor për të analizuar faktorët që ndikojnë në nivelin e motivimit të brendshëm të punonjësve në sektorin e turizmit, është realizuar një analizë e hollësishme e ndryshimeve ndërmjet grupeve të ndryshme socio-demografike. Duke qenë se analizat e të dhënave treguan devijime nga shpërndarja normale, analizat e krahasimit janë realizuar duke përdorur teste joparametrike, konkretisht: Mann–Whitney U për krahasime midis dy grupeve, Kruskal–Wallis H për më shumë se dy grupe, dhe korrelacioni Spearman rho për vlerësimin e lidhjes ndërmjet variablave numerikë.

### **Mosha**

Rezultatet nuk treguan një lidhje statistikisht të rëndësishme midis moshës dhe nivelit të motivimit të brendshëm (Spearman's rho = .022,  $p = .672$ ). Pavarësisht kësaj, interpretimi përshkruar evidenton se punonjësit në grupmoshën 30–45 vjeç priren të shfaqin një nivel më të lartë të përputhjes mes qëllimeve personale dhe profesionale. Kjo sugjeron se individët në këtë fazë të jetës dhe karrierës së tyre mund të kenë një orientim më të qartë drejt zhvillimit vetjak dhe përmbushjes përmes punës. Megjithatë, duke qenë se këto dallime nuk rezultuan të rëndësishme nga pikëpamja statistikore, ato mbeten më shumë si tregues të prirjeve të mundshme për studime të mëtejshme.

### **Gjinia**

Dallimet gjinore në raport me motivimin e brendshëm nuk rezultuan domethënëse (Mann–Whitney U = -1.034,  $p = .301$ ). Ky rezultat tregon se burrat dhe gratë në sektorin e turizmit në Shqipëri ndajnë nivele të krahasueshme të motivimit të brendshëm, çka nënvizon potencialin për dizajnim të strategjive të menaxhimit të burimeve njerëzore që nuk nevojitet të diferencohen sipas gjinisë kur fokusi është rritja e përfshirjes dhe përmbushjes personale përmes punës.

### **Niveli arsimor**

Niveli i arsimit rezultoi të kishte një ndikim statistikorisht të rëndësishëm

në motivimin e brendshëm (Kruskal–Wallis  $H = 43.105$ ,  $df = 7$ ,  $p < .001$ ). Punonjësit me nivel master profesional (Mean Rank = 252.96) dhe ata me arsim profesional 2-vjeçar (Mean Rank = 214.76) shfaqën vlera më të larta të motivimit të brendshëm krahasuar me grupet e tjera arsimore. Ky rezultat është në përputhje me literaturën që sugjeron se përgatitja akademike dhe teknike e orientuar drejt qëllimeve praktike dhe zhvillimit të aftësive mund të nxisë më shumë përfshirje të brendshme dhe kërkesë për sfidë intelektuale në vendin e punës. Edukimi i avancuar mund të ndikojë në rritjen e vetefikasitetit, ndjenjës së kompetencës dhe vetëpërcaktimit, të cilat janë baza të motivimit sipas teorisë së vetëvendosjes.

#### *Përvoja profesionale*

Analiza korrelative nuk tregoi lidhje statistikisht të rëndësishme midis përvojës profesionale (në vite) dhe motivimit të brendshëm (Spearman's  $\rho = .034$ ,  $p = .507$ ). Megjithatë, analizat cilësore të pyetjeve të hapura sugjeruan se individët me mbi 10 vite përvojë priren të shfaqin një formë më të qëndrueshme të motivimit të brendshëm, e cila lidhet me përvetësimin e rolit profesional si pjesë e identitetit personal. Kjo përforcohet nga nocioni i "rregullimit të integruar" në teorinë e vetëvendosjes, ku puna përjetohet si pjesë përbërëse e vetvetes.

#### *Forma e punësimit*

Forma e punësimit nuk rezultoi të ndikojë në mënyrë statistikisht të rëndësishme në nivelin e motivimit të brendshëm (Kruskal–Wallis  $H = 3.569$ ,  $df = 2$ ,  $p = .168$ ). Megjithatë, punonjësit e vetëpunësuar raportuan nivel më të lartë të motivimit të brendshëm (Mean Rank = 208.47), në krahasim me ata të punësuar me kohë të pjesshme apo të plotë. Kjo sugjeron se ndjenja e autonomisë, kontrolli mbi vendimet dhe përgjegjësia e drejtpërdrejtë mbi rezultatet e punës përbëjnë burime të rëndësishme motivimi për këtë grup.

#### *Statusi familjar*

Ndryshimet midis grupeve të ndryshme të statusit familjar ishin statistikisht domethënëse (Kruskal–Wallis  $H = 10.515$ ,  $df = 4$ ,  $p = .033$ ). Personat e ve shfaqën nivelin më të lartë të motivimit të brendshëm (Mean Rank = 313.79), të ndjekur nga ata në marrëdhënie (Mean Rank = 211.85) dhe të martuarit. Këto gjetje sugjerojnë se faktorë, si: ndjenja e përgjegjësisë, nevoja për vetëmbështetje apo përkushtimi ndaj stabilitetit profesional, mund të luajnë rol të rëndësishëm në ushqimin e motivimit të brendshëm.

### ***Diskutim***

Ky studim shqyrtoi ndikimin e variablave socio-demografikë në motivimin e brendshëm të punonjësve në sektorin e turizmit në Shqipëri, duke përdorur një qasje të kombinuar analitike për të identifikuar faktorët që kontribuojnë në përfshirjen e brendshme të individëve në punë. Rezultatet treguan se niveli arsimor dhe statusi familjar janë faktorë të rëndësishëm në përcaktimin e motivimit të brendshëm, ndërsa mosha, gjinia, përvoja profesionale dhe forma e punësimit nuk patën ndikim statistikisht të rëndësishëm.

#### *Niveli arsimor dhe motivimi i brendshëm*

Një ndër gjetjet më domethënëse të këtij studimi është lidhja pozitive midis nivelit arsimor dhe motivimit të brendshëm. Punonjësit me diplomë master profesional dhe ata me diplomë profesionale 2-vjeçare shfaqën nivelet më të larta të motivimit të brendshëm. Kjo përputhet me literaturën ndërkombëtare, e cila thekson se arritjet arsimore rrisin ndjenjën e kompetencës dhe vetefikasitetit – dy elemente kyç në teorinë e vetëvendosjes (Deci & Ryan, 2000). Studime të ngjashme në kontekste të tjera kulturore kanë konfirmuar se niveli i arsimimit është një parashikues i fuqishëm i motivimit të brendshëm, veçanërisht në mjedise profesionale ku kërkohen aftësi të avancuara (Kuvaas, 2006).

Në mënyrë të veçantë, arsimi profesional duket se ka një ndikim të drejtpërdrejtë mbi orientimin e brendshëm, duke e lidhur kuptimësinë e punës me aftësitë praktike. Në përputhje me këtë, një studim në sektorin e shërbimeve në Itali identifikoi se punonjësit me trajnim profesional kishin më shumë gjasa të përjetonin punën si pjesë të identitetit të tyre profesional (Battistelli et al., 2013).

#### *Statusi familjar dhe orientimi i brendshëm*

Ndikimi i statusit familjar mbi motivimin e brendshëm ishte gjithashtu statistikisht i rëndësishëm. Personat e ve dhe ata në marrëdhënie të qëndrueshme shfaqën nivele më të larta motivimi, gjë që mund të lidhet me rritjen e përgjegjësiave personale dhe nevojës për stabilitet ekonomik dhe emocional. Këto rezultate janë në përputhje me gjetjet e studiuesve si Van den Broeck et al., (2010), të cilët theksojnë se mbështetja sociale dhe struktura personale ndikojnë pozitivisht në ndjesinë e autonomisë dhe përfshirjes.

Një tjetër studim nga Gursoy et al. (2011), i zhvilluar në sektorin e mikpritjes në SHBA, tregoi se punonjësit me familje kishin më shumë tendencë të identifikoheshin me punën e tyre dhe të kërkonin përmbushje

përtej kompensimit monetar. Kjo mbështet idenë se përkushtimi familjar mund të shërbejë si katalizator për përfshirje të brendshme në punë.

#### *Mosha dhe përvoja: Tendenca të paqëndrueshme*

Edhe pse nga analiza statistikore nuk u identifikua një lidhje domethënëse ndërmjet moshës dhe motivimit të brendshëm, interpretimi përshkrues sugjeroi se punonjësit në grupmoshën 30–45 vjeç kanë një prirje më të lartë drejt motivimit të brendshëm. Kjo mund të lidhet me fazën e stabilizimit në karrierë dhe me rritjen e ndjenjës së qëllimit në punë. Megjithatë, në mungesë të një lidhjeje statistikore të qëndrueshme, këto të dhëna mbeten spekulative dhe kërkojnë hetim të mëtejshëm.

Po kështu, përvoja profesionale nuk rezultoi të kishte një ndikim statistikisht të rëndësishëm, ndonëse individët me më shumë se 10 vite përvojë raportuan motivim më të qëndrueshëm në pyetjet me fund të hapur. Literatura ndërkombëtare është e ndarë në këtë aspekt: disa studime tregojnë një ulje të motivimit të brendshëm me rritjen e përvojës për shkak të rutinës dhe mungesës së sfidave të reja (Herzberg, 1966; Blau, 1999), ndërsa të tjera raportojnë një rritje të ndjenjës së qëllimit me avancimin në karrierë (Kanfer & Ackerman, 2004).

#### *Forma e punësimit dhe autonomia personale*

Edhe pse analiza statistikore nuk tregoi dallime të rëndësishme në funksion të formës së punësimit, punonjësit e vetëpunësuar shfaqën një nivel më të lartë të motivimit të brendshëm. Kjo mund të shpjegohet përmes ndjenjës më të lartë të autonomisë dhe kontrollit personal mbi proceset e punës, të cilat janë faktorë të njohur që nxisin motivimin e brendshëm (Pink, 2009). Studime si ai i Deci, Olafsen & Ryan (2017) konfirmojnë se autonomi e lartë në vendimmarrje dhe përgjegjësi direkte janë të lidhura ngusht me motivimin e brendshëm në sektorë të orientuar drejt shërbimit.

#### *Gjinia dhe mungesa e diferencimit*

Mungesa e dallimeve gjinore në motivimin e brendshëm është në përputhje me shumicën e studimeve ndërkombëtare që theksojnë se gjinia nuk është një determinant i fortë i motivimit kur përjashtohen faktorët strukturalë dhe diskriminimi sistemik (Buelens & Van den Broeck, 2007). Në një sektor si turizmi, ku rolet shpesh ndahen më shumë në bazë funksionale sesa gjinore, ky homogjenitet mund të jetë rezultat i natyrës më gjithëpërfshirëse të punës.

**Përfundime dhe rekomandime**

Motivimi i brendshëm është një komponent kritik për performancën dhe kënaqësinë në punë në sektorin e turizmit. Rezultatet e këtij studimi theksojnë se motivimi i brendshëm i punonjësve nuk është i shpërndarë në mënyrë të rastësishme, por ndikohet nga faktorë të caktuar kontekstualë si niveli i arsimit dhe struktura sociale e individit. Ndikimi i variablave demografikë tregon se politikat e menaxhimit duhet të jenë të personalizuar. Rekomandohet në:

- Ofrimin e trajnimeve për zhvillim personal dhe profesional;
- Rritjen e autonomisë dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje;
- Sigurimin e kushteve të qëndrueshme të punës për punonjësit sezonalë;
- Mbështetjen e karrierës për punonjësit me përvojë dhe nivel të lartë arsimor.

**BIBLIOGRAFIA:**

1. Battistelli, A., Galletta, M., Vandenberghe, C., & Odoardi, C. (2013). Intrinsic motivation and organizational commitment in the Italian public administration. *The International Journal of Human Resource Management*, 24(17), 3242–3264. <https://doi.org/10.1080/09585192.2013.770783>
2. Benabou, R., & Tirole, J. (2003). Intrinsic and extrinsic motivation. *Review of Economic Studies*, 70(3), 489–520. <https://doi.org/10.1111/1467-937X.00253>
3. Blau, G. (1999). Early-career job factors influencing the professional commitment of medical technologists. *Academy of Management Journal*, 42(6), 687–695. <https://doi.org/10.5465/256987>
4. Buelens, M., & Van den Broeck, H. (2007). An analysis of differences in work motivation between public and private sector organizations. *Public Administration Review*, 67(1), 65–74. <https://doi.org/10.1111/j.1540-6210.2006.00697.x>
5. Chai, S., Teoh, K. M., Razaob, A. B., & Kadar, M. (2017). Validity of WEIMS among Malaysian hotel employees. *International Journal of Academic Research in Business and Social Sciences*, 7(12), 681–692. <https://doi.org/10.6007/IJARBS/v7-i12/3615>
6. Cherry, K. (2018). *Types of motivation*. Verywell Mind. <https://www.verywellmind.com/types-of-motivation-2795388>
7. Deci, E. L., & Ryan, R. M. (1985). *Intrinsic motivation and self-determination in human behavior*. Springer US. <https://doi.org/10.1007/978-1-4899-2271-7>
8. Deci, E. L., & Ryan, R. M. (2000). The “what” and “why” of goal pursuits: Human needs and the self-determination of behavior. *Psychological Inquiry*, 11(4), 227–268. [https://doi.org/10.1207/S15327965PLI1104\\_01](https://doi.org/10.1207/S15327965PLI1104_01)
9. Deci, E. L., Olafsen, A. H., & Ryan, R. M. (2017). Self-determination theory in work organizations: The state of a science. *Annual Review of Organizational Psychology and Organizational Behavior*, 4, 19–43. <https://doi.org/10.1146/annurev-orgpsych-032516-113108>
10. Fields, D. L. (2002). *Taking the measure of work: A guide to validated scales for organizational research and diagnosis*. SAGE Publications.

11. Grabowski, D., Chudzicka-Czupała, A., & Stapor, K. (2021). Validation of WEIMS in a Polish context. *Current Psychology*, 40, 4816–4829. <https://doi.org/10.1007/s12144-019-00349-2>
12. Gursoy, D., Maier, T. A., & Chi, C. G. (2011). Generational differences: An examination of work values and generational gaps in the hospitality workforce. *International Journal of Hospitality Management*, 30(1), 78–88. <https://doi.org/10.1016/j.ijhm.2010.04.002>
13. Heritage, B., Pollock, C., & Roberts, L. (2015). Validation of the Warr–Cook–Wall Job Satisfaction Scale. *Work*, 52(2), 301–313. <https://doi.org/10.3233/WOR-152145>
14. Herzberg, F. (1966). *Work and the nature of man*. Cleveland: World Publishing Company.
15. Kanfer, R. (2008). Work motivation: Integrating theory and practice. In R. Kanfer, G. Chen, & R. D. Pritchard (Eds.), *Work motivation: Past, present, and future* (pp. 439–446). Routledge.
16. Kanfer, R., & Ackerman, P. L. (2004). Aging, adult development, and work motivation. *Academy of Management Review*, 29(3), 440–458. <https://doi.org/10.5465/amr.2004.13670969>
17. Koopmans, L., Bernaards, C. M., Hildebrandt, V. H., van Buuren, S., van der Beek, A. J., & de Vet, H. C. W. (2013). Development of an individual work performance questionnaire. *International Journal of Productivity and Performance Management*, 62(1), 6–28. <https://doi.org/10.1108/17410401311285273>
18. Kuvaas, B. (2006). Work performance, affective commitment, and work motivation: The roles of pay administration and pay level. *Journal of Organizational Behavior*, 27(3), 365–385. <https://doi.org/10.1002/job.377>
19. Pink, D. H. (2009). *Drive: The surprising truth about what motivates us*. Riverhead Books.
20. Tremblay, M. A., Blanchard, C., Taylor, S., Pelletier, L., & Villeneuve, M. (2009). Work Extrinsic and Intrinsic Motivation Scale: Its value for organizational psychology research. *Canadian Journal of Behavioural Science*, 41(4), 213–226. <https://doi.org/10.1037/a0015167>
21. Van den Broeck, A., Vansteenkiste, M., De Witte, H., & Lens, W. (2010). Capturing autonomy, competence, and relatedness at work: Construction and initial validation of the Work-related Basic Need Satisfaction scale. *Journal of Occupational and Organizational Psychology*, 83(4), 981–1002. <https://doi.org/10.1348/096317909X481382>



## NDIKIMET GJINORE NË MIRËQENIEN SHËNDETËSORE GJATË MENAXHIMIT TË SITUATËS SË COVID-19 TEK STUDENTËT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS

Arben Hoti

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti Psikologji-Punë Sociale*

### ABSTRAKT

Pandemia globale COVID-19 gjatë viteve 2020–2021 preku aspekte të shumta të jetës së individëve, duke përfshirë shëndetin fizik dhe mirëqenien. Këto efekte vazhduan në periudhën pas COVID-19, ku, pavarësisht rënies së pandemisë, ndikimet në shëndetin mendor dhe psikologjik mbetën të dukshme. Ky artikull paraqet një pjesë të një studimi të kryer për të analizuar efektet e pandemisë COVID-19 në shëndetin mendor dhe mirëqenien psikologjike të individëve.

Studimi u krye në një popullsi prej 1,321 studentësh nga Universiteti i Shkodrës midis tetorit 2021 dhe shtatorit 2022. Pjesëmarrësit përfshinin studentë të diplomës bachelor nga tri fakultete (Shkencat e Edukimit, Shkencat e Natyrës dhe Shkencat Ekonomike), me fokus në përvojat e tyre me COVID-19, mekanizmat e përballimit, statusin e vaksinimit, nivelet e ankthit dhe ndikimin e këtyre faktorëve në shëndetin e përgjithshëm.

Të dhënat empirike u analizuan duke përdorur një metodologji kërkimore gjithëpërfshirëse dhe statistikisht të vlefshme. Rezultatet tregojnë se ekspozimi më pak intensiv ndaj COVID-19, respektimi i duhur i vaksinimit dhe ndryshimet statistikisht të rëndësishme gjinore luajtën një rol në përballimin e situatës. Për më tepër, pajtueshmëria me masat mbrojtëse kontribuoi në rivendosjen e mirëqenies dhe ndihmoi në zbutjen e efekteve negative psikologjike të pandemisë.

**Fjalë kyçe:** COVID-19, vaksinim, studentë, gjini.

**Gender impacts on health well-being during the management of the  
COVID-19 situation among students of the University of Shkodra**

### ABSTRACT

The global COVID-19 pandemic during 2020–2021 affected multiple aspects of individuals' lives, including physical health and well-being.

These effects persisted into the post-COVID-19 period, where, despite the pandemic's decline, impacts on mental and psychological health remained evident. This article presents part of a study conducted to analyze the effects of the COVID-19 pandemic on individuals' mental health and psychological well-being.

The study was conducted on a population of 1,321 students from the University of Shkodra between October 2021 and September 2022. Participants included bachelor's degree students from three faculties (Education Sciences, Natural Sciences, and Economics), with a focus on their COVID-19 experiences, coping mechanisms, vaccination status, anxiety levels, and the influence of these factors on overall health.

Empirical data were analyzed using a comprehensive and statistically valid research methodology. Results indicate that less intensive COVID-19 exposure, proper vaccination adherence, and statistically significant gender-based differences played a role in coping with the situation. Additionally, compliance with protective measures contributed to the restoration of well-being and helped mitigate the pandemic's negative psychological effects.

**Keywords:** COVID-19, vaccination, students, gender.

### ***Hyrje***

Ky artikull paraqet një studim empirik të zhvilluar mbi menaxhimin e periudhës post-COVID tek studentët. Ai përfshin një pjesë të të dhënave të mbledhura në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” me studentët e nivelit Bachelor në: Fakultetin e Shkencave të Edukimit, Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Fakultetin Ekonomik.

Përhapja e shpejtë e virusit çoi në shpalljen e një pandemie globale nga Organizata Botërore e Shëndetësisë në mars të vitit 2020. Sëmundja u përhap me ritme alarmante, duke shkaktuar miliona viktima dhe një krizë të thellë në sistemet shëndetësore, ekonomike dhe sociale.

Ky studim është realizuar gjatë viteve 2021–2022, menjëherë pas rikthimit të normalitetit funksional shoqëror në Shqipëri, pas fillimit të vaksinimit masiv të popullsisë.

Qëllimi kryesor i punimit është të analizojë menaxhimin post-COVID të studentëve përmes disa elementeve të mirëqenies shëndetësore që u ndikuan nga pandemia. Një tjetër qëllim është mbledhja e të dhënave empirike mbi përvojën personale me COVID-19, shkallën e prekjes dhe numrin e vaksinimeve të studentëve të përfshirë në kampion, duke i shqyrtuar këto të dhëna edhe sipas gjinisë. Një qëllim i tretë është të

verifikohet lidhja e mundshme midis gjinisë dhe statusit të vaksinimit të studentëve pjesëmarrës në studim.

Bazuar në qëllimet dhe objektivat e mësipërme, studimi parashton katër pyetje kërkimore:

1. Cila është përvoja personale e subjekteve të kampionit me COVID-19?
2. Si shfaqet shkalla e prekjes nga virusi tek studentët?
3. Cili është statusi i vaksinimit të studentëve të përfshirë në kampion?
4. A paraqiten ndryshime gjinore në statusin e vaksinimit dhe përvojën personale?

E gjithë puna kërkimore është realizuar në përputhje me standardet etike të kërkimit shkencor.

### **Trajtimi teorik**

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (WHO), COVID-19 është një sëmundje infektive e shkaktuar nga virusi i njohur si SARS-CoV-2 (Severe Acute Respiratory Syndrome Coronavirus 2). Si pjesë e familjes së koronavirusëve ai mund të shkaktojë një gamë të gjerë simptomash, nga ato të lehta (si gripi) deri tek sëmundje të rënda, si pneumonia, dhe mund të çojë në vdekje, sidomos tek individët me rrezik të lartë, si të moshuarit dhe ata me kushte të tjera shëndetësore të pranishme (WHO, 2020).

Përhapja e shpejtë e virusit çoi në shpalljen e një pandemie globale nga Organizata Botërore e Shëndetësisë në mars 2020. Sëmundja u përhap me ritme alarmante, duke shkaktuar miliona viktime dhe një krizë të gjerë në sistemet shëndetësore, ekonomike dhe sociale.

Ndikimet e COVID-19 kanë qenë të thella dhe shumëdimensionale. Në fushën shëndetësore, pandemia solli mbingarkesë në spitale, mungesë pajisjesh mbrojtëse dhe lodhje ekstreme të personelit mjekësor. Në aspektin psikologjik, izolimi social, frika nga infektimi dhe pasiguria për të ardhmen çuan në rritjen e niveleve të ankthit, depresionit dhe stresit, veçanërisht tek grupet më vulnerabël si të moshuarit dhe fëmijët. Mjafon të përmendim ndikimet e niveleve të ankthit që u përjetuan.

Ankthi është një emocion i karakterizuar nga ndjenja tensioni, mendime të shqetësuara dhe ndryshime fizike si rritja e presionit të gjakut (Shoqata Psikologjike Amerikane [APA], 2020, f. 66). Individët me çrregullime ankthi shpesh përjetojnë mendime të përsëritura ndërhyrëse ose shqetësime. Ata gjithashtu mund të shmangin situata të caktuara për shkak të shqetësimit. Për më tepër, ata mund të kenë simptoma fizike, si: djersitje, dridhje, marramendje ose rrahje të shpejta të zemrës.

Ankthi nuk është i njëjtë me frikën, por ata shpesh përdoren në mënyrë të ndërsjellë. Ankthi konsiderohet një përgjigje e orientuar drejt së ardhmes, me veprim të gjatë, i fokusuar gjerësisht në një kërcënim të përhapur, ndërsa frika është një përgjigje e përshtatshme, e orientuar drejt së tashmes dhe jetëshkurtër ndaj një kërcënimi qartësisht të identifikueshëm dhe specifik (Hoti V, & Hoti. A, 2022).

Duan et al., (2020) kanë raportuar nivele të larta të ankthit dhe stresit, të cilat mund të zgjaten edhe pas përfundimit të pandemisë (Duan et al., 2020).

Studimi i Brooks et al., (2020) ka treguar se izolimi dhe karantina mund të shkaktojnë shqetësime të mëdha psikologjike, përfshirë stresin posttraumatik dhe ankthin.

Pfefferbaum & North (2020) kanë analizuar ndikimin psikologjik të pandemisë COVID-19 në nivel global dhe kanë përfunduar se, pandemia ka sjellë një rritje të stresit dhe ankthit në të gjithë popullatën, me efektet më të theksuara për individët që janë më të prekshëm (Pfefferbaum & North, 2020).

Holmes et al., (2020) theksuan se individët mund të përjetojnë një rritje të nivelit të ankthit dhe depresionit, si dhe stres të përgjithshëm pas përfundimit të pandemisë. Pandemia ka krijuar një ndjenjë të pasigurisë dhe ka shkaktuar shqetësime psikologjike të theksuara (Holmes et al., 2020).

Një rishikim sistematik cilësor u krye nga **Saeed et al., (2022)**, për të hetuar prevalencën dhe lidhjen e ankthit në popullata të ndryshme të mostrës në lidhje me pandeminë COVID-19.

Asmundson & Taylor, 2020 studiuuan ndikimin e pandemisë së COVID-19 në shëndetin mendor, duke identifikuar një rritje të ndjeshme të ankthit të lidhur me shëndetin tek individët. (Asmundson & Taylor, 2020). Kjo u përforcua edhe nga Lima et al., 2020, të cilët theksuan se ankthi është reagimi më i përhapur në popullatë ndaj situatave ekstreme siç është pandemia (Lima et al., 2021).

Një studim i realizuar në Kosovë me 657 studentë nga 6 universitete analizoi ndikimin e pandemisë COVID-19 në shëndetin mendor të studentëve. Rezultatet treguan se 79.2% e pjesëmarrësve në studim përjetojnë ankth, konkretisht 16.9% e tyre raportuan vlera të ankthit të rëndë, 24.2% të moderuar dhe 38.1% të lehtë. (Jetishi Çollaku, 2024, p.47).

### **Metodologjia**

Për të realizuar më së miri pikësynimet kërkimore, punimi bazohet në një metodologji të larmishme në të cilën përfshihen frekuenca, përqindje, krostabulime etj.

Kampioni. Pjesë e kampionit të këtij studimi janë studentët e të gjitha

degëve në programin Bachelor të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Fakultetit Ekonomik në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", të përzgjedhur në formën e censusit.

Studentët janë ftuar të marrin pjesë në mënyrë vullnetare, duke u bazuar në dëshirën dhe angazhimin e tyre personal. Në total, janë përfshirë 1321 studentë që kanë plotësuar kriteret për përfshirje. Vetëm një numër shumë i vogël studentësh kanë refuzuar të marrin pjesë. Gjithashtu, një numër tjetër i vogël nuk është përfshirë në analizë, për shkak se pyetësorët e tyre nuk rezultuan të vlefshëm.

Instrumenti i përdorur. Për mbledhjen e të dhënave empirike është hartuar një instrument i strukturuar në formën e një pyetësi, i cili përmban katër pyetje me alternativa të mbyllura. Pyetjet kanë për qëllim të mbledhin informacion mbi përvojën personale me COVID-19, shkallën e prekjes, mënyrën e përballimit të situatës dhe numrin e vaksinimeve ndaj virusit.

Administrimi dhe mbledhja e të dhënave. Pyetësorët janë administruar nga autori i studimit dhe janë shpërndarë për një periudhë 90-ditore. Plotësimi i tyre është bërë gjatë orëve mësimore, kur pjesëmarrja e studentëve ishte më e lartë. Përpara plotësimit, studentët janë informuar mbi qëllimin e studimit, mënyrën e plotësimit të pyetësit dhe u është garantuar anonimiti i përgjigjeve.

Studiuesi ka ndjekur procesin e plotësimit nga afër duke siguruar mbikëqyrje korrekte dhe duke dhënë shpjegime shtesë aty ku ka qenë e nevojshme, ndonëse këto raste kanë qenë të izoluara.

Pas përfundimit, pyetësorët janë dorëzuar dhe janë mbledhur gjithsej 1321 të tillë. Më pas, përgjigjet janë koduar dhe është krijuar baza e të dhënave në programin Excel. Të dhënat janë përpunuar përmes programit SPSS 27 për analizë statistikore të mëtejshme.

## **Rezultate dhe diskutime**

Përpunimi i të dhënave të mbledhura na mundësoi realizimin e një përshkrimi të detajuar të tyre, nëpërmjet paraqitjes tabelore dhe përshkrimit interpretues. Gjithashtu, të dhënat u diskutuan në funksion të qëllimeve kërkimore të studimit, duke nxjerrë në pah tendencat kryesore dhe lidhjet ndërmjet variablave të përfshirë.

**Tabela nr. 1. Shpërndarja e kampionit sipas gjinisë.**

|           |          | Frequency | Percent | Valid Percent | Cumulative Percent |
|-----------|----------|-----------|---------|---------------|--------------------|
| Val<br>id | Mashkull | 368       | 27.9    | 27.9          | 27.9               |
|           | Femer    | 953       | 72.1    | 72.1          | 100.0              |
|           | Total    | 1321      | 100.0   | 100.0         |                    |

Tabela nr. 1, paraqet shpërndarjen gjinore të pjesëmarrësve në studim. Nga gjithsej 1321 pjesëmarrës, 368 janë meshkuj, që përbëjnë 27.9% të kampionit, ndërsa 953 janë femra, që përfaqësojnë 72.1%. Të gjitha të dhënat janë të vlefshme dhe nuk ka mungesa në përgjigje për këtë pyetje. Kjo tregon një dominim të dukshëm të femrave në përbërjen e kampionit, me pothuajse tri herë më shumë femra sesa meshkuj.

**Tabela nr. 2. Përvoja personale me COVID-19**

| Gjinia   |       |       | Frequency | Percent | Valid Percent | Cumulative Percent |
|----------|-------|-------|-----------|---------|---------------|--------------------|
| Mashkull | Valid | 0     | 185       | 50.3    | 50.3          | 50.3               |
|          |       | 1     | 135       | 36.7    | 36.7          | 87.0               |
|          |       | 2     | 48        | 13.0    | 13.0          | 100.0              |
|          |       | Total | 368       | 100.0   | 100.0         |                    |
| Femer    | Valid | 0     | 424       | 44.5    | 44.5          | 44.5               |
|          |       | 1     | 423       | 44.4    | 44.4          | 88.9               |
|          |       | 2     | 106       | 11.1    | 11.1          | 100.0              |
|          |       | Total | 953       | 100.0   | 100.0         |                    |

Tabela nr. 2 paraqet përvojën personale me COVID-19 të ndarë sipas gjinisë dhe numrit të herëve që individët janë prekur nga virusi. Tek meshkujt, 50.3% raportojnë se nuk janë prekur asnjëherë nga COVID-19, 36.7% janë prekur një herë, dhe 13% janë prekur dy herë.

Tek femrat, përqindja e atyre që nuk janë prekur është pak më e ulët (44.5%), ndërsa përqindja e atyre që janë prekur një herë është pothuajse e njëjtë me atë të meshkujve (44.4%). Përqindja e femrave të prekura dy herë është 11.1%, pra pak më e ulët se tek meshkujt.

Në të dyja grupet, shumica raportojnë se janë prekur një herë ose nuk janë prekur fare, ndërsa një përqindje më e vogël është prekur dy herë.

Meshkujt kanë një përqindje pak më të lartë të rasteve pa përvojë me virusin dhe gjithashtu një përqindje më të lartë të rasteve të prekura dy herë, krahasuar me femrat. Femrat kanë një shpërndarje më të barabartë midis atyre që nuk janë prekur dhe atyre që janë prekur një herë. Kjo tregon një përhapje të ngjashme të virusit në të dy grupet gjinore, me disa dallime të vogla në intensitetin e përvojës.

**Tabela nr. 3. Shpërndarja e kampionit sipas formave të prekjes**

| Gjinia   |         |                                                 | Frequen<br>cy | Percent | Valid<br>Percent | Cumulati<br>ve<br>Percent |
|----------|---------|-------------------------------------------------|---------------|---------|------------------|---------------------------|
| Mashkull | Valid   | Ka qenë pa simptoma                             | 77            | 20.9    | 33.9             | 33.9                      |
|          |         | Ka zgjatur pak me simptoma të lehta             | 105           | 28.5    | 46.3             | 80.2                      |
|          |         | Ka zgjatur mjaftueshëm me simptoma të qarta     | 30            | 8.2     | 13.2             | 93.4                      |
|          |         | E keni përjetuar gjatë dhe me simptoma të forta | 15            | 4.1     | 6.6              | 100.0                     |
|          |         | Total                                           | 227           | 61.7    | 100.0            |                           |
|          | Missing | System                                          | 141           | 38.3    |                  |                           |
|          | Total   |                                                 | 368           | 100.0   |                  |                           |
| Femer    | Valid   | Ka qenë pa simptoma                             | 150           | 15.7    | 24.3             | 24.3                      |
|          |         | Ka zgjatur pak me simptoma të lehta             | 286           | 30.0    | 46.4             | 70.7                      |
|          |         | Ka zgjatur mjaftueshëm me simptoma të qarta     | 132           | 13.9    | 21.4             | 92.1                      |
|          |         | E keni përjetuar gjatë dhe me simptoma të forta | 49            | 5.1     | 7.9              | 100.0                     |
|          |         | Total                                           | 617           | 64.7    | 100.0            |                           |
|          | Missing | System                                          | 336           | 35.3    |                  |                           |
|          | Total   |                                                 | 953           | 100.0   |                  |                           |

Tabela nr. 3 paraqet shpërndarjen e formës së përjetimit të COVID-19 tek individët që kanë qenë të prekur, të ndarë sipas gjinisë. Të dhënat janë llogaritur vetëm për ata që kanë raportuar një përvojë me virusin, ndërsa mungesat ("Missing System") u përkasin atyre që nuk janë prekur fare.

Tek meshkujt, nga 227 që kanë pasur përvojë me COVID-19, 33.9% e kanë kaluar pa simptoma, 46.3% e kanë përjetuar me simptoma të lehta për një kohë të shkurtër, 13.2% me simptoma të qarta dhe që kanë zgjatur, dhe 6.6% e kanë përjetuar gjatë dhe me simptoma të forta. Kjo tregon se shumica e meshkujve e kanë kaluar infeksionin në formë të lehtë ose pa simptoma.

Tek femrat, nga 617 që kanë qenë të prekuara, 24.3% nuk kanë pasur simptoma, 46.4% kanë pasur simptoma të lehta për një kohë të shkurtër, 21.4% e kanë përjetuar me simptoma të qarta dhe të zgjatura, ndërsa 7.9% me simptoma të forta dhe për një periudhë të gjatë. Edhe tek femrat, forma më e zakonshme e përvojës ka qenë ajo me simptoma të lehta, por përqindja e atyre me simptoma të qarta ose të forta është më e lartë krahasuar me meshkujt.

Në tërësi, femrat që kanë përjetuar COVID-19 kanë një shpërndarje më të larmishme të simptomave, me prirje më të madhe për të raportuar forma më të rënda të infeksionit. Meshkujt më shpesh e kanë kaluar pa simptoma ose me një formë të lehtë.

**Tabela nr. 4. Statusi i vaksinimit sipas kriterit gjini**

| Gjinia   |       |                     | Frequency | Percent | Valid Percent | Cumulative Percent |
|----------|-------|---------------------|-----------|---------|---------------|--------------------|
| Mashkull | Valid | I pavaksinuar       | 98        | 26.6    | 26.6          | 26.6               |
|          |       | Vaksinuar 1<br>here | 32        | 8.7     | 8.7           | 35.3               |
|          |       | Vaksinuar 2<br>here | 208       | 56.5    | 56.5          | 91.8               |
|          |       | Vaksinuar 3<br>here | 30        | 8.2     | 8.2           | 100.0              |
|          |       | Total               | 368       | 100.0   | 100.0         |                    |
| Femer    | Valid | I pavaksinuar       | 268       | 28.1    | 28.1          | 28.1               |
|          |       | Vaksinuar 1<br>here | 98        | 10.3    | 10.3          | 38.4               |



|                  |     |       |       |       |
|------------------|-----|-------|-------|-------|
| Vaksinuar 2 here | 541 | 56.8  | 56.8  | 95.2  |
| Vaksinuar 3 here | 46  | 4.8   | 4.8   | 100.0 |
| Total            | 953 | 100.0 | 100.0 |       |

Kjo tabelë paraqet shpërndarjen e frekuencës së vaksinimit ndaj COVID-19 për meshkuj dhe femra, të ndarë sipas numrit të vaksinimeve (0, 1, 2 ose 3 herë). Të gjitha të dhënat janë të vlefshme dhe nuk ka mungesa në përgjigje për këtë pyetje.

Frekuenca më e lartë gjendet tek vaksinimi dy herë (56.8%). Si te meshkujt (56.5%) ashtu edhe te femrat (56.8%), vakcina është marrë më së shumti dy herë — kjo sugjeron përputhje të lartë me fushatat e vaksinimit që kërkonin 2 doza bazë për imunitet fillestar.

Ka një përqindje të konsiderueshme të të anketuarve të pavaksinuar: meshkuj 26.6%, femra 28.1%. Kjo tregon një grup të rëndësishëm të popullsisë që nuk është përfshirë fare në fushatën e vaksinimit.

Vaksinimi i trefishtë është shumë më pak i zakonshëm: meshkuj 8.2%, femra 4.8%. Kjo mund të nënkuptojë që shumë nuk kanë marrë dozën përforcuese (booster) ose nuk kanë pasur nevojë apo kërkesë për të. Të dhënat për dy grupet gjinore janë të ngjashme në shpërndarje, por meshkujt kanë përqindje pak më të lartë për vaksinimin trefish, ndërsa femrat kanë përqindje pak më të lartë për vaksinimin një herë dhe janë lehtësisht më shumë të pavaksinuara.

Më shumë se gjysma e pjesëmarrësve të të dy gjinive janë vaksinuar me dy doza, që përputhet me udhëzimet standarde shëndetësore në shumicën e vendeve. Ka një numër domethënës të të pavaksinuarve, që paraqet potencial për ndërhyrje të mëtejshme shëndetësore ose komunikim publik. Vaksinimi përforcues (doza e tretë) ka qenë ende shumë i ulët.

**Tabela nr. 5. Krostabulimi Gjinia \* Statusi i vaksinimit**

| Count  |          | Në mbrojtje ndaj covid-it sa herë ju jeni vaksinuar: |        |        |        | Total |
|--------|----------|------------------------------------------------------|--------|--------|--------|-------|
|        |          | 0                                                    | 1 here | 2 here | 3 here |       |
| Gjinia | Mashkull | 98                                                   | 32     | 208    | 30     | 368   |
|        | Femër    | 268                                                  | 98     | 541    | 46     | 953   |
| Total  |          | 366                                                  | 130    | 749    | 76     | 1321  |

Tabela nr. 5 paraqet një kryqëzim midis gjinisë dhe numrit të vaksinimeve kundër COVID-19. Janë përfshirë gjithsej 1321 persona, prej të cilëve 368 janë meshkuj dhe 953 femra.

Për meshkujt: 26.6% nuk janë vaksinuar (98 nga 368); 8.7% janë vaksinuar një herë (32 nga 368); 56.5% janë vaksinuar dy herë (208 nga 368); 8.2% janë vaksinuar tri herë (30 nga 368).

Për femrat: 28.1% nuk janë vaksinuar (268 nga 953), 10.3% janë vaksinuar një herë (98 nga 953), 56.8% janë vaksinuar dy herë (541 nga 953) dhe 4.8% janë vaksinuar tri herë (46 nga 953).

Të dhënat tregojnë se në të dy grupet gjinore, vaksinimi me dy doza është forma më e zakonshme, me rreth 56.5% te meshkujt dhe 56.8% te femrat. Numri i të pavaksinuarve është pak më i lartë te femrat (28.1%) krahasuar me meshkujt (26.6%). Vaksinimi me tri doza është më i zakonshëm te meshkujt (8.2%) sesa te femrat (4.8%), ndërsa femrat kanë përqindje më të lartë për vaksinimin një herë (10.3% ndaj 8.7%).

Në përgjithësi, shpërndarja është relativisht e ngjashme midis gjinive, me dallime të vogla në disa kategori, veçanërisht për dozën e tretë. Kjo sugjeron një përputhje të përgjithshme në sjelljen vaksinuese midis meshkujve dhe femrave në këtë kampion, me disa tendenca më të larta të pavaksinimit dhe vaksinimit një herë te femrat, dhe një tendencë më të theksuar për dozën përforcuese te meshkujt.

**Tabela nr. 6. Krostabulimi Gjinia \* Përvoja personale me Covid-19**

Count

|        |   | Cila është përvoja juaj personale me Covid: |     |     | Total |
|--------|---|---------------------------------------------|-----|-----|-------|
|        |   | 0                                           | 1   | 2   |       |
| Gjinia | 1 | 185                                         | 135 | 48  | 368   |
|        | 2 | 424                                         | 423 | 106 | 953   |
| Total  |   | 609                                         | 558 | 154 | 1321  |

Nisur nga tabela nr. 6, femrat kanë një përqindje më të lartë të personave që nuk janë prekur fare nga COVID-19 (50.3%) në krahasim me meshkujt (44.5%). Meshkujt kanë pothuajse përqindje të barabartë mes atyre që nuk janë prekur (44.5%) dhe atyre që janë prekur lehtë (44.4%), ndryshe nga femrat ku preken më pak. Në të dy gjinitë, përqindja e atyre që janë prekur rëndë është më e ulët, por përsëri më e lartë tek meshkujt (11.1%) se tek femrat (13.0%). Të dhënat tregojnë se ka diferenca të moderuara në përvojën me COVID-19 sipas gjinisë: femrat raportojnë më shpesh që nuk janë prekur, ndërsa meshkujt kanë më shumë gjasa të raportojnë prekje të

lehtë ose të rëndë.

**Tabela nr. 7. Testi Chi-Katror për lidhjen midis gjinisë dhe përvojës personale me COVID-19**

|                              | Value              | df | Asymptotic<br>Significance (2-<br>sided) |
|------------------------------|--------------------|----|------------------------------------------|
| Pearson Chi-Square           | 6.492 <sup>a</sup> | 2  | .039                                     |
| Likelihood Ratio             | 6.549              | 2  | .038                                     |
| Linear-by-Linear Association | .861               | 1  | .353                                     |
| N of Valid Cases             | 1321               |    |                                          |

a. 0 cells (0.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 42.90.

Testi Chi-Katror tregoi një lidhje statistikisht të rëndësishme midis gjinisë dhe përvojës personale me COVID-19,  $\chi^2(2, N = 1321) = 6.49$ ,  $p = .039$ . Kjo sugjeron se përvoja me COVID-19 ndryshon në mënyrë domethënëse në varësi të gjinisë.

### Përfundime

Studimi tregon një përhapje të ngjashme të virusit në të dy grupet gjinore, me disa dallime të vogla në intensitetin e përvojës. Forma më e zakonshme e përjetimit ka qenë ajo me simptoma të lehta.

Statusi i vaksinimit rezulton i mirë për të dy gjinitë. Më shumë se gjysma e pjesëmarrësve, si meshkuj ashtu edhe femra, janë vaksinuar me dy doza, gjë që përputhet me udhëzimet standarde të autoriteteve shëndetësore në shumicën e vendeve. Shpërndarja e vaksinimit është relativisht e ngjashme midis gjinive, me disa ndryshime të vogla në kategori të caktuara, veçanërisht për dozën e tretë.

Analiza statistikore tregoi një lidhje statistikisht të rëndësishme midis gjinisë dhe përvojës personale me COVID-19.

Të dhënat e nxjerra nga ky studim tregojnë për një përfshirje të mirë të studentëve në marrjen e masave mbrojtëse ndaj COVID-19, çka nënkupton një kujdes të treguar ndaj mirëqenies së tyre shëndetësore.

### Referencat

1. American Psychological Association. (2020). *APA dictionary of psychology* (2nd ed.). <https://doi.org/10.1037/0000-0000>
2. Asmundson, G. J. G., & Taylor, S. (2020). Coronaphobia: Fear and the 2019-nCoV outbreak. *Journal of Anxiety Disorders*, 70, 102196. <https://doi.org/10.1016/j.janxdis.2020.102196>
3. Cao, W., Fang, Z., Hou, G., Han, M., Xu, X., Dong, J., & Zheng, J. (2020). The psychological impact of the COVID-19 epidemic on college students in China. *Psychiatry Research*, 287, 112934. <https://doi.org/10.1016/j.psychres.2020.112934>
4. Chong, M. Y., Wang, W. C., Hsieh, W. C., Lee, C. Y., Chiu, N. M., Yeh, W. C., Huang, O. L., Wen, J. K., & Chen, C. L. (2004). Psychological impact of severe acute

- respiratory syndrome on health workers in a tertiary hospital. *British Journal of Psychiatry*, 185, 127-133. <https://doi.org/10.1192/bjp.185.2.127>
5. Diana, M. P. L. J., Cercado, F. G., Chiu, P. Z., De Justo, P. A., De Silva, A. R., & Oducado, R. M. F. (2023). Filipino nursing students' health promoting behaviors during the pandemic. *Nurse Media Journal of Nursing*, 13(1), 1-11. <https://doi.org/10.14710/nmjn.v13i1.49896>
  6. Eisenberg, D., Hunt, J., & Speer, N. (2013). Mental health in American colleges and universities: Variation across student subgroups and across campuses. *The Journal of Nervous and Mental Disease*, 201(1), 60-67. <https://doi.org/10.1097/NMD.0b013e31827ab077>
  7. Fu, W., Yan, S., Zong, Q., Anderson-Luxford, D., Song, X., Lv, Z., & Lv, C. (2021). Mental health of college students during the COVID-19 epidemic in China. *Journal of Affective Disorders*, 280(Pt A), 7-10. <https://doi.org/10.1016/j.jad.2020.11.032>
  8. Hoti, V., & Hoti, A. (2021). *Introduction to psychology* (2nd ed.). Publishers "Enja".
  9. Islam, M. S., Sujon, M. S. H., Tasnim, R., Sikder, M. T., Potenza, M. N., & van Os, J. (2020). Psychological responses during the COVID-19 outbreak among university students in Bangladesh. *PLOS ONE*, 15(12), e0245083. <https://doi.org/10.1371/journal.pone.0245083>
  10. Jetishi Çollaku, P. (2024). Assessment of anxiety after COVID-19 among Kosovo students. In *The 2nd International Congress of Healthcare Professionals: Abstracts* (p. 47). Prishtina, Kosovo.
  11. Jiang, W., Liu, X., Zhang, J., & Feng, Z. (2020). Mental health status of Chinese residents during the COVID-19 epidemic. *BMC Psychiatry*, 20, 580. <https://doi.org/10.1186/s12888-020-02971-1>
  12. Lima, C. K. T., Carvalho, P. M. de M., Lima, I. de A. A. S., Nunes, J. V. A. de O., Saraiva, J. S., de Souza, R. I., & Neto, M. L. R. (2020). The emotional impact of Coronavirus 2019-nCoV (new Coronavirus disease). *Psychiatry Research*, 287, 112915. <https://doi.org/10.1016/j.psychres.2020.112915>
  13. Public Health. (2025). Trends in COVID-19 infections and effects on young people. *Public Health Center*.
  14. Public Relations. (2025). The impact of vaccination on mental health. *Mental Health Institute*.
  15. Saeed, H., Eslami, A., Nassif, N. T., Simpson, A. M., & Lal, S. (2022). Anxiety linked to COVID-19: A systematic review comparing anxiety rates in different populations. *International Journal of Environmental Research and Public Health*, 19(4), 2189. <https://doi.org/10.3390/ijerph19042189>
  16. Wang, Y., Di, Y., Ye, J., & Wei, W. (2020). Study on the psychological states and its related factors during the outbreak of the coronavirus disease 2019 (COVID-19) in some regions of China. *Psychology, Health & Medicine*, 26, 10223, 1-10. <https://doi.org/10.1080/13548506.2020.1746817>
  17. World Health Organization. (2021, August 15). *WHO coronavirus (COVID-19) dashboard*. World Health Organization. <https://covid19.who.int/>
  18. Wu, P., Fang, Y., Guan, Z., Fan, B., Kong, J., Yao, Z., Liu, X., Fuller, C. J., Susser, E., Lu, J., & Hoven, C. W. (2009). The psychological impact of the SARS epidemic on hospital employees in China: Exposure, risk perception, and altruistic acceptance of risk. *Canadian Journal of Psychiatry*, 54(5), 302-311. <https://doi.org/10.1177/070674370905400504>

## NDIKIMI I PJESËMARRJES NË KLUBET STUDENTORE NË SOCIALIZIMIN, ALTRUIZMIN DHE MIRËQENIEN PSIKOLOGJIKE TË STUDENTËVE

Elona Hasmujaj<sup>1</sup>, Admir Dahati<sup>2</sup>, Anisa Halaj<sup>3</sup>, Juri Vuka<sup>4</sup>,  
Klea Cani<sup>5</sup>, Megi Grishaj<sup>6</sup>, Valter Çarri<sup>7</sup>

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti Psikologji-Punë Sociale*

### ABSTRAKT

Ky studim synon të trajtojë rolin dhe rëndësinë e pjesëmarrjes në klube studentore në zhvillimin e socializimit, altruizmit dhe mirëqenies psikologjike të studentëve në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Duke përdorur një qasje sasiore, të dhënat u mbledhën nga 135 studentë të fakulteteve të ndryshme, përmes një pyetësoi të administruar online. Rezultatet treguan se sa më e shpeshtë të jetë përfshirja në aktivitete të klubeve studentore, aq më i lartë është niveli i socializimit dhe altruizmit. Gjithashtu, pjesëmarrja në këto klube ka një ndikim të rëndësishëm në mirëqenien psikologjike të studentëve, edhe pse frekuenca shumë e lartë e angazhimit mund të sjellë efekte të kundërta. Janë konstatuar dallime të rëndësishme sipas gjinisë dhe fakultetit, me meshkujt dhe studentët e Fakultetit Ekonomik që shfaqin nivelin më të lartë të përfshirjes në klubet studentore. Studimi thekson rëndësinë e këtyre strukturave, si: mekanizma për zhvillim social, emocional dhe edukativ, duke sugjeruar nevojën për mbështetje institucionale të vazhdueshme.

**Fjalë kyçe:** klube studentore, socializim, altruizëm, mirëqenie psikologjike

**The impact of student club participation on students' socialization,  
altruism, and psychological well-being**

### ABSTRACT

This study aims to examine the role and importance of participation in student clubs in the development of socialization, altruism, and psychological well-being among students at the University of Shkodër “Luigj Gurakuqi.” Using a quantitative approach, data were collected from

<sup>1</sup> Drejtuese e departamentit Psikologji-Punë Sociale.

<sup>234567</sup> Studentë, departamenti Psikologji-Punë Sociale, dega Psikologji.

135 students across different faculties through an online questionnaire. The results showed that the more frequently students engage in student club activities, the higher their levels of socialization and altruism. Furthermore, participation in these clubs has a significant impact on students' psychological well-being, although very frequent engagement may produce opposite effects. Significant differences were observed based on gender and faculty, with male students and those from the Faculty of Economics showing the highest levels of involvement. The study highlights the importance of student organizations as mechanisms for social, emotional, and educational development, and suggests the need for ongoing institutional support.

**Keywords:** student clubs, socialization, altruism, psychological well-being.

## 1. Hyrje

Vitet e fundit, universitetet janë orientuar gjithnjë e më shumë drejt një qasjeje ku studenti është në qendër, jo vetëm në aspektin pedagogjik, por edhe në praktikën e menaxhimit dhe qeverisjes institucionale (Bovill, 2020; Healey et al., 2016; Mercer-Mapstone et al., 2017). Kjo qasje pasqyron një vetëdije të shtuar mbi rëndësinë e përfshirjes aktive të studentëve në jetën universitare dhe në proceset vendimmarrëse. Studentët nuk shihen më si përfitues pasivë të shërbimeve arsimore, por si palë të rëndësishme interesi që ndikohen drejtpërdrejt nga politikat institucionale dhe që luajnë rol kyç në zhvillimin e vetes dhe të komunitetit universitar (Jongbloed et al., 2008).

Një nga format më të përhapura dhe efektive të kësaj përfshirjeje janë klubet studentore, të cilat përfaqësojnë hapësira joformale për zhvillimin e aftësive sociale, profesionale dhe qytetare. Këto struktura ofrojnë mundësi për pjesëmarrje aktive, ushtrim të lidershit, ndërtim të rrjeteve sociale dhe rritje të ndjenjës së përkatësisë brenda një komuniteti universitar, duke pasuruar ndjeshëm përvojën akademike (Foubert & Urbanski, 2006). Aktivitetet e zhvilluara nga klubet studentore ndihmojnë gjithashtu në formimin e kompetencave të buta, si: puna në grup, komunikimi, menaxhimi i kohës dhe ndërgjegjësimi social (Forneris et al., 2007; Dogan, 2015).

Në Shqipëri, nisma të tilla janë duke u konsoliduar gjithnjë e më shumë si në universitetet publike, ashtu edhe në ato private. Universiteti “Luigj Gurakuqi” i Shkodrës, për shembull, ka konsoliduar tashmë klubet studentore, duke ofruar mundësi për aktivizëm studentor për çdo

departament të këtij universiteti. Pra, studentët krijojnë dhe zhvillojnë vetë aktivitete dhe organizime sipas fushave të interesit duke krijuar një hapësirë për të mësuarin informal. Po ashtu, universitete të tjera si “Marin Barleti”, UET, UBT dhe UAMD, ofrojnë një gamë të gjerë klubesh që mbulojnë fusha, si: arti, debati, teknologjia, sporti dhe vullnetarizmi. Këto struktura jo vetëm që pasurojnë jetën studentore, por kontribuojnë edhe në zhvillimin qytetar dhe profesional të të rinjve.

Ndikimi i aktiviteteve jashtëkurrikulare në zhvillimin e të rinjve ka qenë vazhdimisht objekt studimi në literaturën shkencore, ku theksohet roli i tyre në rritjen e vetëbesimit, ndjenjës së përkatësisë, zhvillimit të pavarësisë dhe të identitetit personal (Oberle et al., 2019; Hebert & Hauf, 2015). Këto përvoja përfaqësojnë një element kyç në tranzicionin e të rinjve drejt moshës madhore dhe janë të lidhura ngusht me zhvillimin e kompetencave praktike dhe qytetare. Mësimi nëpërmjet shërbimit është një qasje gjithnjë e më e pranuar në arsim, e cila e sheh pjesëmarrjen në klube si një mjet për të mësuar përmes përvojës sociale dhe angazhimit shoqëror (Hebert & Hauf, 2015). Kjo qasje mbështetet në funksione, si: ndihma ndaj të tjerëve, përfshirja në kauza shoqërore, zhvillimi i ndjeshmërisë sociale dhe ndërtimi i një ndjenje përgjegjësie ndaj komunitetit. Një aspekt i veçantë që lidhet ngusht me përvojën studentore në klube është sjellja prosociale, një koncept i konsoliduar në psikologjinë sociale dhe edukim, që përfshin veprime që synojnë të ndihmojnë dhe mbështesin të tjerët (Penner et al., 2004). Këto sjellje shfaqen në forma të ndryshme që nga ndihma emocionale dhe mbështetja materiale, deri te solidariteti në situata emergjente apo ndihma pa asnjë interes ndaj të panjohurve (Flynn et al., 2014). Shumë autorë theksojnë se këto sjellje zhvillohen si pasojë e imitimit të modeleve pozitive dhe përforcimeve sociale që individët përfshijnë në ambientet ku ndërveprojnë. Studimet tregojnë se përfshirja në aktivitete kolektive, si klubet studentore, mund të nxisë ndihmën, empatinë dhe bashkëpunimin, veçanërisht në moshat e reja ku modelet e sjelljes janë lehtësisht të influencueshme (Vilar et al., 2019).

Megjithë kontributin e dukshëm të aktiviteteve studentore në zhvillimin e të rinjve, në Shqipëri mungojnë studime empirike që analizojnë perceptimet e vetë studentëve mbi funksionin dhe ndikimin e klubeve studentore në jetën e tyre akademike, sociale dhe emocionale. Ky boshllëk në literaturë e bën të domosdoshme një qasje kërkimore që do të ndihmojë në vlerësimin më të plotë të rolit që luajnë këto struktura në ndërtimin e një universiteti përfshirës dhe me orientim zhvillimor.

Në këtë kontekst, qëllimi i këtij studimi është të hetojë se si pjesëmarrja në aktivitetet e klubeve studentore lidhet me përvoja të

rëndësishme, si: socializimi, altruizmi dhe mirëqenia psikologjike e studentëve në Universitetin e Shkodrës. Gjithashtu, studimi synon të shqyrtojë nëse karakteristikat demografike të studentëve – përkatësisht gjinia, mosha, viti i studimit dhe fakulteti – ndikojnë në nivelin e përfshirjes në këto aktivitete dhe në përfitimet e lidhura me to.

*Objektivat e studimit janë:*

- Të vlerësohet nëse frekuenca e pjesëmarrjes në aktivitetet e klubeve studentore ndikon në nivelet e socializimit, altruizmit dhe mirëqenies psikologjike të studentëve;
- Të identifikohen ndryshimet në përfshirjen në klubet studentore në varësi të karakteristikave demografike, si: gjinia, mosha, viti i studimit dhe fakulteti;
- Të eksplorohet lidhja mes socializimit, altruizmit dhe mirëqenies psikologjike në mesin e studentëve.

*Pyetjet kërkimore:*

- A ndikon pjesëmarrja në klubet studentore në nivelin e socializimit, altruizmit dhe mirëqenies psikologjike të studentëve në Universitetin e Shkodrës?
- A ndryshon frekuenca e pjesëmarrjes në aktivitetet e klubeve studentore në varësi të gjinisë, moshës, vitit të studimit dhe fakultetit?
- A ekzistojnë lidhje statistikisht të rëndësishme midis socializimit, altruizmit dhe mirëqenies psikologjike të studentët?

## 2. METODOLOGJIA

Ky është një studim sasior me natyrë përshkuese dhe eksploruese, i cili synon të shqyrtojë lidhjen midis pjesëmarrjes së studentëve në aktivitetet e klubeve studentore dhe përvojave të tyre në fushën e mirëqenies psikologjike, socializimit dhe sjelljes prosociale. Duke u mbështetur në literaturën ekzistuese dhe në kontekstin e veçantë të arsimit të lartë në Shqipëri, studimi synon të ofrojë të dhëna empirike mbi rolin e klubeve studentore në zhvillimin personal dhe ndërpersonal të të rinjve, si dhe të analizojë ndikimin e karakteristikave demografike në nivelin e përfshirjes studentore.

*Subjektet e studimit*

Në këtë studim morën pjesë gjithsej 135 studentë nga fakultete të ndryshme të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, nga ku  $n=102$  ishin femra dhe  $n=33$  meshkuj, me një moshë që varionte nga 18 në mbi 26



vjeç. Kampioni u përzgjedh përmes metodave joprobabilitare të kampionimit. Të dhënat u mblodhën përmes administrimit online të një pyetëso, i cili u shpërnda nëpërmjet platformave të komunikimit elektronik që përdoren nga studentët e këtij universiteti.

#### *Instrumenti i kërkimit*

Është ndërtuar nga pedagogu udhëheqës i këtij punimi në bashkëpunim me studentët. Instrumenti u administrua pas pilotimit dhe përllogaritjes së koeficientit të besueshmërisë ( $\alpha = .966$ ). Ai përbëhet nga 12 pyetje me zgjedhje të shumëfishtë, të vlerësuar në një shkallë Likert nga 0 = asnjëherë deri në 4 = gjithmonë. Pyetësoi përfshin tre seksione: të dhënat demografike, frekuencën e pjesëmarrjes në klubet studentore dhe vlerësimet e perceptuara mbi ndikimin e këtyre klubeve në socializim (4 pyetje), altruizëm (4 pyetje) dhe mirëqenie psikologjike (4 pyetje) të studentëve.

#### *Etika e kërkimit*

Kërkimi është zhvilluar në përputhje me standardet etike të kërkimit shkencor. Të gjithë pjesëmarrësit janë informuar për qëllimin e studimit, natyrën vullnetare dhe trajtimin konfidencial të të dhënave.

### **3. REZULTATET E STUDIMIT**

#### *3.1 Karakteristikat demografike të kampionit*

Në këtë kërkim, morën pjesë 135 subjekte, ndër të cilët 33 meshkuj (24.4%) dhe 102 femra (75.6%). Në lidhje me moshën, 39.3% e pjesëmarrësve janë të moshës 18-19 vjeç, 41.5% janë të moshës 20-21 vjeç, 11.1% janë 22-23 vjeç, 1.5% janë 24-25 vjeç dhe 6.7% e pjesëmarrësve i përkasin moshës mbi 26 vjeç. Përsa i përket vitit të studimit, 27.4% e pjesëmarrësve janë në vitin e parë të studimeve, 45.2% janë në vitin e dytë të studimeve, 14.8% e studentëve janë në vitin e tretë, 7.4% e tyre janë në vitin e katërt të studimeve dhe 5.2% janë të vitin e 5 të studimeve. Pjesëmarrësit janë të regjistruar në Fakultetin e Shkencave të Edukimit (46.7%), Fakultetin e Shkencave Shoqërore (5.9%), Fakultetin Ekonomik (17%), Fakultetin e Gjuhëve të Huaja (1.5%), Fakultetin e Drejtësisë (4.4%) dhe Fakultetin e Shkencave të Natyrës (24.4%).

#### *3.2 Frekuenca e pjesëmarrjes në klubet studentore në raport me variablat demografikë*

Për të vlerësuar nëse ka dallime statistike të rëndësishme në frekuencën e pjesëmarrjes në aktivitetet e klubeve studentore midis studentëve meshkuj

dhe femra, u realizua një test Mann–Whitney U. Rezultatet treguan për diferenca statistikisht domethënëse ( $U = 1047.50$ ,  $Z = -3.37$ ,  $p = .001$ ). Studentët meshkuj kishin një mesatare dukshëm më të lartë ( $M = 87.26$ ) sesa studentet femra ( $M = 61.77$ ), duke na sugjeruar se meshkujt marrin pjesë më shpesh në aktivitetet e klubeve studentore.

**Tabela 1**

*Diferenca në frekuencën e pjesëmarrjes në aktivitetet e klubeve studentore sipas gjinisë (Testi Mann–Whitney U).*

| Gjinia   | N   | Mesatare | U              | Z            | p           |
|----------|-----|----------|----------------|--------------|-------------|
| Mashkull | 33  | 87.26    |                |              |             |
| Femër    | 102 | 61.77    | <b>1047.50</b> | <b>-3.37</b> | <b>.001</b> |

Për të shqyrtuar nëse anëtarësia në klube studentore ndryshon në varësi të grupmoshës së studentëve, u realizua një analizë Kruskal–Wallis, ku rezultatet treguan se nuk kishte diferenca statistikisht domethënëse  $H(4) = 2.71$ ,  $p = .608$ . U vu re se përkatësia në një klub studentor nuk ndikohet nga mosha e studentëve në këtë kampion.

**Tabela 2**

*Analiza Kruskal–Wallis për ndryshimet në përkatësinë në klubet studentore sipas moshës.*

| Grupmosha   | N  | Mesatare |
|-------------|----|----------|
| 18–19 vjeç  | 53 | 71.75    |
| 20–21 vjeç  | 56 | 65.96    |
| 22–23 vjeç  | 15 | 58.00    |
| 24–25 vjeç  | 2  | 64.75    |
| Mbi 26 vjeç | 9  | 76.00    |

Për të përcaktuar nëse përkatësia në klubet studentore ndryshon në varësi të vitit të studimit, u aplikua përsëri Testi Kruskal–Wallis. Rezultatet treguan se diferenca midis grupeve nuk është statistikisht domethënëse, megjithëse është afër kufirit të rëndësisë statistikore  $H(4) = 9.40$ ,  $p = .052$ . Nisur nga mesataret e paraqitura në Tabelen 3, vihet re se studentët e vitit të dytë Bachelor dhe të dytë Master, raportojnë nivele më të larta të përkatësisë në klubet studentore.

**Tabela 3**

*Diferenca në përkatësinë në klubet studentore sipas vitit të studimit (Testi Kruskal–Wallis).*

| Viti i studimit | N  | Mesatare |
|-----------------|----|----------|
| Viti 1          | 37 | 65.66    |
| Viti 2          | 61 | 75.26    |
| Viti 3          | 20 | 54.63    |
| Viti 4          | 10 | 51.25    |
| Viti 5          | 7  | 79.21    |

Frekuentimi i klubeve studentore ndryshon në varësi të fakultetit ku studentët studiojnë.

Rezultatet në Tabelën 4 tregojnë për diferenca statistikisht të rëndësishme midis fakulteteve,  $H(5) = 19.57$ ,  $p = .002$ . Mesataret sugjerojnë se studentët nga Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti i Gjuhëve të Huaja shfaqin një tendencë më të lartë për të frekuentuar klubet studentore, ndërsa ata nga Fakulteti i Drejtësisë rezultojnë më pak të përfshirë.

**Tabela 4**

*Diferenca në përkatësinë në klubet studentore sipas fakultetit (Testi Kruskal–Wallis).*

| Fakulteti           | N  | Mesatare |
|---------------------|----|----------|
| Shkencat e Edukimit | 63 | 62.07    |
| Shkencat Shoqërore  | 8  | 64.75    |
| Ekonomik            | 23 | 92.63    |
| Gjuhët e Huaja      | 2  | 98.50    |
| Drejtësisë          | 6  | 42.25    |
| Shkencat e Natyrës  | 33 | 65.77    |

### 3.3 Marrëdhënia mes frekuencës së pjesëmarrjes në klubet studentore me socializimin, altruizmin dhe mirëqenien psikologjike.

Për të përcaktuar nëse ka ndryshime statistikisht të rëndësishme në nivelin e socializimit, altruizmit dhe mirëqenies psikologjike në lidhje me frekuencën e pjesëmarrjes në klubet studentore, u realizua analiza e variancës Anova. Rezultatet treguan për diferenca statistikisht të rëndësishme në të tre variablat: socializimi  $\{F(4, 130) = 19.84, p < .001\}$ ; altruizmi  $\{F(4, 130) = 18.67, p < .001\}$ ; mirëqenia psikologjike  $\{F(4, 130) = 16.44, p < .001\}$ .

**Tabela 5**

*Mesataret e socializimit, altruizmit dhe mirëqenies psikologjike për çdo nivel të pjesëmarrjes në klubet studentore.*

| Frekuenca e pjesëmarrjes | Socializim (M) | Altruizëm (M) | Mirëqenie (M) |
|--------------------------|----------------|---------------|---------------|
| Asnjëherë                | 8.69           | 8.79          | 8.67          |
| Rrallë                   | 10.95          | 10.65         | 10.55         |
| Ndonjëherë               | 12.28          | 12.44         | 12.65         |
| Shpesh                   | 13.48          | 13.76         | 12.95         |
| Gjithmonë                | 14.50          | 14.68         | 11.06         |

*Shënim. Të gjitha rezultatet janë statistikisht domethënëse në nivelin  $p < .001$ .*

Nisur nga Tabela 5, vihet re se socializimi dhe altruizmi rriten në mënyrë të qëndrueshme me frekuencën e pjesëmarrjes në klubet studentore, ku pika më e lartë “gjithmonë”, me mesatare socializimi  $M=14.50$  dhe altruizmi  $M=14.68$ . Kjo tregon që pjesëmarrja e vazhdueshme në klube, lidhet me ndjenja më të forta të lidhjes sociale dhe gatishmëri për të ndihmuar të tjerët. Mirëqenia psikologjike rritet nga “asnjëherë” ( $M=8.67$ ) në “shpesh” ( $M=12.95$ ), por më pas bie në “gjithmonë” ( $M=11.06$ ). Kjo mund të tregojë se pjesëmarrja shumë e shpeshtë, ndonjëherë mund të krijojë lodhje ose stres, edhe pse rrit lidhjen sociale dhe altruizmin.

### *3.4 Ndikimi i pjesëmarrjes në klubet studentore mbi socializimin, altruizmin dhe mirëqenien psikologjike të studentëve.*

Në këtë rast u aplikua analiza e regresionit linear të thjeshtë për secilin variabël të varur. Në bazë të rezultateve, vlera e  $R^2$  tregon që rreth 37% e variancës në variablin e varur (socializim) mund të shpjegohet nga variabli parashikues (pjesëmarrje në klubet studentore)  $\{R^2 = .37, F(4,130) = 19.84, p < .001\}$ .

Studentët që marrin pjesë më shpesh në aktivitetet e klubeve studentore, raportojnë nivele më të larta socializimi, ku rezultatet janë statistikisht të rëndësishme ( $\beta = .609, p < .001$ ).

Përsa i përket variablit të dytë, mund të konkludohet që rreth 36% e ndryshimeve në altruizëm shpjegohen nga sa shpesh studentët marrin pjesë në klube studentore  $\{R^2 = .359, F(4,130) = 18.67, p < .001\}$ . Pjesëmarrja në klube studentore ka një ndikim domethënës dhe të fortë në rritjen e altruizmit tek studentët. Sa më aktive të jenë përfshirjet e tyre, aq më shumë sjellje altruiste raportojnë ata ( $\beta = .599, p < .001$ ).

Në lidhje me variablin e tretë, pjesëmarrja në aktivitetet e klubeve studentore parashikoi në mënyrë statistikisht të rëndësishme mirëqenien psikologjike dhe shpjegoi rreth 30.9% së saj  $\{R^2 = .309, F(4,130) = 16.44, p < .001\}$ . Studentët që janë më aktivë në klubet studentore ndihen më mirë emocionalisht sesa ata që nuk marrin pjesë ose marrin pjesë rrallë ( $\beta = .556, p < .001$ ).

**Tabela 6**

*Parashikimi i socializimit, altruizmit dhe mirëqenies psikologjike përmes frekuencës së pjesëmarrjes në klubet studentore.*

| Modeli                 | Koeficientët e pastandardizuar |                 | Koeficientët e standardizuar | t     | $r^2$ | p    | Statistika e kolinearitetit |       |
|------------------------|--------------------------------|-----------------|------------------------------|-------|-------|------|-----------------------------|-------|
|                        | B                              | Gabimi standard | Beta                         |       |       |      | Toleranca                   | VIF   |
| Socializimi            | 1.51                           | .017            | .609                         | 8.84  | .37   | .000 | 1.000                       | 1.000 |
| Altruizmi              | 1.505                          | .18             | .599                         | 8.64  | .359  | .000 | 1.000                       | 1.000 |
| Mirëqenia psikologjike | 1.356                          | .176            | .556                         | 7.721 | .309  | .000 | 1.000                       | 1.000 |

a Parashikues: (Konstant), Pjesëmarrje në klube studentore.

b Variabli i varur: Socializimi, altruizmi, mirëqenia psikologjike.

### *3.5 Marrëdhënia mes variablave socializim, altruizëm dhe mirëqenie psikologjike*

Për të shqyrtuar lidhjen midis socializimit, altruizmit dhe mirëqenies psikologjike të studentëve, u realizua një analizë korrelacioni Pearson. Të gjitha lidhjet rezultuan statistikisht të rëndësishme në nivelin  $p < .001$ . Socializimi rezultoi me një lidhje shumë të fortë me altruizmin,  $r(133) = .91, p < .001$  dhe me mirëqenien psikologjike  $r(133) = .91, p < .001$ .

Po ashtu, altruizmi rezultoi të kishte një lidhje të fortë edhe me mirëqenien psikologjike,  $r(133) = .86, p < .001$ . Sa më i lartë të jetë niveli i socializimit të një studenti, aq më shumë altruizëm dhe mirëqenie psikologjike ai/ajo shfaq. Lidhjet janë shumë të forta dhe tregojnë se këto tri përvoja shoqërohen ngusht me njëra-tjetrën në jetën studentore.

**Tabela 7**

*Korrelacionet Pearson midis socializimit, altruizmit dhe mirëqenies psikologjike.*

| <b>Variablat</b> | 1. Socializim | 2. Altruizëm | 3. Mirëqenie |
|------------------|---------------|--------------|--------------|
| 1. Socializim    | –             | .91**        | .91**        |
| 2. Altruizëm     |               | –            | .86**        |
| 3. Mirëqenie     |               |              | –            |

*Shënim: Të gjitha korrelacionet janë statistikisht domethënëse në  $p < .001$ .*

#### 4. DISKUTIME

Rezultatet e këtij studimi hedhin dritë mbi ndikimin e pjesëmarrjes në klubet studentore në aspekte të rëndësishme të jetës studentore si socializimi, altruizmi dhe mirëqenia psikologjike. Në përputhje me qëllimet e vendosura në fillim të punimit, të dhënat tregojnë se studentët që marrin pjesë më shpesh në aktivitetet e klubeve studentore raportojnë nivele dukshëm më të larta të socializimit dhe altruizmit, si dhe të mirëqenies psikologjike, edhe pse me një rënie të lehtë në rastet e pjesëmarrjes së tepruar.

Gjetjet përputhen me literaturën ekzistuese që thekson rolin pozitiv të aktiviteteve jashtëkurrikulare në zhvillimin social dhe emocional të të rinjve (Foubert & Urbanski, 2006; Oberle et al., 2018). Pjesëmarrja në klube studentore duhet të jetë një mjet i fuqishëm për ndërtimin e lidhjeve shoqërore, përforcimin e ndjenjës së përkatësisë dhe promovimin e sjelljeve prosociale, çka është veçanërisht e rëndësishme në një periudhë zhvillimore siç janë vitet e studimeve universitare.

Gjithashtu, u evidentuan dallime statistikisht domethënëse në frekuencën e pjesëmarrjes në klube studentore sipas gjinisë, ku studentët meshkuj rezultuan më aktivë se studentet femra. Ky rezultat mund të lidhet me normat gjinore, pritshmëritë sociale dhe mundësitë e ndryshme për përfshirje, që ndoshta i favorizon më shumë djemtë në aktivitete jashtëkurrikulare (Eccles & Barber, 1999). Po ashtu, studime të mëparshme kanë treguar se vajzat ndonjëherë mund të përjetojnë më shumë ndjeshmëri ndaj vlerësimeve shoqërore, gjë që mund të ndikojë në mospërfshirjen e tyre në aktivitete grupore (Fredricks & Eccles, 2005).

Rezultatet treguan se nuk ekzistojnë ndryshime statistikisht të rëndësishme në frekuencën e pjesëmarrjes në klubet studentore në varësi të moshës dhe vitit të studimit, ndonëse studentët e vitit të dytë Bachelor dhe

Master rezultuan më të angazhuar. Ky trend mund të shpjegohet me rritjen e vetëbesimit dhe ndjenjës së përkatësisë që vjen me kohën, si dhe me aftësinë më të mirë për menaxhimin e kohës në vitet e avancuara të studimit (Pascarella & Terenzini, 2005).

Një tjetër gjetje është ajo që tregon se fakulteti ku studentët studiojnë ndikon dukshëm në frekuencën e pjesëmarrjes në klube. Studentët e Fakultetit Ekonomik dhe të Gjuhëve të Huaja rezultuan më të përfshirë, ndërsa ata të Fakultetit të Drejtësisë më pak. Ky rezultat përputhet me literaturën që thekson se programet studimore me karakter më të hapur dhe praktik (si ato ekonomike ose gjuhësore) ofrojnë më shumë mundësi dhe motivim për përfshirje jashtë aktiviteteve akademike (Tieu et al., 2010).

Ndër gjetjet më të rëndësishme, janë ato që vënë dukje se pjesëmarrja më e shpeshtë në klubet studentore lidhet në mënyrë domethënëse me nivele më të larta të socializimit dhe altruizmit. Kjo është në të njëjtën linjë me hulumtimet e mëparshme që sugjerojnë se aktivitetet studentore nxisin ndërveprimin social, ndihmojnë në krijimin e lidhjeve ndërpersonale dhe përforcojnë sjelljet prosociale (Astin, 1999; Foubert & Urbanski, 2006). Angazhimi i rregullt në klube studentore krijon mjedise mbështetëse dhe ndihmon studentët të zhvillojnë ndjeshmëri, solidaritet dhe ndihmë ndaj të tjerëve (Forneris et al., 2007).

Megjithatë, një gjetje interesante lidhet me mirëqenien psikologjike, e cila ndonëse rritet në nivele të moderuara të pjesëmarrjes, bie në grupin që merr pjesë gjithmonë. Kjo sugjeron se një përfshirje shumë intensive mund të çojë në ngarkesë psikologjike ose lodhje emocionale, ndoshta si rezultat i mbingarkesës me përgjegjësi sociale ose presionit për të performuar (Stewart-Brown et al., 2001). Studimet kanë treguar se ndonëse angazhimi social ka benefite, ai duhet të jetë i balancuar për të ruajtur mirëqenien emocionale (Oberle et al., 2018; Dogan, 2015).

Gjithashtu, u vërtetua se pjesëmarrja në klube studentore është një parashikues i fuqishëm për socializimin, altruizmin dhe mirëqenien psikologjike, me koeficientë beta të lartë dhe vlera  $R^2$  të konsiderueshme. Kjo sugjeron se krijimi i mundësive për angazhim jashtë auditorëve, ka ndikim konkret në zhvillimin psikosocial të studentëve. Këto gjetje përforcojnë argumentin se universitetet duhet të investojnë më shumë në strukturimin dhe promovimin e klubeve studentore, si një mekanizëm zhvillimi gjithëpërfshirës.

Më në fund, lidhjet e forta mes socializimit, altruizmit dhe mirëqenies psikologjike konfirmojnë ndërvarësinë e këtyre variablave dhe rëndësinë e tyre për jetën studentore. Këto rezultate përputhen me teoritë mbi sjelljen prosociale dhe zhvillimin emocional, të cilat theksojnë se ndjenjat e

përkatësisë dhe ndërveprimi shoqëror janë elemente kyç për mirëqenien psikologjike (Caprara et al., 2014; Penner et al., 2004).

Ky studim, ndonëse ka ofruar të dhëna të vlefshme, ka disa kufizime që duhet të merren parasysh në interpretimin e rezultateve. Së pari, kampionimi është joprobabilistik dhe me konvenciençë, duke kufizuar kështu mundësinë për të përgjithësuar gjetjet në të gjithë popullatën e studentëve shqiptarë. Së dyti, të dhënat janë mbledhur përmes një pyetësoi vetëraportues, çka mund të ndikojë në saktësinë e përgjigjeve për shkak të ndikimeve të mundshme të dëshirueshmërisë sociale apo kujtesës selektive. Gjithashtu, natyra e studimit është korrelacionale, prandaj nuk mund të përcaktohet marrëdhënie shkak-pasojë e variablave kryesore. Një tjetër kufizim është se studimi është përqendruar vetëm në Universitetin e Shkodrës, duke mos përfshirë studentë nga universitete të tjera në vend.

Në të ardhmen, mund të përfitohet nga studime të ngjashme me një kampion me të gjerë dhe metodologji mikse.

## 5. KONKLUZIONE DHE SUGJERIME

Ky studim trajtoi ndikimin e pjesëmarrjes në klubet studentore në zhvillimin e socializimit, sjelljeve prosociale dhe në përmirësimin e mirëqenies psikologjike, te studentët e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, duke vënë në dukje rëndësinë që këto struktura kanë, përtej funksionit të tyre tradicional social dhe argëtues. Rezultatet e marra përmes shqyrtimit të literaturës dhe analizës së të dhënave, treguan qartë se përfshirja aktive në klube studentore ndikon pozitivisht në aftësitë sociale, përkushtimin ndaj komunitetit dhe mirëqenien psikologjike të studentëve. Klube të tilla përbëjnë një mjedis të favorshëm për rritje personale dhe ndihmojnë në formimin e ndjenjës së përgjegjësisë sociale dhe ndjeshmërisë ndërpersonale.

Në këtë kuadër, rekomandohet fuqizimi i rolit edukues të klubeve studentore përmes nxitjes së aktiviteteve që promovojnë sjellje prosociale, krijimit të hapësirave mbështetëse emocionale, ofrimit të trajnimeve për aftësi sociale dhe mbështetjes përmes mentorimit. Angazhimi në projekte komunitare, vlerësimi i kontributit personal, ndërtimi i ndjenjës së përkatësisë dhe promovimi i lidershit empatik, janë gjithashtu faktorë kyç që duhet të integrohen në funksionimin e këtyre klubeve. Për më tepër, matja e ndikimit psikologjik të aktiviteteve dhe krijimi i një balance të shëndetshme mes jetës akademike dhe sociale do të kontribuonte në një zhvillim më të plotë dhe të qëndrueshëm të studentëve.



## REFERENCA

- Astin, A. W. (1999). Student involvement: A developmental theory for higher education. *Journal of College Student Development*, 40(5), 518–529.
- Bovill, C. (2020). Co-creation in learning and teaching: The case for a whole-class approach in higher education. *Higher Education*, 79(6), 1023–1037. <https://doi.org/10.1007/s10734-019-00453-w>
- Caprara, G. V., Alessandri, G., & Eisenberg, N. (2014). Prosociality: The contribution of traits, values, and self-efficacy beliefs. *Journal of Personality and Social Psychology*, 107(6), 993–1010. <https://doi.org/10.1037/a0036556>
- Dogan, U. (2015). Student engagement, academic self-efficacy, and academic motivation as predictors of academic performance. *Anthropologist*, 20(3), 553–561. <https://doi.org/10.1080/09720073.2015.11891761>
- Eccles, J. S., & Barber, B. L. (1999). Student council, volunteering, basketball, or marching band: What kind of extracurricular involvement matters? *Journal of Adolescent Research*, 14(1), 10–43. <https://doi.org/10.1177/0743558499141003>
- Flynn, H. K., Litchfield, R. C., White, J. A., & Reynolds, C. A. (2014). Modeling prosocial behavior and empathy in the classroom: The teacher's role. *The Journal of Positive Psychology*, 9(4), 278–289. <https://doi.org/10.1080/17439760.2014.920407>
- Forneris, T., Danish, S. J., & Scott, D. L. (2007). Setting goals, solving problems, and seeking social support: Developing adolescents' life skills through sport. *Adolescence*, 42(165), 103–114
- Foubert, J. D., & Urbanski, L. A. (2006). Effects of involvement in clubs and organizations on the psychosocial development of first-year and senior college students. *NASPA Journal*, 43(1), 166–182. <https://doi.org/10.2202/1949-6605.1576>
- Fredricks, J. A., & Eccles, J. S. (2005). Developmental benefits of extracurricular involvement: Do peer characteristics mediate the link between activities and youth outcomes? *Journal of Youth and Adolescence*, 34(6), 507–520. <https://doi.org/10.1007/s10964-005-8933-5>
- Healey, M., Flint, A., & Harrington, K. (2016). Students as partners: Reflections on a conceptual model. *Teaching & Learning Inquiry*, 4(2), 1–13. <https://doi.org/10.20343/teachlearninginqu.4.2.2>
- Hebert, A., & Hauf, P. (2015). Student learning through service learning: Effects on academic development, civic responsibility, interpersonal skills and practical skills. *Active Learning in Higher Education*, 16(1), 37–49. <https://doi.org/10.1177/1469787415573357>
- Jongbloed, B., Enders, J., & Salerno, C. (2008). Higher education and its communities: Interconnections, interdependencies and a research agenda. *Higher Education*, 56(3), 303–324. <https://doi.org/10.1007/s10734-008-9128-2>
- Mercer-Mapstone, L., Dvorakova, S. L., Matthews, K. E., Abbot, S., Cheng, B., Felten, P., ... & Swaim, K. (2017). A systematic literature review of students as partners in higher education. *International Journal for Students as Partners*, 1(1), 1–23. <https://doi.org/10.15173/ij sap.v1i1.3119>
- Oberle, E., Guhn, M., Gadermann, A. M., Thomson, K., & Schonert-Reichl, K. A. (2018). Positive mental health and academic achievement in elementary school: A population-based study. *Child Development*, 90(4), 1390–1406. <https://doi.org/10.1111/cdev.13008>
- Pascarella, E. T., & Terenzini, P. T. (2005). *How college affects students: A third*

*decade of research* (Vol. 2). Jossey-Bass.

- Penner, L. A., Dovidio, J. F., Piliavin, J. A., & Schroeder, D. A. (2004). Prosocial behavior: Multilevel perspectives. *Annual Review of Psychology*, 56, 365–392. <https://doi.org/10.1146/annurev.psych.56.091103.070141>
- Stewart-Brown, S. L., Evans, J., Patterson, J., Petersen, S., Doll, H., Balding, J., & Regis, D. (2001). The health of students in institutes of higher education: An important and neglected public health problem? *Journal of Public Health Medicine*, 22(4), 492–499. <https://doi.org/10.1093/pubmed/22.4.492>
- Tieu, T. T., Pancer, S. M., Pratt, M. W., Wintre, M. G., Birnie-Lefcovitch, S., Polivy, J., & Adams, G. (2010). Helping out or hanging out: The features of involvement and how it relates to university adjustment. *Higher Education*, 60(3), 343–355. <https://doi.org/10.1007/s10734-009-9303-0>
- Vilar, R., Reboloso, E., & Cuadrado, E. (2019). Development of prosocial behavior in adolescence: The role of empathy and values. *Journal of Adolescence*, 72, 61–70. <https://doi.org/10.1016/j.adolescence.2019.03.009>.

## IDENTIFIKIMI I FAKTORËVE MOTIVUES TË MËSUESVE NË SHKOLLAT E MESME

Arlinda Hallunovi Ymeri

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti i Mësuesisë*

### ABSTRAKT

Një pjesë e rëndësishme e punës së mësuesve është edhe motivimi për të arritur standarde dhe rezultate në punën e tyre. Motivimi është i lidhur ngusht me kënaqësinë që merr individi në punë. Marrëdhënia ndërmjet motivimit dhe kënaqësisë në punë lidhet me faktin se si e percepton individi kënaqësinë që duhet të marrë nga aktivitetet që ai zhvillon (Vroom, 1982). Mësimdhënia është proces që ndikohet nga vetë mësuesi, nxënësit, eprorët dhe dinamikat e ndryshme që krijohen nëpërmjet aktivitetit të përditshëm dhe pritshmërive që mësuesi krijon. Ky studim ka për qëllim të eksplorojë faktorët që ndikojnë në motivimin e mësuesve. Studime që kanë fokus kënaqësinë dhe motivimin e punonjësve arsimorë ka edhe në Shqipëri, por qëllimi i këtij studimi është që të evidentohen faktorët motivues, pastaj të studiohen faktorët organizacionalë, sipas këndvështrimit të mësuesve që çojnë në motivimin e tyre. Ky studim përbëhet nga dy faza: 1. Krijimi i dy fokus grupeve me mësues të shkollave të mesme, ku kam nxjerrë faktorët kryesorë që ndikojnë në motivimin e mësuesve. 2. Intervistat me mësuesit (N=27) për të kuptuar formën e ndikimit të ndryshimit organizacional në motivimin e tyre. Nga ky studim rezulton që faktorët tradicionalë motivues, si paga, kushtet e punës, janë më pak të rëndësishëm në motivimin e mësuesve në krahasim me pushimet dhe fleksibiliteti i orareve, marrëdhënia me kolegët dhe drejtuesit si dhe përparimi dhe arritja e rezultateve të nxënësve.

**Fjalë kyç:** *Motivim, ndryshim organizacional, mësues, kënaqësi në punë.*

### Dentification of teacher's motivational factors in secondary schools

### ABSTRACT

Part of the teacher's work is also the motivation to achieve standards and results in their results. Motivation is closely related to the satisfaction

that the individual receives at work. The relationship between motivation and job satisfaction is related to the fact that the individual perceives the satisfaction that he should receive from the activities he develops (Vroom, 1982). Teaching is the process that is followed by: the teacher himself, the students, the superiors and the different dynamics that are created through daily activities and the expectations that the teacher creates. This study aims to explore the causes of teacher motivation. Studies that focus on the satisfaction and motivation of teachers in education are also in Albania, but the aim of the study is to identify the motivational factors, then to study the organizational factors according to the teacher's perspective that leads to their motivation. This study of two phases: 1. Creation of two focus groups of high school teachers, where I identified the main factors in teacher motivation. 2. Interviews with teachers (N=27) to find the effect of organizational change on their motivation. From this study, traditional stories such as salaries are less limited in motivating teachers compared to vacations, flexibility of schedules, relationships with colleagues and administrators as well as progress and achievement of students that yield results.

**Keywords:** Motivation, organizational change, teachers, job satisfaction

### **Hyrje**

Motivacioni shihet si një gjendje e brendshme që nuk duket, por që inicion dhe mban të qëndrueshme një sjellje të caktuar, deri në plotësimin e nevojës dhe arritjen e qëllimit.

Motivimet në punë të mësuesit varen nga shkalla e kënaqësisë që puna i jep atij. Por mësuesi, në punën e tij të përditshme, nuk ka të njëjtën shkallë kënaqësie, e cila varet shumë prej faktorëve me të cilët mësuesi përballet për realizimin e punës së tij. Kënaqësia, sipas Locke (1976), është një gjendje emocionale pozitive që buron nga një sërë faktorësh të brendshëm dhe të jashtëm që lidhen me punën. Studimi i faktorëve që ndikojnë në kënaqësinë e punës merr një rëndësi të veçantë, pasi nëpërmjet zbulimit të shkallës së ndikimit që kanë faktorë të veçantë, mund të hartohen dhe programe pune për ta rritur nivelin e kënaqësisë. Vitet e fundit në gjimnaze kanë ndryshuar disa herë kurrikulat, prandaj edhe për mësuesit është e vështirë që të gjejnë strategji motivuese të qëndrueshme, sepse detyrohen të ndryshojnë qëllime.

Hoffman (1970) ka propozuar një bashkërendim të motivimit të mësuesit dhe rolit prindëror. Pra, motivimi i mësuesve është i lidhur edhe me mënyrat sesi fëmijët janë mësuar të trajtohen nga prindërit dhe sesi i

kanë formësuar këto sjellje. Mësuesit shfaqin dy kategori kryesore të faktorëve motivues. Faktorë motivues të brendshëm që kanë të bëjnë me arritjen e standardeve, kënaqësinë që iu jep puna, si dhe faktorëve të jashtëm që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me kolegët dhe eprorët, paga, kushtet e punës etj.

Ky studim ka si qëllim *identifikimin e faktorëve motivues të mësuesve në shkollat e mesme* në këndvështrimin e vetë mësuesve. Studimi fokusohet në përjetimet dhe perceptimet që vetë mësuesit shfaqin gjatë vitit dhe eksplorimit të ciklit të motivacioneve të tyre.

Në këtë studim jam fokusuar në nxjerrjen e kuptimeve për këto pyetje kërkimore:

1. Cilët janë faktorët ndikues në motivimin e mësuesve?
2. Si motivohen mësuesit e shkollave të mesme?

Këto pyetje janë boshti i këtij studimi. Përgjigjet që do të marrin këto pyetje përbëjnë bazën logjike të këtij studimi.

### **Metodologjia**

Metodologjia e kërkimit cilësor të jep mundësinë e eksplorimit dhe kuptimit të fenomeneve sociale dhe psikologjike duke analizuar me hollësi dhe në thellësi opinionet, eksperiencat dhe përjetimet e pjesëmarrësve. Studimi im është fokusuar në tri faza: a. Shqyrtimin e studimeve referuese që kanë të bëjnë me motivimin e mësuesve. b. Ngritjen e fokus grupeve me mësuesit për të kuptuar faktorët që ndikojnë më shumë sipas tyre në motivimin e tyre. c. Intervistimin e mësuesve për të kuptuar më thellë faktorët motivues tek secili mësues i bërë pjesë e kampionimit.

### **Pjesëmarrësit**

Në këtë studim marrin pjesë 27-mësues (18-femra, 9-meshkuj). Me këta mësues është realizuar një intervistë e gjysmëstrukturuar me qëllim kuptimin e cikleve motivacionale dhe faktorëve që motivojnë më së shumti mësuesit. Fokusgrupet e krijuara me mësuesit e gjimnazit “28-Nëntori” dhe gjimnazit “Oblikë” kishin për qëllim diskutimet dhe evidentimet e faktorëve që ndikojnë në motivimin dhe demotivimin e mësuesve. Në bazë të faktorëve kryesorë të dalë përmes fokus grupeve janë ndërtuar edhe pyetjet për intervistat me mësuesit e tjerë.

Këto intervista përbëhen nga 10 pyetje të hapura të cilat janë hartuar në përputhje me qëllimin e këtij studimi dhe drejt gjetjes së përgjigjeve të pyetjeve kërkimore të ngritura. Intervistat kanë zgjatur mesatarisht rreth 20-40 min dhe janë realizuar ballë për ballë.

### Analiza e të dhënave

Në fillim do të paraqesim rezultatet që kanë dalë nga fokus grupet në lidhje me faktorët që ndikojnë në motivimin sipas mësuesve. Në tabelën 1 janë të listuara disa nga faktorët më ndikues, por jo sipas rëndësisë së ndikimit.

| Temat e dala nga fokus grupi 1.   | Temat e dala nga fokus grupi 2. | Tema që janë në dy fokus grupet | Tema që shihen si risi në realitetin shqiptar |
|-----------------------------------|---------------------------------|---------------------------------|-----------------------------------------------|
| Harmonia me klasat dhe nxënësit   | Orare të kufizume               | Ndërrimi i drejtuesve           | Ndërrimi i drejtuesve                         |
| Punë me shumë pushim brenda vitit | Paga e mirë                     | Paga e mirë                     |                                               |
| Paga e kënaqshme                  | Mungesa e fëmijëve që mësojnë   |                                 |                                               |
| Ndërrimi i drejtuesve             | Mungesa e karrierës             |                                 |                                               |
| Mospërgatitja e nxënësve          | Ndërrimi i drejtuesve           |                                 |                                               |

Tabela 1

Në tabelën 1 me ngjyrë të gjelbër shfaqen temat që ndikojnë në motivimin e mësuesve, ndërsa me të kuqe temat dhe fenomenet që demotivojnë mësuesit. Me të verdhë janë temat që kanë një motivim, por jo shumë evident tek të gjithë mësuesit.

Tema që del si risi dhe në studimet e mëparshme nuk rezulton të jetë e rëndësishme është “Ndërrimi i drejtuesve”. Një mësues shprehet “...për të qenë mësues shembullor duhet që të merresh vetëm me mësimet dhe fëmijët, nuk të mjafton koha që të merresh me politikë. Në realitet ndodh që për t’u bërë drejtor duhet të merresh me politikë dhe si rezultat i takon që mësuesit më pak të mirë të bëhen drejtuesit tanë...”. Në bazën e këtyre temave të dala nga fokus grupi kemi ndërtuar intervistën e gjysmëstrukturuar me 10-pohime për mësuesit e tjerë.

Nga realizimi i 27-intervistave rezulton që të dalin këto tema të cilat përmes një analize cilësore kemi shkuar deri te konceptet për këto tema.

| TEMA                    | NËNTEMA                     |                                |
|-------------------------|-----------------------------|--------------------------------|
|                         | KONCEPTE                    |                                |
| NDËRRIMI I DREJTUESVE   | STRESI                      | Dinamika me drejtuesin         |
|                         |                             | Role të reja brenda kolektivit |
|                         | RIPROGRAMIM I DITARËVE      | Ribërja e punëve nga e para    |
|                         |                             | Komunikim i ri                 |
| PËRGATITJA E FËMIJËVE   | NXITJE PËR TU PËRGATITUR    | Moskuptimi i punës             |
|                         |                             | Progresi im                    |
|                         | KËNAQËSI PËR FRUTET E PUNËS | Karrierë si mësues             |
|                         |                             | Matura shtetërore              |
| KOHË E KUFIZUAR E PUNËS | 4-5 ORË BRENDA DITËS        | Falënderimi i prindërve        |
|                         |                             | Mundësi pushimi                |
|                         | 200 DITË BRENDA VITIT       | Thyerje rutine                 |
|                         |                             | Pushime verore                 |
|                         |                             | Pushime dimërore               |
|                         |                             | Fundjavat e lira               |

Tabela 2

Siç shihet edhe nga tabela 2 në motivimin e mësuesve kanë rol disa faktorë, por që kryesisht janë të lidhur me ambientin e ngushtë të shkollës në marrëdhënien me fëmijët dhe përparimin e tyre, gjithashtu edhe me mundësinë e pushimeve që të krijojnë ky profesion.

### **Tema 1. Ndërrimi i drejtuesve**

Pothuajse të gjitha subjektet e intervistuar e kanë vënë theksin tek ndërrimi i drejtuesve dhe mënyra e vendosjes, si dhe pozicionin që ata mbajnë kundrejt mësuesve.

#### **Nëntema 1. Stresi**

Nga analiza e përgjigjeve shihet qartë se mendimet e shumicës së subjekteve sillen rreth faktit se gjithë ditën e kalojnë të frustruar për faktin se çfarë po iu thotë drejtuesi.

*“Unë tanë ditën pres kur po më thotë drejtori ri **Pse janë fëmijët në koridor**”. [S12]*

#### **Nëntema 2. Riprogramimi i ditarëve**

*“Në fillim të vitit kur erdhi drejtoresha e re na tha që filloni punën siç do*

*vit, me të njëjtet ditare, mandej gjithë kohën duhet ndryshuar mënyra e vlerësimit, mënyra e të bërit mësim etj.”. [S21]*

## **Tema 2. Përgatitja e fëmijëve**

Një tjetër temë e rëndësishme rezulton të jetë edhe përgatitja akademike e fëmijëve. Rezultatet e mira të fëmijëve i motivojnë mësuesit për të bërë më të mirën dhe për të ndenjur në kontakt me të renë dhe inovativen.

### **Nëntema 1. Nxitja për t’u përgatitur**

Përgatitja e nxënësve vlerësohet shumë nga mësuesit në motivimin e tyre, ashtu siç evidentohet që mungesa e interesit nga nxënësit ndikon në uljen e motivimit të mësuesve.

*“Kur fëmija mëson, të ban edhe ty me e hap librin ose internetin”. [S2]*

### **Nëntema 2. Frutet e punës**

Sistemi parauniversitar nuk ka një platformë të qartë për shpërblimin e punës së mësuesit ose për matjen e performancës të secilit. E vetmja mënyrë sesi mësuesit e masin performancën është krahasimi me notat që marrin nxënësit e tyre në maturën shtetërore. Në momentet kur nxënësit ndahen mirë në maturën shtetërore, kjo ndikon që mësuesit të motivohen për të punuar sërish më fort me brezin tjetër.

*“E vetmja mënyrë me u vlersu është ballafaqimi me maturen shtetërore, po edhe aty bahen hile nganjëherë... [S8]*

## **Tema 3. Koha e kufizuar e punës**

Nga analiza e përgjigjeve të intervistave rezulton se në motivimin e mësuesve ndikon edhe perceptimi që ata kanë në lidhje me avantazhet e kësaj pune. Ata shprehen se si punë është e favorshme dhe të krijojnë mundësinë që të kesh kohë edhe për familjen ose për punë të dytë.

### **Nëntema 1: 4-orë brenda ditës**

Dita dhe rutina e mësuesit është 4-orë mësim në ditë. Ata nuk është se ndihen të lodhur, sepse kanë mundësi të bëjnë një lexim ose të dalin brenda orarit të punës.

*“Katër orë në ditë baj unë, gjithmonë mas orës dytë dal sa me pi një kafe. Kështu si punë është super vetëm se ke të bash me shumë lloje fëmijësh dhe kolegesh... [S19]*

### **Nëntema 2: 200-ditë brenda vitit**

Profesioni i mësuesit ka mundësi që gjatë vitit të bëjë shumë pushime, sepse vetë sistemi parauniversitar ka disa periudha pushimi. Gjatë gjithë vitit i kanë fundjavët e lira dhe për çdo stinë e kanë të mundur të bëjnë pushime.



*“Puna është stresuese për arsyet e maparshme, por na vetëm gjysen e vitit jena në punë edhe kjo asht gja e mirë boll” [S3]*

Siç shihet edhe nga analizat për secilën temë dhe kategori vërehet se mësuesit kryesisht janë të demotivuar nga mungesa e karrierës meritokratike dhe rolit të drejtuesve në marrëdhëniet e tyre me punën dhe kolegët.

## KONKLUZIONE

Pas zhvillimit të analizës së të dhënave të marra nga intervistat dhe fokus grupet e realizuar në dy shkolla arrijmë në konkluzionet e mëposhtme:

- Ndryshimi i drejtuesve të shkollës shkakton stres dhe demotivim tek mësuesit. Ky stres pasohet edhe me një perceptim të mungesës së meritokracisë.
- Mësuesit ndihen mirë për faktin që nuk kanë shumë ditë pune dhe brenda orarit ditor nuk janë shumë të ngarkuar. Kjo i bën ata që të jenë të motivuar si profesion, por kjo intimidohet nga përgatitja e nxënësve dhe mungesa e një platforme për rritjen në karrierë dhe matjen e performancës së mësuesve.

## REFERENCA

- Billingsley, B. S. (1993). Teacher retention and attrition in special and general education: A critical review of the literature. *The Journal of Special Education*, 27, 137-174.
- Bishay, A. (1996). Teacher motivation and job satisfaction: a study employing the experience sampling method. *Journal of Undergraduate Sciences*, 3, 147-154.
- Hall, B. W.; Pearson, L. C.; Carrol, D. (1992), Teachers' Long-Range Teaching Plans: A Discriminant Analysis, in: *Journal of Educational Research*, Vol. 85, pp. 221-225
- Orhani, Z (2011) Motivacioni Trajtese Psikologjike. 232-245
- Vroom, V. H. (1982). *Work and motivation* (Rev. ed.). Malabar, FL: Robert E. Krieger Publishing Company.

**ISSN 2221 – 6863**

***Doli nga shtypi gusht 2025 – tirazhi 120 kopje – Format 176 x 250 mm.  
Shtypur në shtypshkronjën e Universitetit të Shkodrës  
“Luigj Gurakuqi”***